

SHQIPËRIA
2018 - 2030



PROGRAMI KOMBËTAR SEKTORIAL I UJIT

MESAZHI I KRYEMINISTRIT (PREAMBUL)

Finalizimi i Programit Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit është një hap shumë i rëndësishëm për arritjen me sukses të një prej prioriteteve të qeverisë. Ai ka ardhur si rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë midis ministrive, fusha e përgjegjësisë së të cilave lidhet me sektorin e ujit, partnerëve zhvillimorë, njësitë të qeverisjes vendore dhe përfaqësuesve të fushës akademike.

Në këtë dokument reflektohet puna e deritanishme e Qeverisë shqiptare për të pasur një pasqyrë të qartë të problematikave si dhe vendosmëria për zgjidhjen e tyre nëpërmjet qasjes sektoriale për ujin. Programi bazohet mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, gjithëpërfshirjes e transparencës duke siguruar zhvillimin ekonomik, social e mjedisor të vendit.

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit synon sigurimin e nevojave jetësore, konkurrueshmërinë e përdorimit, reduktimin e rrezikut nga ujit, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Gjithashtu, ai siguron zhvillimin e sektorit dhe merr në konsideratë çështje që lidhen direkt ose indirekt me të, siç janë ndryshimet klimatike, reduktimi i riskut nga përmbytjet, zhvillimi ekonomik etj.

Në aspektin ligjor e teknik, ky program vendos kornizat për arritjen e objektivave të përcaktuar, por njëkohësisht ai ka fleksibilitetin dhe dinamizmin për tu përshtatur në varësi të situatave të caktuara.

Mesazhi kryesor që përcjell zbatimi i një dokumenti të mirëhartuar dhe lehtësisht të zbatueshëm sikurse është Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit është optimizimi për zhvillimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm për shoqërinë. Sfida që bashkërisht kemi përpara është zbatimi me skrupulozitet i të gjithë gamës së masave të konkretizuara në këtë instrument madhor.

Gjej rastin të falënderoj Ministrat, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Ujit, dhe të shpreh mirënjohje për të gjithë aktorët e angazhuar në faza të ndryshme të hartimit të këtij programi.

Mbetem besimplotë se ky dokument do të përmirësojë komunikimin midis grupeve të interesit dhe do të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë, për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të ujit dhe afrimin e mëtejshëm të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

EDI RAMA

KRYEMINISTËR

KRYETAR I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

PËRMBAJTJA

AKRONIME	4
LISTA E FIGURAVE	5
LISTA E TABELAVE	5
LISTA E GRAFIKËVE	6
HYRJE	8
KAPITULLI I: QASJA E PËRGJITHSHME NDAJ POLITIKAVE	12
1.1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM	12
1.1.1. Kushtet fiziko-gjeografike	12
1.1.2. Ndarja administrative	15
1.1.3. Demografia	16
1.1.4. Situata ekonomike e Shqipërisë	16
1.1.5. Burimet ujore në Shqipëri	16
1.1.6. Ekosistemet në Shqipëri	17
1.2. ANALIZA E SEKTORIT TË UJIT	20
1.2.1. Përdorimi i ujit	20
1.2.2. Mbrojtja e ujit	22
1.2.3. Mbrojtja nga uji	27
1.3. QEVERISJA E UJIT	28
1.3.1. Kuadri rregullator	28
1.3.2. Kuadri institucional	33
1.3.3. Kuadri financiar	35
1.3.4. Burimet njerëzore	40
1.3.5. Sistemi i informacionit	43
1.3.6. Studimet	43
1.3.7. Investimet	44
1.4. VIZIONI	45
1.5. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	45
1.6. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR QEVERISJEN E SEKTORIT TË UJIT	49
1.7. RISQET E PROGRAMIT	50
1.7.1. Riske për kuadrin ligjor dhe nënligjor	50
1.7.2. Riske për kuadrin institucional	51
1.7.3. Riske për kapacitetet njerëzore	51
1.7.4. Riske për kuadrin financiar	51
1.7.5. Riske për informacionin	51
1.7.6. Riske për investimet	51
KAPITULLI II: STRATEGJIA DHE PLANI I MASAVE	52
2.1. STRUKTURA E MASAVE	52
2.2. MASAT E GRUPUARA DHE PLANI TOTAL I MASAVE	53
KAPITULLI III: MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE	62
3.1. MEKANIZMI INSTITUCIONAL	62
3.1.1. Nivelet e mekanizmit institucional	62
3.1.2. Roli i niveleve hierarkike të mekanizmit institucional	63
3.2. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PKS	74
3.2.3. Matricat e prioritizimit të projekteve	76
3.3. METODOLOGJIA	77
3.3.6. Mekanizmat shtrëngues	79
3.4. ZBATIMI	80
KAPITULLI IV. BUXHETI I PROGRAMIT KOMBËTAR SEKTORIAL DHE BURIMET E FINANCIMIT	82

4.1. HENDEKU FINANCIAR	82
4.1.1. <i>Financimi i nevojshëm për përmbushjen e objektivave</i>	82
4.1.2. <i>Parashikimi i financimit sipas objektivave për periudhën 2019-2030</i>	89
4.1.3. <i>Treguesit financiarë sipas secilit objektiv</i>	95
4.2. BURIMET E FINANCIMIT TË SEKTORIT	113
4.2.1. <i>Mekanizmi i financimit të sektorit në kuadër të GMIP</i>	114
4.2.2. <i>Mekanizmi i financimit të pushtetit vendor në kuadër të përmbushjes së objektivave</i>	115
KAPITULLI V: MONITORIMI	116
5.1. AKTORËT	116
5.2. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E AKTORËVE	116
5.3. INSTRUMENTAT E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	119
5.3.1 <i>Raportimi dhe proceset</i>	119
5.3.2 <i>Raporti i monitorimit 6-mujor të planit të veprimit</i>	121
5.4. INDIKATORËT E MONITORIMIT	122
FJALOR/PËRKUFIZIME	129
BIBLIOGRAFIA	132
SHTOJCA	133
SHTOJCA 1: AKTORËT KRYESORË NË SEKTOR	133
SHTOJCA 2: METODOLOGJIA	138
SHTOJCA 2.1 DETAJIMI I MASAVE NË AKTIVITETE	138
SHTOJCA 2.2 SEKUENCIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË NJË MEKANIZMI EFICIENT QEVERISËS	139
SHTOJCA 2.3 KOSTIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE	139
SHTOJCA 2.4 PËRCAKTIMI I PESHËS QË ZËNË PROJEKTET NË RAPORT ME ARRITJEN E OBJEKTIVAVE RESPEKTIV	142
SHTOJCA 2.5 PËRCAKTIMI I INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE	142
SHTOJCA 2.6 PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE	142
SHTOJCA 2.7 PRIORITIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE / PROJEKTEVE TË KARAKTERIT INFRASTRUKTUROR	144
SHTOJCA 2.8 PRIORITIZIMI I OBJEKTIVAVE	160
SHTOJCA 2.9 PROCESI I KONSULTIMIT	161
SHTOJCA 3: FORMATI I HARTIMIT TË LISTËS SË PROJEKTEVE NË INFRASTRUKTURË NGA ÇDO INSTITUCION NË KUADËR TË PLANIT TË VEPRIMIT	162
SHTOJCA 4: FINANCIMI	174
SHTOJCA 5: MONITORIMI	176
SHTOJCA 5.1. STRUKTURA E RAPORTIT VJETOR TË PKS-SË DHE PLANIT TË VEPRIMIT	176
SHTOJCA 5.2. STRUKTURA E RAPORTIT 6-MUJOR TË PLANIT TË VEPRIMIT	177
SHTOJCA 5.3. MATRICA E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	178

Akronime

ABU	Agjencitë e Basenit Ujor
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ARZM	Administratat Rajonale te Zonave te Mbrojtura
ASH	Akademia e Shkencave
ASIG	Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
GMIP	Grupi për Manaxhimin e Integruar të Politikave
GWP	Global Water Partnership
HEC	Hidrocentral
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IGJIU	Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
ISHPM	Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Mjedisit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHU	Inspektorati Shtetëror i Ujërave
KESH	Kooperata Elektroenergjitike Shqiptare
KBU	Këshillat e Baseneve Ujorë
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
KPAUN	Komisioni i Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MM	Ministria e Mjedisit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
PBA	Program Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PKS	Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SRSHP	Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik
STKKU	Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
UK	Shoqëritë Ujësjetëlës – Kanalizime
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZPA	Zona të Përcaktuara për Akuakulturë

Lista e figurave

Figura 1. Skema e përbërjes së Grupit për Manaxhimin e Integruar të Politikave	9
Figura 2. Hapat e ndjekur gjatë procesit të hartimit të PKS-së.....	10
Figura 3. Hartë e relievit të Shqipërisë.	14
Figura 4. Harta administrative territoriale e bashkive të Shqipërisë.....	15
Figura 5. Kufijtë hidrografikë të baseneve ujëmbledhës (punuar nga STKKU).....	19
Figura 6. Paraqitje skematike e sektorit të ujit sipas ndarjes në PKS.	20
Figura 7. Harta administrative e Shqipërisë dhe kufijtë hidrografikë të baseneve ujore.	34
Figura 8. Struktura e masave për zbatimin e Programit Kombëtar Sektorial	52
Figura 9 Hierarkia e niveleve qeverisëse	63
Figura 10 Skema e aktorëve sipas niveleve qeverisëse.....	74
Figura 11. Metodologjia e hartimit të PKS, PV dhe planit vjetor institucional.	75
Figura 12. Skema e monitorimit të hartimit dhe miratimit të raportit të PKS-së dhe planit të veprimit.....	121
Figura 13. Skema e procesit të hartimit dhe miratimit të raportit 6-mujor të planit të veprimit.	122
Figura 14. Skema e Indikatorëve	123
Figura 15. Skema e përfutimit të informacionit nga dokumente planifikuese	138

Lista e tabelave

Tabela 1. Të dhënat e baseneve hidrografike të Shqipërisë.....	18
Tabela 2. Të dhënat e financimit të sektorit të ujit sipas programeve (2015-2019).....	36
Tabela 3. Llojit i financimit për periudhën 2015-2019.....	37
Tabela 4. Të dhënat e financimeve aktuale të partnerëve zhvillimorë sipas llojit të financimit.	38
Tabela 5. Të dhënat për financimet aktuale të partnerëve zhvillimorë sipas nënsektorëve.	38
Tabela 6. Numri i koncesioneve dhe vlera totale e investimit.	39
Tabela 7. Masat e grupuara.....	54
Tabela 8. Programi i masave qeverisëse.	60
Tabela 9. Programi i masave infrastrukturore.....	61
Tabela 10. Të dhëna lidhur me nevojat totale financiare, financimin sipas PBA si dhe hendeku financiar sipas objektivave për periudhën 2018-2030.....	83
Tabela 11. Financimi për secilin objektiv sipas PBA-së për periudhën 2015-2018.	85
Tabela 12. Parashikimi mbi financimin sipas PBA për periudhën 2019-2030 për secilin objektiv.....	89
Tabela 13. Të dhënat lidhur me nevojat totale për financim të ndara në studime, investime dhe nevojat për mirëqeverisjen, financimi sipas PBA-së dhe hendeku financiar sipas objektivave për periudhën 2018-2030	92
Tabela 14. Indikatorët e objektivave të sektorit.....	124
Tabela 15. Studimet dhe kostot e llogaritura për ditë pune	141
Tabela 16. Indikatorët matës të performancës për objektiv (shembull).....	143
Tabela 17. Matricë prioritizimi (<i>shembull</i>).....	145
Tabela 18. Matrica e prioritizimit për ujësjellës urban.	146
Tabela 19. Matrica e prioritizimit për ujësjellës rural.....	147
Tabela 20. Matrica e prioritizimit për kanalizim urban.	148
Tabela 21. Matrica e prioritizimit për kanalizim rural.....	149
Tabela 22. Matrica e prioritizimit për ujitjen.....	150
Tabela 23. Matrica e prioritizimit për kullimin.	152
Tabela 24. Matrica e prioritizimit për akuakulturën.	153
Tabela 25. Matrica e prioritizimit për shfrytëzimin e potencialeve hidroenergjetike.	154
Tabela 26. Matrica e prioritizimit për plotësimin e nevojave të industrisë me ujë.	155
Tabela 27. Matrica e prioritizimit për Objektivin 8, Objektivin 9, Objektivin 10.	156
Tabela 28. Matrica e prioritizimit për përmbytjen.....	157
Tabela 29. Matrica e prioritizimit për kushtet teknike të digave.	158

Tabela 30. Matrica e prioritizimit për erozionin	159
Tabela 31. Ndarja e financimit në kategorinë financim i brendshëm dhe financim i huaj në nivel programi	174
Tabela 36. Raporti vjetor i monitorimit të PKS-së dhe planit të veprimit.	176
Tabela 37. Raporti 6-mujor i monitorimit të planit të veprimit.	177
Tabela 38. Matrica e monitorimit dhe raportimit.....	178

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Të dhënat financiare sipas tre shtyllave të sektorit të ujit.....	91
Grafiku 2. Nevojat dhe financimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 1	95
Grafiku 3. Hendeku financiar për Objektivin 1	96
Grafiku 4. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 2	97
Grafiku 5. Hendeku financiar për Objektivin 2	97
Grafiku 6. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 3	98
Grafiku 7. Hendeku financiar për Objektivin 3	99
Grafiku 8. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 4	99
Grafiku 9. Hendeku financiar për Objektivin 4	100
Grafiku 10. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 5 ..	100
Grafiku 11. Hendeku financiar për Objektivin 5	101
Grafiku 12. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 6 ..	101
Grafiku 13. Hendeku financiar për Objektivin 6	102
Grafiku 14. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 7 ..	102
Grafiku 15. Hendeku financiar për Objektivin 7	103
Grafiku 16. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 8 ..	104
Grafiku 17. Hendeku financiar për Objektivin 8	105
Grafiku 18. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 9 ..	105
Grafiku 19. Hendeku financiar për Objektivin 9	106
Grafiku 20. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 10	106
Grafiku 21. Hendeku financiar për Objektivin 10	107
Grafiku 22. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 11	108
Grafiku 23. Hendeku financiar për Objektivin 11	108
Grafiku 24. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 12	109
Grafiku 25. Hendeku financiar për Objektivin 12	110
Grafiku 26. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 13	110
Grafiku 27. Hendeku financiar për Objektivin 13	111
Grafiku 28. Nevojat totale, financimi sipas PBA-së dhe hendeku financiar total i PKS 2018-2030	111
Grafiku 29. Treguesit financiarë për Programin Kombëtar Sektorial për Manaxhimin e Integruar të Ujit	112
Grafiku 30. Hendeku financiar total i PKS-së për çdo vit	112



HYRJJE

Manaxhimi i integruar i ujit është një ndër prioritet e qeverisë shqiptare. Ky prioritet theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (*miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016*). Sektori i ujit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ai lidhet ngushtë me prodhimin e energjisë elektrike, zhvillimin e bujqësisë, turizimin dhe rekreacionin. Në procesin e integritit evropian arritja e standardeve të BE-së në sektorin e ujit konsiderohet si një nga proceset më të vështira dhe të kushtueshme.

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit është një dokument i konkretizuar pas një pune të përbashkët të institucioneve dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore, të partnerëve zhvillimorë, shoqërisë civile dhe specialistëve që kanë të bëjnë direkt ose indirekt me sektorin e ujit. Ky program paraqet një qasje të integruar për zhvillimin e sektorit të ujit, e cila ka lindur si një nevojë e institucioneve shqiptare, por edhe e partnerëve zhvillimorë që mbështesin sektorin e ujit.

Synimet kryesore të këtij programi janë orientimi i investimeve drejt objektivave kombëtarë, përmirësimi i procesit të planifikimit, rritja e investimeve në sektor, rritja e të ardhurave që gjeneron sektori, monitorimi i vazhdueshëm dhe efektiv, sikurse edhe mbrojtja e ekuilibrave mjedisore. Zbatimi i këtij programi do të bëhet nëpërmjet planit të veprimit që përditësohet çdo vit dhe ka një projektion 3-vjeçar. Këto plane përfshijnë masa e aktivitete të propozuara nga të gjithë aktorët e sektorit të ujit në zbatim të objektivave kombëtare.

Nevoja për një qasje sektoriale

Gjatë 25 viteve të fundit janë bërë përpjekje të ndryshme për të reformuar këtë sektor nisur edhe nga rëndësia që uji ka për jetën sociale, zhvillimin ekonomik dhe strategjik të vendit. Nga pikëpamja institucionale sektori i ujit rezulton të jetë i fragmentuar. Për fusha të ndryshme në sektorin e ujit janë bërë investime me fonde nga buxheti i shtetit, janë dhënë grante dhe kredi në periudha dhe vlera të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar disa dokumente strategjike, por koordinimi midis tyre si dhe mbështetja e pamjaftueshme financiare i kanë bërë shpeshherë të pazbatueshme. Gjithashtu është investuar për ngritjen e kapaciteteve me anë të programeve dhe projekteve të ndryshme të trajnimit, të cilat kanë dhënë një mbështetje të konsiderueshme përgjithësisht për nivelin politikbërës. Në këtë kuadër, sektori i ujit ka ende nevojë për ngritje kapacitetesh në të gjitha nivelet qeverisëse.

Planifikimi i investimeve rezulton të ketë nevojë për përmirësim të koordinimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm të lidhur me ujin. Mënyra aktuale e planifikimit duhet të jetë e orientuar drejt rezultatit, përse i përket pritshmërive dhe efektivitetit. Përpjekjet e deritanishme për të bërë planifikim të integruar dhe afatgjatë kanë rezultuar jo realiste dhe të vështira në mjaft raste, kjo për shkak të mungesës së një mekanizmi dhe qasje të integruar.

Në këto kushte, duke marrë parasysh edhe qasjen e orientuar nga BE-ja për manaxhimin e fondeve IPA sikurse edhe rekomandimet e propozuara nga partnerët zhvillimorë për reforma në këtë sektor, u pa e nevojshme përgatitja e një vizioni të ri për sektorin e ujit dhe ngritja e mekanizmave për të aplikuar qasjen sektoriale. Kjo qasje do të shërbejë gjithashtu për të aplikuar mbështetjen buxhetore sektoriale.

Për zbatimin e qasjes sektoriale është ngritur Grupi për Manaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP). Në këtë kontekst, propozohet që nëpërmjet Programit Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit (PKS) dhe mekanizmit të GMIP-së, të krijohet kuadri i nevojshëm institucional dhe ligjor për zbatimin me sukses të kësaj qasjeje. Hartimi dhe zbatimi

i këtij dokumenti do të krijojë një perspektivë të qartë të zhvillimit të sektorit, sikurse edhe mekanizmat e duhur për t'ju përgjigjur sfidave të ardhshme.

Procesi i hartimit të materialit

- **Mekanizmi institucional**

Puna për hartimin e PKS-së ka nisur menjëherë pas miratimit të Urdhrit të Kryeministrit nr. 129, datë 21.09.2015 “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e GMIP-së dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 4 datë 2.12.2015 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e nëngrupeve tematike në fushën e manaxhimit të integruar të ujit”.

GMIP-ja është organi më i lartë udhëheqës i mekanizmit institucional të propozuar për qasjen e integruar të sektorit të ujit. Ky grup drejtohet nga Kryeministri (në cilësinë e Kryetarit të KKKU-së) dhe ka anëtarë ministrat e Këshillit Kombëtar të Ujit, partnerët zhvillimorë, përfaqësues të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile. Ai siguron instrumentin transparent dhe të koordinuar për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të politikave në sektorin e ujit.

Roli i GMIP-së është të këshillojë, drejtojë dhe koordinojë institucionet e përfshira në sektor, të zhvillojë dhe të zbatojë një Program Kombëtar Sektorial (përfshirë një Program për Mbështetje Sektoriale që tregojnë burimet e financimit për masat e ndryshme), të sigurojë dakordësi për çështje kyçe që ndikojnë në sektor, të miratojë listën e vetme sektoriale të projekteve prioritare strategjike, të miratojë rezultatet e punës së ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm dhe të bëjë rekomandime për vendimmarrësit e nivelit të lartë.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU) është institucioni koordinues që harmonizon dhe standardizon rekomandimet e dhëna nga GMIP-ja me propozimet e dhëna nga nëngrupet tematike.

Nëngrupet tematike drejtohen nga ministratë e linjës të cilat kanë në fushën e tyre të përgjegjësisë çështje të ndryshme të sektorit të ujit. Ministratë përkatëse kanë përcaktuar respektivisht për secilin nga nëngrupet tematike me Urdhër Ministri përfaqësuesit e tyre.




Figura 1. Skema e përbërjes së Grupit për Manaxhimin e Integruar të Politikave dhe nëngrupeve tematike.

• **Hapat e ndjekur**

Nëngrupet tematike dhe ministritë e linjës kanë hartuar dokumentin duke kontribuar secili sipas fushave të përgjegjësisë që ata mbulojnë. STKKU-ja ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të këtij dokumenti si dhe ka kontribuar në koordinimin e punës së institucioneve të përfshira në të.

Për finalizimin e këtij dokumenti janë zhvilluar 48 mbledhje ku anëtarët e nëngrupeve tematike kanë dakordësuar mbi rëndësinë e dokumentit, strukturën e tij, problematikat, objektivat për të ardhmen dhe masat e nevojshme për arritjen e tyre, aspektet financiare dhe afatet kohore.

Gjatë procesit të hartimit të PKS-së është pasur parasysh parimi i gjithëpërfshirjes dhe transparencës duke ftuar në takime jo vetëm institucionet qendrore dhe vendore por edhe grupet e interesit, OJF-të, shoqatën e bashkive dhe shoqatën për autonominë vendore. Në këtë kuadër, ky dokument është konsultuar më pas me një grup më të madh aktorësh, duke përfshirë institucionet e varësisë, universitetet, ekspertë të njohur të fushës, vendas dhe të huaj.

Pushteti vendor është një nga aktorët kryesorë për zbatimin e këtij programi dhe në këtë kuadër ky dokument është prezantuar në takimet e mbajtura me përfaqësues të bashkive të ndryshme.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces kanë luajtur edhe partnerët zhvillimorë dhe organizatat shqiptare jofitimprurëse të përfshira në manaxhimin e ujit në vend. Kontributet e tyre gjenden gjithashtu të reflektuara në këtë dokument.




Figura 2. Hapat e ndjekur gjatë procesit të hartimit të PKS-së.

Qëllimi i programit

Ky program synon të garantojë koordinimin e procesit të planifikimit të financimeve në sektorin e ujit, që vijnë nga pushteti qendror, nga mbështetja e partnerëve zhvillimorë si dhe bashkërendimin me njësitë e qeverisjes vendore për programimin e investimeve në sektor.

Të gjitha këto hapa do t'i paraprijnë hartimit të PBA-së, si një ndër proceset kryesore për konkretizimin e zbatimit të programit, duke pasur parasysh kompleksitetin që paraqet sektori i ujit, përfshirë këtu fusha, çështje dhe institucione të ndryshme. Funkcionimi i mekanizmit institucional dhe zbatimi i masave me karakter qeverisës do të garantojnë eficiencën dhe do të krijojnë sinergji mes këtyre niveleve.

Qasja sektoriale e zbatuar për sektorin e ujit paraqet një rëndësi të veçantë sa i përket identifikimit të nevojave për investime nga pushteti qendror, pushteti vendor, mundësitë për investime nga partnerët zhvillimorë dhe sektori privat, të orientuara drejt arritjes së objektivave për trembëdhjetë vitet e ardhshme. Përcaktimi i qartë i përgjegjësive në nivel vertikal dhe horizontal, si dhe monitorimi i këtij programi, do të garantonte zbatimin me sukses të tij.

Kapitulli I: QASJA E PËRGJITHSHME NDAJ POLITIKAVE

Në këtë kapitull jepet vizioni, qëllimet dhe objektivat që do të ketë sektori i ujit për periudhën 2018-2030. Këto objektiva janë përcaktuar nga nëngrupet tematike, bazuar në nevojat dhe problematikat që ka secila nga tre shtyllat e sektorit të ujit (përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe mbrojtja nga uji).

Analiza e sektorit paraqet identifikimin e problematikave kryesore të sektorit të ujit, arritjet dhe sfidat e tyre. Fushat e ujit që lidhen me këto shtylla janë analizuar në aspektin e kuadrit ligjor, institucional, burimeve njerëzore dhe atyre financiare dhe sistemit të informacionit. Gjithashtu, në këtë analizë janë marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

Arritja e objektivave referuar shtrirjes në kohë është ndarë në pikësnyime afatmesme dhe afatgjata duke i harmonizuar me dokumentat si më poshtë:

- Pikësnyime deri në vitin 2020, të cilat përkojnë me kohëzgjatjen e SKZHI-së dhe shumicën e strategjive të hartuara;
- Pikësnyime deri në vitin 2027, të cilat përkojnë me ciklin e tretë të përgatitjes së planeve të manaxhimit të baseneve konform direktivës kuadër të ujit;
- Pikësnyime deri në vitin 2030, të cilat përkojnë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UN Sustainable Development Goals – 2030 Agenda).

1.1. Përshkrim i përgjithshëm

Për të pasur një referencë dhe panoramë të përgjithshme të burimeve ujore dhe sektorit të ujit në Shqipëri, më poshtë është bërë një përshkrim i kushteve fiziko-gjeografike, zhvillimit social ekonomik, kushteve klimatike, burimeve ujore dhe shpërndarjes së tyre sipas baseneve ujëmbledhëse.

1.1.1. Kushtet fiziko-gjeografike

Relievi i Shqipërisë është kryesisht malor. Lartësia mesatare e relievit është 708 metra ose dy herë më e lartë se mesatarja e Evropës. Lartësitë më të mëdha gjenden në alpet shqiptare dhe në pjesën lindore (Mali i Korabit me lartësi 2751 metra mbi nivelin e detit, përbën edhe majën më të lartë të Shqipërisë). Territori i Shqipërisë ndahet në 4 rajone të mëdha natyrore (fiziko-gjeografike):

- Rajoni verior dhe verilindor
- Rajoni malor qendror
- Rajoni malor jugor
- Ultësira perëndimore

Shqipëria shtrihet në pjesën jugperëndimore të Ballkanit, në brigjet lindore të detit Adriatik dhe të detit Jon. Në veriperëndim kufizohet nga Mali i Zi (172 km vijë kufitare), në verilindje nga Kosova (115 km vijë kufitare), në lindje nga Maqedonia (151 km vijë kufitare) në jug e

juglindje nga Greqia (282 km vijë kufitare), ndërsa në perëndim ka kufij detarë dhe kufizohet me Italinë. Sipërfaqja e përgjithshme është 28748 km² ndërsa kryeqyteti i saj është Tirana.¹

Shqipëria ka një pozitë të favorshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimin e rrugëve më të shkurtra që kalojnë nga Mesdheu perëndimor për në Ballkan e Azinë e Vogël dhe kontrollon kalimin përmes kanalit detar të Otrantos.

Luginat e saj më të gjëra janë ato të lumenjve Drin, Shkumbin dhe Vjosë, që lehtësojnë, njëkohësisht lidhjen e brendshme të Ballkanit me detin Adriatik si dhe të Azisë së Vogël me pellgun e Mesdheut.

Diversiteti i relievit si rrjedhojë e ndryshimit të lartësisë nga niveli i detit deri në lartësinë 2751 m mbi nivelin e detit, ndikon në ndryshimet e mëdha klimatike, në bimësi, si dhe në dendësinë e vendosjes së qendrave të banuara në drejtim vertikal. Në relievin e tyre mbizotërojnë kodrat dhe malet.

¹ Gjeografia e fizike e Shqipërisë, Tiranë.



Figura 3. Hartë e relievit të Shqipërisë.

1.1.2. *Ndarja administrative*

Referuar ligjit nr. 115/2014, datë 31.7.2014 për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” territori ndahet në 12 qarqe dhe 61 bashki të cilat kanë brenda tyre njësitë administrative respektive.




Figura 4. Harta administrative territoriale e bashkive të Shqipërisë.

1.1.3. Demografia

Popullsia e Shqipërisë (më 1 Janar 2016) është 2,886,026 banorë. Nga kjo popullsi, 1,461,326 janë meshkuj dhe 1,424,700 janë femra. Mosha mesatare e popullsisë është 34.7 vjeç².

1.1.4. Situata ekonomike e Shqipërisë

Sipas vlerësimit ekonomik të Bankës Botërore, Shqipëria bën pjesë në nivelin e lartë të vendeve mesatare. PBB-ja për vitin 2015 është 1400 mld Lek (11.5 mld USD). PBB-ja për frymë është 4587 USD. Investimet e huaja të drejtpërdrejta, si përqindje në raport me PBB-në për vitin 2015 është 9.49%. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit është 1.4%. Deficiti i buxhetit si përqindje në raport me PBB-në është 4 %. Borxhi Publik Bruto si përqindje në raport me PBB-në është 72.2%³.

1.1.5. Burimet ujore në Shqipëri

Burimet ujore janë në formën e lumenjve, liqeneve, ujërave detare, akuifereve, burimeve gjeotermale dhe rezervuarëve artificialë. Furnizimi i këtyre burimeve bëhet nga reshjet atmosferike. Regjimi i reshjeve në Shqipëri është mesdhetar dhe faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në reshjet atmosferike janë vendndodhja gjeografike dhe topografia. Disa faktorë lokale kanë ndikim të madh mbi gradientin e reshjeve. Të tillë faktorë janë: drejtimi mbizotërues i erërave, distanca nga deti, topografia e zonës, si dhe ekspozimi i shpateve.

Sasia më e vogël e reshjeve bie në pjesën juglindore të vendit, ku shumat vjetore arrijnë deri në 600 mm shi, duke u ndjekur nga fusha e Myzeqesë, e cila merr rreth 1000 mm shi në vit. Sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar në Alpet Shqiptare, ku vlerat arrijnë deri në 2800-3000 mm shi në vit. Një rajon me reshje të bollshme është edhe zona malore jugperëndimore, ku sasia e reshjeve arrin deri në 2200 mm shi në vit. Sasia e reshjeve e mesatarizuar në territorin shqiptar është 1480 mm/vit. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë muajve të ftohtë (tetor-mars), me rreth 75% të shumës vjetore. Muaji më i pasur me reshje në gjithë territorin është nëntori, ndërsa muajt më të thatë janë korriku dhe gushti. Një analizë e hartës vjetore të reshjeve tregon se izoipset vjetore ndjekin orientimin jugor të vargmaleve, gjë që tregon për ndikimin e përgjithshëm të gjeografisë mbi reshjet. Një tjetër tipar i kësaj shpërndarje është se shpatet të cilat janë të orientuara nga perëndimi dhe jugperëndimi marrin më shumë reshje se shpatet lindore. Kjo shpjegohet me drejtimin perëndim-lindje të rrugës së masave ajrore që kalojnë në territorin e Shqipërisë.

Volumi mesatar shumëvjeçar i ujit që shkarkohet brenda një viti është 39.22 miliardë m³/vit, nga të cilat 95% shkarkohen në detin Adriatik dhe vetëm 5% në detin Jon⁴. I gjithë territori përshkohet nga shtatë lumenj kryesorë nga lindja në perëndim: Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa.

Pellgu hidrografik i baseneve ujëmbledhëse të Shqipërisë shtrihet edhe jashtë kufijve territorialë të vendit. Ai ka një gjatësi maksimale prej 360 km dhe gjerësi prej 172 km dhe sipërfaqja e përgjithshme e këtij pellgu është 43305 km². Nga këto, 28748 km² janë brenda

2 (Burimi: INSTAT) http://www.instat.gov.al/media/322938/pop_1_janar_2016.pdf

3 (Burimi: INSTAT dhe SKZHI) <http://data.worldbank.org/country/albania>

4 Referuar IGJEUM <http://www.geo.edu.al>

territorit shqiptar. Liqenet zënë 4% të territorit, nga ku mund të përmendim tre liqene të mëdha: liqeni i Shkodrës, liqeni i Ohrit dhe liqeni i Prespës, si dhe 247 liqene të vogla.

Shqipëria ka rreth 476 km vijë bregdetare nga të cilat 326 km në detin Adriatik dhe 150 km në detin Jon. Gjithashtu në ultësirën perëndimore dhe gjatë luginave të lumenjve ka akuiferë të cilët kontribuojnë me rreth 23%⁵ në rrjedhjen totale vjetore. Përgjatë lumenjve janë ndërtuar 630 rezervuar artificialë, të cilët përdoren për ujitje, hidroenergji dhe ujë të pijshëm.

1.1.6. Ekosistemet në Shqipëri

Ruajtja dhe ekzistenca e ekosistemeve natyrore është e lidhur drejtpërdrejt me burimet ujore, jo vetëm në aspektin sasior por edhe në atë cilësor.

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e lartë të ekosistemeve. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, pyje gjethegjere dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine, livadhe, si dhe ekosisteme të larta malore. Në zonën bregdetare të vendit gjenden laguna e Karavastasë, Nartës, Patokut, Vilunit, Kune-Vainit, Orikumit dhe Butrintit, me një sipërfaqe totale prej 150 km², me vlera të mëdha ekonomike dhe ekologjike.

Në Shqipëri gjenden rreth 32% e të gjithë llojeve të florës evropiane, afërsisht 3200 lloje bimësh të larta. Flora shqiptare është e lidhur ngushtë me atë të rajonit të Mesdheut si dhe me florën e Alpeve Evropiane Jugore.

Referuar Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit 2015-2020, në Shqipëri gjenden rreth 91 lloje të kërcënuara në nivel global, ku përfshihen Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), Korani (*Salmo letnica*), Breshka e Detit (*Caretta caretta*), Blini (*Acipenser sturio*) etj, të cilat janë lloje të veçanta për Shqipërinë dhe si të tilla përfshihen në listën e kuqe⁶.

Nga pikëpamja e kufijve hidrologjikë, Shqipëria kontribuon në 8 lumenj të mëdhenj që derdhen në det, të cilat janë si në tabelën në faqen që vijon.

Një pjesë e përrenjve dhe lumenjve shkarkojnë direkt në detin Jon dhe Adriatik, sikurse edhe lumi Drin i Lezhës, i cili nga pikëpamja hidrologjike është një pellg ujëmbledhës i ndarë nga lumenjtë e tjerë.

⁵ Draft Strategjia e Energjisë

⁶ Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mjedisit nr. 1280 datë 20.11.2013

Tabela 1. Të dhënat e baseneve hidrografike të Shqipërisë.⁷

Lumi	Shtrirja	Sipërfaqe natyrore e pellgut ujëmbledhës (km²)	Sipërfaqe e pellgut ujëmbledhës brenda territorit (km²)	Prurja mesatare shumë vjeçare m³/sek	Shtetet kufitare që ndahet baseni
Lumi Drin	<i>Ndërkufitar</i>	14.173	5.973	350	<i>Mali i Zi Kosovë Maqedoni Greqi</i>
Lumi Bunë	<i>Ndërkufitar</i>	5.179	1.025	670	<i>Mali i Zi</i>
Lumi Mat	<i>Kombëtar</i>	2.441	2.441	105	
Lumi Ishëm	<i>Kombëtar</i>	673	673	20	
Lumi Erzen	<i>Kombëtar</i>	766	766	18	
Lumi Shkumbin	<i>Kombëtar</i>	2.445	2.445	59	
Lumi Seman	<i>Kombëtar</i>	5.649	5.649	91	
Lumi Vjosë	<i>Ndërkufitar</i>	6.710	4.365	204	<i>Greqi</i>
Lumi Danub	<i>Ndërkufitar</i>	801.463	200	7.000	<i>ndahet ndërmjet 18 shteteve</i>

⁷ Burimi IGJEUM <http://www.geo.edul.a>




Figura 5. Kufijtë hidrografikë të baseneve ujëmbledhës (punuar nga STKKU).

1.2. Analiza e sektorit të ujit

Analiza e sektorit paraqet fillimisht identifikimin e problematikave kryesore të sektorit të ujit, arritjet dhe sfidat për përdorimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe mbrojtjen nga uji. Fushat e ujit që lidhen me këto shtylla janë analizuar në aspektin e kuadrit ligjor, institucional, burimeve njerëzore dhe atyre financiare dhe sistemit të informacionit. Gjithashtu, në këtë analizë janë marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura në kuadër të zbatimit të reformës së re administrativo-territoriale.

Analiza e burimeve ujore dhe e infrastrukturës nisur nga pikëpamja e përdorimit, impaktit të shkaktuar dhe impaktit të pësuar, është ndarë në tre shtylla kryesore:

- Përdorimi i ujit
- Mbrojtja e ujit
- Mbrojtja nga uji



Figura 6. Paraqitje skematike e sektorit të ujit sipas ndarjes në PKS.

Ndërsa, analiza e qeverisjes së ujit, e cila lidhet me mekanizmat dhe instrumentet në funksion të saj, është kryer duke u bazuar në komponentët që listohen më poshtë:

- Kuadri ligjor
- Kuadri institucional
- Kuadri financiar
- Burimet njerëzore
- Sistemi i informacionit
- Studimet
- Investimet

1.2.1. Përdorimi i ujit

Burimet ujore luajnë një rol kyç në ekonominë e Shqipërisë, pasi përdorimi i tyre gjen vend në të gjithë sektorët e zhvillimit të vendit.

Në Shqipëri rreth 80% e ujit të pijshëm në vend sigurohet nga përdorimi i burimeve ujore nëntokësore. Nga të dhënat e benchmark për 58 shoqëri UK, prodhimi mesatar i ujit është 272 litër/banor/ditë dhe shitja mesatare e ujit nga këto ndërmarrje është 109 litër/banor/ditë. Referuar raportit vjetor të ERRU-së, për vitin 2015, mbulimi në nivel kombëtar me rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm është rreth 80.8% dhe mbulimi me rrjetin e kanalizimeve është 51%. Niveli i humbjeve në sektor është 67% e ujit të prodhuar gjë e cila tregon se pjesa më e

madhe e ujit nuk gjeneron të ardhura. Në nivel kombëtar, mesatarja e orëve të furnizimit me ujë është 12.1 orë/ditë⁸.

Bujqësia është nga përdoruesit kryesorë të ujit, duke përdorur kryesisht ujërat sipërfaqësore, dhe më pak ato nëntokësore. Ujitja dhe kullimi kanë ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor, i cili kontribuon me rreth 19% të PBB-së. Më shumë se gjysma e nevojës totale për ujë në bujqësi sigurohet nga ujërat sipërfaqësore që rrjedhin në lumenjtë dhe përrenjtë e ndryshëm. Pjesa tjetër sigurohet nëpërmjet rezervuarëve artificialë të cilët ofrojnë një kapacitet akumulues prej 560 milion m³ ujë (siguruar nga 626 rezervuarë)⁹. Gjithashtu në zonat e ulëta, në disa raste, sasia e ujit të nevojshëm sigurohet nga burimet e ujërave nëntokësore. Në të ardhmen ky sektor është i kërcënuar përse i përket sigurimit të sasisë së nevojshme të ujit. Kjo, si pasojë e tendencës në rritje të zhvillimit të sektorit, reduktimit të kapacitetit akumulues të rezervuarëve nga mbushja me aluvione, rritjes së normës së avullimit dhe uljes së sasisë vjetore të reshjeve si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Hydroenergjinë, për nga volumi i ujit që qarkullon, mbetet përdoruesi më i madh në vend i burimeve ujore. Nga pikëpamja topografike, Shqipëria ka një rezervë hidroenergjetike të lartë. Kapaciteti teorik i fuqisë së instaluar që mund të sigurohet nga burimet hidroenergjetike vlerësohet të jetë rreth 4000 MW. Bazuar në raportin vjetor të ERRE-es për vitin 2015, fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1687 MW¹⁰. Prodhimi i energjisë elektrike në vend është i bazuar në prodhimin e saj nga burimet hidrike (në vitin 2015, 100% e energjisë u prodhua nga burimet hidrike, e vlerësuar në 5,378,588 MWh), megjithatë, shfrytëzohet ende vetëm 40% e potencialit hidroenergjetik të vendit.

Burimet ujore përdoren edhe në sektorin e industrisë ku mund të përmendim atë ushqimore, të minierave dhe industrinë e lehtë. Industria në Shqipëri është e bazuar përgjithësisht në atë nxjerrëse, sektori i minerareve e hidrokarbureve dhe industria e lehtë përpunuese. Uji përdoret në sektorin e përpunimit të naftës bruto nga dy rafineri, ajo e Ballshit dhe Fierit, furnizimi me ujë i tyre bëhet nga Ujësjellësi i Fierit dhe ai i Ballshit (ky i fundit përdor një sasi prej 700 l/sek nga burimi i Poçemit). Megjithatë në lidhje me këtë sektor nuk ka të dhëna zyrtare të konfirmuara, mbi sasinë e përdorur, edhe pse uji është pjesë e domosdoshme e procesit teknologjik. Nga regjistri kombëtar i lejeve të përdorimit të burimeve ujore (hartuar nga Ministria e Mjedisit deri në qershor 2014)¹¹ në nivel kombëtar, sasia e ujit të përdorur me leje nga industria është rreth 4.5 m³/sek ose rreth 142 milion m³/vit. Për qëllime të ambalazhimit të ujit në shishe referuar këtij regjistri, ambalazhohet rreth 5.4 milion m³ ujë/vit. Megjithatë përdorimi faktik është më i madh se kaq, nisur edhe nga shkalla e informalitetit të përdorimit të burimeve ujore me leje për këto qëllime. Kërkesa për ujë në këtë sektor do të rritet në proporcion me zhvillimin e tij¹².

Referuar Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, struktura bregdetare e vendit, veçanërisht në detin Jon, është e përshtatshme për zhvillimin e akuakulturës. Për shkak të mungesës së të dhënave të plota për këtë sektor, si dhe të mosvendosjes së Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë, është e vështirë të kryhen vlerësime apo planifikime për zhvillimin e sektorit dhe respektimin e standardeve evropiane.

⁸ Raporti vjetor i Entit Rregullator të Ujit http://www.erru.al/doc/ERRU_Raporti_Vjetor_2015.pdf, fq 50 - 53

⁹ Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 - 2020

¹⁰ Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Energjisë http://www.ere.gov.al/doc/Raporti_Vjetor_ERE_2015.pdf

¹¹ <http://www.stkku.gov.al/regjistri-kombetar-i-lejeve-te-perdorimit-te-burimeve-ujit-2/>

¹² Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/plane-pune-dhe-strategjiite/strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020>

Burimet ujore në Shqipëri kanë potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit. Banjat kurative, minerale dhe hidrotermale mund të nxisin turizmin rajonal dhe zhvillimin e vendeve afër tyre. Kjo veprimtari është e pakontrolluar duke qenë se këto burime shfrytëzohen pa planifikim dhe nuk monitorohen. Rrjedhat ujore shfrytëzohen për qëllime rekreacioni ku përfshihen aktivitete si: rafting në lumenj, vozitje me kajak në lum dhe det si dhe banja dielli apo vizita në parqet ujore.

1.2.2. Mbrojtja e ujit

Burimet ujore në vend, për shkak se përdoren për qëllime të ndryshme, janë të ekspozuara ndaj presionit që aktivitete apo veprimtari të ndryshme, të kontrolluara ose jo, ushtrojnë mbi regjimin hidrologjik duke shkaktuar përkeqësim të cilësisë së ujit dhe zvogëlim të rezervave të ripërtëritshme. Presionet e ushtruara mbi burimet ujore klasifikohen në dy kategori, (i) presione brenda territorit, ku përfshihen të gjitha presionet brenda territorit të vendit, dhe (ii) presione jashtë territorit, ku përfshihen të gjitha presionet të cilat ushtrohen në pjesën e sipërme të baseneve ujore, që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

1.2.2.1. Burimet ujore brenda vendit

- Presionet mbi burimet ujore që ndodhen brenda territorit

Me zhvillimin e shpejtë dhe sheshherë të pakontrolluar gjatë dy dekadave të fundit, bazuar në të dhënat e publikuara nga raportet vjetore të gjendjes së mjedisit, cilësia e burimeve ujore është përkeqësuar dukshëm nga shfrytëzimi pa kriter i burimeve, sipërfaqësore dhe nëntokësore, gjë e cila ka çuar në vështirësi të garantimit të ujit për të gjithë përdoruesit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme. Aktualisht është në fuqi VKM nr. 267, datë 7.5.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore", e cila transponon pjesërisht Direktivën 2013/39/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe VKM nr. 246, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore", e cila transponon pjesërisht Direktivën 2008/105/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Megjithatë, në monitorimin periodik që bëhet për burimet ujore në vend, këto norma dhe standarde ende nuk janë vënë në jetë.

Megjithatë, bazuar në raportin e vitit 2015¹³ të gjendjes së mjedisit, ndotja e ujërave sipërfaqësore është në nivele mbi normat e lejuara, kryesisht në afërsi të burimeve të ndotjes, si në zonat industriale ekzistuese, komplekse të dikurshme industriale apo komplekse të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve, etj. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit tregojnë një tendencë negative për disa lumenj që po dëmtohen më së shumti nga shkarkimet e patrajuara të ujërave të ndotura urbane, nga aktivitetet sociale dhe industriale.

Nga rezultatet e monitorimit vjetor që bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për vitin 2015 në mënyrë të përmbledhur gjendja rezulton si më poshtë:

- Monitorimi i lumenjve

Janë monitoruar gjithsej 36 stacione/pika në lumenjtë kryesorë Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë. Rezultatet mesatare të monitorimit në vite tregojnë për një ndikim të dukshëm dhe të qëndrueshëm të shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave të lumenjve. Ujërat e lumenjve vlerësohen alkaline me pH 7.5-8.3 dhe në vlera brenda normës së lejuar (< 8.5). Alkaliniteti i përgjithshëm rezulton në vlera më të larta në lumin e Gjanicës dhe

¹³ Raporti i gjendjes së mjedisit 2015 publikuar nga AKM dhe MM http://akm.gov.al/cil%C3%ABsia-e-mjedisit.html#raporte_publicime

në Drinin e Lezhës. Përmbajtja e NBO₅ si tregues i matjes së ndotjes organike, rezulton me tendencë në rritje nga viti 2010 deri 2015, shkak i të cilit është shkarkimi i ujërave urbane dhe industriale të patrajuara. Lumenjtë më të ndotur në Shqipëri vazhdojnë të jenë lumi i Ishmit dhe ai i Gjanicës. Në gjendje të varfër ose cilësi IV, paraqitet lumi Drin i Lezhës, i cili ndotet nga shkarkimet urbane të qytetit të Lezhës.

- Monitorimi i liqeneve

Janë monitoruar 3 stacione për degët e liqenit të Ohrit dhe 9 stacione monitorimi për liqenin e Ohrit, Shkodrës, Prespës dhe lagunën e Butrintit. Duke u nisur nga vlerat e transparencës, të përmbajtjes së fosforit, të nevojës kimike për oksigjen dhe nevojës biologjike për oksigjen, rezulton se ujërat e liqenit të Shkodrës janë të cilësisë mezotrofike. Liqeni i Ohrit vazhdon të jetë një liqen oligotrofik dhe nuk vihet re tendencë negative në ndryshimin e vlerave të treguesve fiziko-kimikë. Nga analiza e gjithë parametrave të matur në liqenin e Prespës, ujërat e tij rezultojnë të gjendjes mezotrofike.

- Monitorimi i vijës bregdetare

Gjithashtu janë monitoruar 78 stacione për zonën bregdetare Durrës, Vlorë dhe Sarandë¹⁴. Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetare të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të patrajuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte. Mosfunksionimi i impianteve të trajtimit të ujërave urbane si ai i Vlorës, reflektohen në impaktin negativ të ndotjes së ujërave dhe përkeqësimin e gjendjes së cilësisë së ujërave të larjes. Punimet që janë kryer në sistemin e kanalizimeve të ujërave urbane në plazhin e Kavajës, Durrësit, Shëngjinit dhe Qeparoit në lidhjen e kanalizimeve sekondare dhe terciare do të sjellin përmirësim të cilësisë së ujërave larës në këto plazhe. Plazhi i Kavajës dhe ai i Durrësit kanë qënë plazhet më të ndotura, të monitoruara në vite. Nga inspektimet higjieno-sanitare të bëra në terren dhe të dhënat analitike, rezulton se ndërhyrjet në infrastrukturën e kanalizimeve dhe shërbimeve të tjera në dobi të popullatës, kanë sjellë përmirësime të dukshme në cilësinë e ujërave larës, duke ulur ndjeshëm ndotjen e tyre. Këtu përmendim investimet e bëra në infrastrukturë në plazhet e Shëngjinit, Velipojës dhe Durrësit.

- Monitorimi i ujërave nëntokësore

Për sa i përket cilësisë së ujërave nëntokësore, referuar raportit të gjendjes së mjedisit 2015, nuk ka ndotje masive. Në disa shpime në faza të ndryshme të monitorimit shfaqet prezencë e NO₂ dhe NH₄, të cilat janë raste që përsëriten dhe lidhen kryesisht me moszbatimin e zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare. Tendencë në vite e cilësisë për treguesit e ndotjes së ujërave nëntokësore me amoniak, nitrite dhe nitrate nuk është në rritje. Prezenca e ndotjeve lidhet me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare dhe nga shfrytëzimi pa kriter i akuiferëve. Shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ujërave nëntokësore të ndotur është e ulët. Popullsia është e ekspozuar ndaj përdorimit të ujërave të ndotur apo me kriptomëri të lartë, në zonat me tregues të tillë mbi normat e lejuara, në rastet kur janë kryer shpime private dhe kur uji përdoret i patrajuar.

Nga eksperiencat botërore, sektori i bujqësisë karakterizohet si ndotësi më i madh i burimeve ujore. Aktualisht në vendin tonë nuk ka të dhëna apo vlerësime lidhur me shkallën e ndotjes që shkaktohet nga përdorimi i pakontrolluar i pesticideve dhe kimikateve në prodhimin bujqësor. Gjithashtu, nuk ka statistika të sakta për dëmin mjedisor dhe nivelin e ndotjes të shkaktuar nga

¹⁴Marrja e mostrave bëhet në përputhje me metodat ISO dhe laboratorit i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit punon bazuar në Manualin e Cilësisë ISO 17025 si dhe është akredituar për 10 parametrat kryesorë të cilësisë: pH, konduktivitet, mbetjet e ngurta pezull (lënda pezull), BOD dhe COD, nitrite, nitrate, amoniak, ortofosfate, dhe fosfori total.

ky sektor. Aktiviteti i ushtruar nga bujqësia shoqërohet me ndotje dhe prishje të ekuilibrave natyrorë, si dhe shkakton eutrofikimin e trupave ujorë.

Një kërcënim serioz në përkeqësimin e cilësisë së ujërave përbën shkarkimi i patrajtuar i ujërave të ndotura urbane në to. Aktualisht janë ndërtuar nëntë (9) impiante të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, përgjithësisht në zonën bregdetare, nga të cilët tetë (8) janë funksionale. Niveli i trajtimit të nevojshëm, referuar cilësisë të trupave ujore ku këto impiante shkarkojnë, mbetet për t'u analizuar. Mungesa e zonave higjieno-sanitare përbën një faktor negativ në sigurimin e cilësisë së ujit në burim dhe mbrojtjes së tij.

Ndërtimi i një numri të madh hidrocentralesh përgjatë lumenjve është një tjetër kërcënim mjedisor që kërkon vëmendje të posaçme nga Ministria Përgjegjëse për Mjedisin. Në periudhën 2003-2015 janë lidhur 173 kontrata koncesionare për ndërtimin e 502 hidrocentraleve¹⁵. Aktualisht rreth 60% e tyre ende nuk janë ndërtuar ende, por në të ardhmen në mungesë të respektimit rigoroz të kushteve përkatëse të lejeve mjedisore të dhëna, ato mund të kthehen në rrezik për mjedisin dhe ekosistemin nëse nuk respektohen kushtet mjedisore.

Trupat ujorë janë mjediset më të ekspozuara kundrejt këtyre ndotjeve si psh.: ndotja nga hidrokarburet në fushën e Patos-Marinzës, ndotja nga dambat e industrisë minerare, kombinati i metalurgjikut etj. Ende nuk ka një inventar të plotë të këtyre aktiviteteve, dhe rrjedhimisht edhe të ndotjes së shkaktuar, edhe pse zona të tilla janë tashmë të identifikuar si hotspot-e.

Burimet ujore në vendin tonë përdoren edhe për transport detar dhe më pak për atë lumor. Shkarkimet e lëngshme dhe të ngurta në këto mjedisë shpesh kanë çënuar cilësinë e tyre. Monitorimi aktualisht është i limituar vetëm në kontrollin periodik të ndotjes bakterologjike dhe kjo e fundit e shtrirë jo në të gjithë trupat ujorë në nivel kombëtar. Shpesh, në ujërat detare dhe bregdetare, janë evidentuar shkarkime të mbetjeve të ngurta, të ujërave të ndotur nga ujërat e ndotur urbane dhe të vajrave në mjediset ujore, gjatë transportit të mjeteve lundruese vendase dhe të huaja. Sot mungon një inventar i këtyre shkarkimeve. Aktualisht është në proces hartimi Plani Kombëtar për Pastrimin e Ujërave Detare dhe gjithashtu Shqipëria ka një rol aktiv dhe komunikim të vazhdueshëm me Qendrën e Reagimit ndaj Emergjencave të Ndotjes Detare në detin Mesdhe (REMPEC).

Sasia e mbetjeve të gjeneruara në nivel kombëtar është ulur në krahasim me vitet e mëparshme. Megjithatë, manaxhimi i tyre është akoma në nivel të ulët, duke patur parasysh faktin që vetëm 10% e mbetjeve riciklohet. Të gjitha këto mbetje kanë një ndikim të drejtpërdrejt në burimet ujore sipërfaqësore, nëntokësore apo detare.

1.2.2.2. Burimet ujore jashtë territorit

Dy nga lumenjtë kryesorë të Shqipërisë, Drini dhe Vjosa, e kanë burimin jashtë kufijve territoriale të vendit. Në këto kushte, një pjesë e ndotjes është e mbartur nga aktivitetet e vendeve fqinje. Nën ndikimin e këtij presioni janë dhe tre liqenet e mëdhenj (liqeni i Ohrit, liqeni i Shkodrës dhe liqeni i Prespës), kufiri hidrografik i të cilëve shtrihet jashtë kufijve territoriale. Vlerësimi i impakteve mbi këto burime ujore bëhet më i vështirë pasi monitorimi i këtyre aktiviteteve duhet të kryhet në bashkëpunim me vendet fqinje. Marrëdhëniet e bashkëpunimit për manaxhimin e burimeve ujore rregullohen me dispozita të veçanta nëpërmjet marrëveshjeve ndërkufitare, dy apo shumëpalëshe. Detyrimet e vendeve të cilat ndajnë të njëjtat burime ujore rrjedhin nga dispozitat e Konventave nërkombëtare, në të cilat këto vende kanë aderuar.

¹⁵ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore www.akbn.gov.al

- Konventat

Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë këshillojnë dhe sanksionojnë marrëdhëniet e palëve për manaxhimin e ujërave të përbashkëta, si më poshtë:

Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar, e njohur si Konventa ESPOO e vitit 1991; Përcakton detyrimin e përgjithshëm të shteteve që të njoftojnë dhe të konsultohen me njëri-tjetrin në të gjitha projektet e mëdha që mund të kenë ndikim të rëndësishëm negativ në mjedisin përtej kufijve.

Konventa për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese, e njohur si Konventa e Barcelonës. Palët hyjnë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, rajonale ose nën rajonale për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore në Detin Mesdhe, me kusht që këto marrëveshje të jenë në përputhje me këtë Konventë, protokollet dhe ligjin ndërkombëtar.

Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë, e njohur si Konventa Ramsar e vitit 1971, e ndryshuar nga Protokollin i datës 3.12.1982 dhe amendamentet e datës 28 Maj 1987 dhe 13 Korrik 1994.

Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve. Përcakton se çdo marrëveshje në fuqi është e detyrueshme për vendet në të cilat ajo operon dhe duhet të zbatohet me mirëbesim. Kjo Konventë është dokumenti themelor ndërkombëtar që rregullon të gjitha modalitetet nga pika e nisjes deri në pikën përfundimtare të lidhjes së një traktati.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare, e njohur si Konventa e Helsinkit e vitit 1992. Dispozitat e kësaj konvente i këshillojnë vendet, të cilat ndajnë të njëjtat burime ujore, që të reduktojnë dhe kontrollojnë impaktin në nivel ndërkufitar, ti përdorin burimet ujore ndërkufitare në mënyrë racionale dhe të barabartë si dhe të garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Të gjitha vendet palë në këtë konventë duhet ti manaxhojnë burimet ujore të përbashkëta nëpërmjet arritjes së marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe.

- Statusi aktual i marrëdhënieve ndërkufitare

Aktualisht statusi i marrëdhënieve ndërkufitare dhe marrëveshjeve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje është si më poshtë:

“Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë mbi çështjet e ekonomisë ujore” e vitit 1956, është ende në fuqi për shkak të Parimit të Suksedimit, ndonëse dispozitat e saj janë të pazbatueshme.

Ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi aktualisht nuk ka një marrëveshje dypalëshe për ujërat ndërkufitare. Marrëveshja e firmosur në vitin 2002 ka pasur një afat 10-vjeçar dhe nuk është më në fuqi. Mali i Zi ka përcjellë një draft marrëveshje të re për ekonominë ujore e cila është në shqyrtim nga Komisioni i posaçëm i ujërave ndërkufitare dhe do t'i nënshtrohet procedurave ligjore deri në miratim.

Në vitin 2010 është firmosur Memorandumi i Mirëkuptimit “Për rregullimin e regjimit ujor të lumit Drin, Bunë dhe liqenit të Shkodrës, situata pas përmbytjeve”. Qëllimi i firmosjes së këtij memorandumi ishte “për të punuar bashkërisht për realizimin e përsheptuar të projektit të rregullimit të regjimit ujor të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës, Bunës dhe Drinit”.

Në vitin 2008, me Malin e Zi është firmosur Marrëveshja për "Manaxhimin e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës”, e cila ka si qëllim që palët “të punojnë për të siguruar mbrojtje të njëjtë, të integruar për liqenin e Shkodrës, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm

sipas normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian”. Kjo Marrëveshje nuk është zbatuar me rigorozitet nga Palët, pasi Komiteti i liqenit nuk ka funksionuar rregullisht.

Memorandumi i Mirëkuptimit "Për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe parimit të zhvillimit të qëndrueshëm" u nënshkrua në vitin 2003 midis Ministrive respektive të mjedisit.

Midis Shqipërisë dhe Kosovës nuk ka ende një marrëveshje për manaxhimin e ujërave. Fillimi i bashkëpunimit në këtë fushë ishte takimi i mbajtur në vitin 2012, me përfaqësues të ministrive respektive përgjegjëse për çështjet e ujërave. Në fund të takimit, palës së Kosovës iu dorëzua një draft marrëveshje për ujërat ndërkufitare të përgatitur nga pala shqiptare, e cila nuk është zyrtarizuar ende.

Ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë nuk ka ende një marrëveshje mbi manaxhimin e ujërave. Në vitin 2004, është firmosur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet qeverive respektive për manaxhimin e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit. Qëllimi i saj ishte të siguronte mbrojtje të njëjtë, të integruar dhe zhvillim të qëndrueshëm sipas normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian. Në zbatim të dispozitave të saj, është ngritur Komiteti i liqenit, i cili ka funksionuar rregullisht, dhe ka raportuar vazhdimisht në Ministrinë e Mjedisit. Ndërkohë, me qëllim riaktivizimin e marrëdhënieve dypalëshe, Ministria e Mjedisit, në vitin 2013, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, i ka paraqitur Ministrisë përgjegjëse për ujërat të Maqedonisë një draft marrëveshje të re për ujërat ndërkufitare. Ndërmjet dy vendeve ende nuk ka një marrëveshje të firmosur.

Ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë bashkëpunimi për ujërat ndërkufitare ka filluar që në vitet 1980. Edhe pse në mungesë të një marrëveshjeje dypalëshe, Komisioni dypalësh ka qënë aktiv dhe ka zhvilluar takime me palën greke. Në vitin 1985 Komisioni hartoi dhe nënshkroi Rregulloren e “Komisionit të Përbashkët Shqiptaro-Grek për ujërat e lumenjve kufitarë”.

“Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për krijimin e Komisionit të Përhershëm Shqiptaro-Grek mbi çështjet e ujërave të ëmbla ndërkufitare”, u nënshkrua në Athinë, në Prill 2003 dhe ka hyrë në fuqi më 21.11.2005. Qëllimi i marrëveshjes dypalëshe është “bashkëpunimi për mbrojtjen e rrjedhave ujore dhe liqeneve ndërkufitare nëpërmjet krijimit të Komisionit të Përhershëm Shqiptaro-Grek për ujërat e ëmbla ndërkufitare”.

Gjithashtu, në vitin 2003 është firmosur Memorandumi i Mirëkuptimit për "Mbrojtjen e Mjedisit", i cili ka hasur vështirësi në zbatim nga palët.

Marrëveshja trepalëshe “Për shpalljen Rezervë Ndërkufitare Biosferë të Rajonit Ohër-Prepë”, ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë, e firmosur nga pala shqiptare dhe maqedonase në vitin 2012. Momentalisht, ajo nuk është firmosur akoma nga pala greke. Ndërkohë, pala shqiptare ka ngritur në zbatim të saj Komitetin e liqenit të Prepës, por ky komitet nuk është vënë në funksion ende.

Në vitin 2011, ndërmjet Shqipërisë, Greqisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë, u firmos Memorandumi i Mirëkuptimit “Drin - Një vizion strategjik i përbashkët”. Qëllimi i tij ishte “të angazhohen për promovimin e veprimeve të përbashkëta për manaxhimin e integruar të koordinuar të ujërave të përbashkëta të basenit ndërkufitar Drin, si një mënyrë për të ruajtur dhe rikthyer në kushtet e mëparshme ekosistemet dhe shërbimet që ato prodhojnë, si dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në basen”. Në zbatim të memorandumit u ngritën 3 grupe pune të përbashkëta. Ky memorandum parashikon një sërë masash për t’u ndërmarrë nga palët. Këto masa u përkthyen në një plan veprimi, i cili u miratua në vitin 2013.

1.2.3. Mbrojtja nga uji

Përmbytja është një fenomen i përsëritur në Shqipëri, i cili shkaktohet kryesisht si pasojë e kushteve ekstreme hidro-meteorologjike dhe ka ardhur duke u përkeqësuar vitet e fundit, kjo edhe për shkak të ndryshimeve klimatike.

Krahasimisht me vendet e rajonit, Shqipëria është më e prekur nga fenomene të tilla natyrore dhe vlerësohet me risk të lartë. Dëmet më të mëdha të shkaktuara nga përmbytja dhe sidomos si pasojë e intensitetit të lartë të reshjeve në një kohë të shkurtër, kanë ndodhur vitet e fundit, me disa përmbytje ku mund të përmendim, në vitet 2002 dhe 2010 në zonën e nën Shkodrës dhe në vitin 2015¹⁶ në rrjedhën e poshtme të lumit Vjosa.

Megjithëse Shqipëria është e pasur me burime ujore shpërndarja e reshjeve vjetore nuk është e njëtrajtshme gjatë gjithë vitit, pasi vetëm rreth 20% e totalit të reshjeve bie në periudhën e verës. Ky fakt e bën të domosdoshme përbushjen e nevojës për ujtime gjatë kësaj periudhe dhe garantimin e kullimit e rrjedhimisht të mbrojtjes nga përmbytjet gjatë periudhës së dimrit. Mungesa e studimeve, matjeve periodike dhe e buletineve, për periudhën pas viteve 1990 mbi plotat dhe sasinë e reshjeve e bën të vështirë parashikimin dhe modelimin hidraulik të zonave të prirura ndaj përmbytjeve. Lëvizjet demografike dhe zhvillimi urban në mënyrë të pakontrolluar gjatë dekadave të fundit ka rritur ndjeshëm rrezikun ndaj këtij fenomeni. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe mungesa e sistemeve të paralajmërimit zvogëlojnë mundësinë e reagimit në kohë reale për minimizimin e pasojave.

Digat kanë një rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, pasi ato janë struktura kryesore e rezervuarëve të cilët plotësojnë rreth 45 % të nevojave për ujtime, në prodhimin e energjisë elektrike dhe në disa raste për sigurimin e burimit të ujit të pijshëm.

Shqipëria është një nga 90 vendet anëtare të ICOLD-it dhe renditet¹⁷:

- E para për treguesin diga për 10,000 banorë, ose 09 diga/10,000 banorë;
- E 18-ta për numrin e përgjithshëm të digave të mëdha, 306 diga;
- E 20-ta për numrin e digave me lartësi >30 m, 85 diga;
- E 43-ta për numrin e digave me lartësi >60 m, 6 diga;
- Diga e Fierzës është e 75-ta për nga lartësia midis digave më të mëdha të botës, 167 m (150 m-335 m);
- Diga e Bovillës renditet më e larta në botë për llojin e ekranit të aplikuar, me gjeomembranë 90 m.

Duke marrë në konsideratë nivelin e riskut që paraqet dëmtimi i tyre, siguria e digave është një çështje që kërkon vëmendje të veçantë. Kontrollat periodike, në shumicën e rasteve, nuk janë kryer, për mungesë të stafit të kualifikuar dhe buxhetit të nevojshëm. Investimet gjatë këtyre viteve janë orientuar drejt rezervuarëve më të rëndësishëm për zhvillimin bujqësor, gjë e cila ka sjellë një rritje të riskut në pjesën tjetër të digave me më pak interes për bujqësinë. Zhvillimi urban në pjesën e poshtme të disa prej digave ka rritur nivelin e riskut dhe njëkohësisht të sigurisë që ato duhet të kenë.

Gjithashtu janë ndërtuar edhe disa damba për depozitim të sterileve nga minierat, të cilat përbëjnë rrezik serioz për zonat urbane në afërsi të tyre, sikurse edhe janë një burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

¹⁶ Desinventar Albania <http://www.desinventar.net/DesInventar/profiletab.jsp?countrycode=alb>

¹⁷ Referuar të dhënave të regjistrit të digave të mëdha

Erozioni është një tjetër fenomen i cili vendos në presion të vazhdueshëm tokat bujqësore. Terreni malor dhe shpatet e thepisura që karakterizojnë shumicën e territorit, e bëjnë Shqipërinë të ekspozuar kundrejt këtij fenomeni. Të dhënat tregojnë se 25% e tokave bujqësore kanë një rrezik mesatar për erozionin, ndërsa, 75% e tyre kanë një rrezik të lartë. Gjatë dy dekadave të fundit është vlerësuar se janë shpyllëzuar më shumë se 80,000 ha të zonave pyjore, duke krijuar një problem shumë të madh mjedisor.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i inerteve lumore ka sjellë dëmtime shpeshherë të pakthyeshme në shtretërit e lumenjve. Ky fenomen shoqërohet me pasoja afatgjata në dëm të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Erozioni detar është një kërcënim në rritje i përqëndruar përgjithësisht në vijën bregdetare që laget nga deti Adriatik. Referuar imazheve ajrore, gjatë 20 viteve të fundit, vihet re një përparim i konsiderueshëm i detit kundrejt tokës. Ky është një fenomen i nxitur nga prishja e dinamikës së aluvioneve që vjen nga lumenjtë dhe ndërhyrjeve të pakontrolluara në vijën bregdetare. Efekti i ndryshimeve klimatike, ku pritet një rritje e nivelit të detit, ndikon drejtpërdrejt në fenomenin e erozionit. Kjo kërcënon zhvillimin e turizmit bregdetar dhe humbjen e sipërfaqes së tokës.

1.3. Qeverisja e Ujit

Qeverisja e ujit përfshin hartimin dhe zbatimin e politikave të ujit, legjislacionit dhe organizimin institucional, rolin dhe përgjegjësitë e qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat në burimet ujore. Gjithashtu, përfshin gamën e masave, rregullave, organeve vendimmarrëse, shërbimeve të informacionit dhe organeve mbikëqyrëse, të cilat bëjnë të mundur garantimin e funksionimit të duhur dhe monitorimin e sektorit të ujit.

Mënyra e qeverisjes ndikon në jetesën e njerëzve dhe në qëndrueshmërinë e burimeve ujore. Ajo përcakton barazinë dhe efikasitetin në shpërndarjen e burimeve dhe shërbimeve të ujit, dhe balancon përdorimin e tij mes aktiviteteve socio-ekonomike dhe ekosistemeve.

Nisur nga këta elementët është bërë një analizë e situatës aktuale sa i përket qeverisjes së ujit e cila rezulton si mëposhtë.

1.3.1. *Kuadri rregullator*

1.3.1.1. Kuadri ligjor dhe përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian

Kuadri ligjor në sektorin e ujit në Shqipëri, ashtu si edhe në të gjithë sektorët e tjerë, po orientohet tërësisht drejt përafrimit me legjislacionin e BE-së. Në këtë drejtim janë bërë hapa konkrete, duke miratuar një sërë ligjesh të rëndësishme të cilat do t'i japin një shtysë të madhe sektorit.

Kjo ka një rëndësi prioritare, pasi do të bëjë të mundur zbatimin e një sërë reformash të qeverisë, përsa i përket funksionimit të institucioneve ekzistuese dhe atyre të reja, planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, aseteve, burimeve njerëzore, etj. Akoma mbetet shumë punë për t'u bërë, kryesisht në përafrimin e direktivave dhe hartimin e kuadrit ligjor.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me “acquis-in” për mjedisin të BE-së, buron nga Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, neni 70.

Në qershor të vitit 2014, Republika e Shqipërisë mori statusin e vendit kandidat të BE-së. Një nga detyrimet që rrjedh nga ky status është përafrimi i legjislacionit kombëtar me “*acquis-it*” për mjedisin të BE-së.

Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së specifikisht për sektorin e ujit, është një proces i vazhduar, i ndarë në disa faza, i cili koordinohet nga Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Shqipëri. Instrumenti i parë i procesit të monitorimit është plani kombëtar për integrimin evropian (PKIE), një dokument i hartuar çdo vit nga qeveria shqiptare, i cili paraqet të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi apo të parashikuara për miratim, që janë në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së për menaxhimin e ujërave, pjesë e “*acquis*” për mjedisin të BE-së. Instrumenti i dytë është raporti i monitorimit të progresit, i cili përfshin plotësimin e tabelave të përpunueshmërisë së “*acquis*” për mjedisin të BE-së me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare (qofshin këto në proces hartimi apo në fuqi), si edhe plotësimin e pyetësorëve të zbatimit të direktiv përkatëse të BE-së për menaxhimin e ujërave, pjesë e “*acquis*” për mjedisin të BE-së.

Direktiva 2000/60/EC “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave” e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës, e datës 23 tetor 2000 është direktiva kuadër në fushën e politikave të ujit. Referuar nenit 1 të saj, qëllimi i kësaj Direktive është ngritja e një kuadri ligjor për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore të brendshëm, ujërave të përkohshëm, ujërave bregdetare dhe ujërave nëntokësore.

Në Shqipëri statusi i përafrimit me “*Acquis*” së mjedisit të BE-së është si më poshtë:

Direktivat e përafuara me legjislacionin shqiptar:

- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000 për “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU 2013/64/EC dhe 2014/101/EU.
- Direktiva e Këshillit 98/83/EC e datës 3 nëntor 1998 për “Cilësinë e ujit të pijshëm”, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009 si dhe nga Direktiva 2015/1787/EC.
- Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shkurt 2006 për “Manaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes” që shfuqizon Direktivën 76/160/EEC të amenduar me Rregulloren (EC) 596/2009 dhe Direktiven 2013/64/EC.
- Direktiva 2013/39/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 gusht 2013, e cila amendon Direktivën 2000/60/EC dhe 2008/105/EC përsa i përket substancave prioritare në fushën e politikave të ujit.

Direktivat, ende të papërafuara ose në proces përafrimi me legjislacionin shqiptar:

- Direktiva 91/676/EEC e datës 12 dhjetor 1991 për “Mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet e përdorura në bujqësi” amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008.
- Direktiva 2008/56/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 qershor 2008 për “Krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare” (direktiva për kuadrin e strategjisë detare).
- Direktiva 2007/60/EC e datës 23 tetor 2007 për “Vlerësimin dhe manaxhimin e rrezikut nga përmbytjet”.

- Direktiva 2009/90/EC e datës 31 korrik 2009 për “Përcaktimin e specifikimeve teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të tyre”.
- Direktiva 2006/118/EC e datës 12 dhjetor 2006 për “Mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi” amenduar nga Direktiva 2014/80/EC.
- Direktiva e Këshillit 91/271/EEC e datës 21 maj 1991 për “Trajtimin e ujërave të ndotura urbane”, amenduar nga Direktivat 98/15/EC dhe 2016/64/EC, si dhe nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008.

Në plotësimin e kriterëve për standarde evropiane, përgjithësisht Shqipëria i ka plotësuar kërkesat e MSA-së sipas afateve të vendosura dhe rekomandimeve të përbashkëta BE-së dhe Shqipërisë¹⁸.

Deri tani janë draftuar një sërë aktesh nënligjore që përafrojnë direktivat e BE-së, por që ende nuk janë miratuar. Kjo vonesë në procesin e hartimit ka sjellë vështirësi në mbrojtjen dhe manaxhimin e burimeve ujore në nivel baseni, si dhe në qeverisjen e sektorit të ujit në tërësi.

Gjithashtu ka një numër të konsiderueshëm aktesh nënligjore për të cilat ende nuk ka filluar procesi i hartimit të tyre. Kjo ka ardhur kryesisht për arsye të mungesës së ekspertizës dhe financave të nevojshme. Përgjithësisht mungon harmonizimi ndërmjet akteve nënligjore duke krijuar paqartësi për sa i përket fushës së përgjegjësisë dhe mbivendosjes së institucioneve. Kostimi i efekteve financiare që kanë aktet është i vështirë të parashikohet saktësisht pasi mungon metodologjia përkatëse.

Në vijim pasqyrohet një panoramë më e plotë e legjislacionit në vend

Me anë të Ligjit 111/2012 për “Manaxhimin e integruar të burimeve ujore” është përafuar plotësisht Direktiva 2000/60/EC “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e datës 23 Tetor 2000, por ky akt nuk është plotësuar me aktet e nevojshme ligjore për ta bërë të zbatueshëm plotësisht dispozitat e tij. Në lidhje me këtë ligj janë parashikuar ndryshimet, të cilat duhet të përfshijnë jo vetëm përcaktimin e qartë të institucioneve përgjegjëse, por edhe çështje të tjera të paevidentuara ende.

Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 për “Kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, nuk përafuron asnjë direktivë të sipërcituar si dhe nuk rregullon të gjitha aspektet e këtij sektori, pasi fokusi i tij është vetëm kuadri institucional, organizimi dhe funksionimi i Entit Rregullator të Ujit.

Ligji nr. 24/2017 për “Administrimin e ujitjes dhe të kullimit” ka për qëllim të përcaktojë kuadrin institucional, kuadri ligjor, të drejtat dhe detyrat e personave fizik dhe juridik dhe të rregullojë çështjet e transferimit, në fushën e ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytja dhe erozionit. Ky ligj nuk përafuron ndonjë direktivë specifike të BE-së.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 për “Riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” është përafuar pjesërisht me Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23 tetor 2000 “Krijimi i një kuadri në fushën e politikës së ujit”.

Ligji nr 103/2016 për “Akuakulturën” është përafuar pjesërisht me: Rregulloren (BE) Nr. 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, “Mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit”, që amendon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.1954/2003 dhe (KE)

¹⁸ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/plane-pune-dhe-strategjitë/strategjia-kombëtare-për-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020>, faqe 12.

nr.1224/2009 dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.2371/2002 dhe (KE) nr.639/2004 dhe Vendimin e Këshillit 2004/585/KE, Rregulloren e Këshillit (KE) nr.199/2008, datë 25 shkurt 2008, "Mbi vendosjen e një kuadri të Komunitetit për mbledhjen, manaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit", Rregulloren (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, lidhur me Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit, dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.2328/2003, (KE) nr. 861/2006, (KE), nr. 1198/2006 dhe (KE) nr. 791/2007 dhe Rregulloren (BE) nr. 1255/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Ligji nr. 138/2013 për "Energjinë e rinovueshme" të ndryshuar, nuk përafuron asnjë nga direktivat në fushën e ujërave por është përafuar plotësisht me direktivën "Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE".

Ligji nr. 9251, datë 8.7.2004 për "Kodin detar të RSH-së" i ndryshuar, nuk përafuron asnjë nga direktivat në fushën e ujërave.

Ligji nr. 93/2015 për "Turizmin" është në përputhshmëri të pjesshme me shtojcën e Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, "Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve" (neni 2 dhe 3), si dhe pjesërisht me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nr. 692/2011/BE, datë 6 korrik 2011, "Statistikat Evropiane në Turizëm" (neni 3).

Ligji nr.10431, datë 9.6.2011 për "Mbrojtjen e mjedisit" të ndryshuar, është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin".

Ligji nr.9048 datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

VKM nr. 267, datë 07.05.2014 për "Miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore" përafuron pjesërisht direktivën 2013/39/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 gusht 2013, që amendon direktivat 2000/60/KE dhe 2008/105/KE në lidhje me substancat prioritare në fushën e politikave të ujërave.

VKM nr. 246, datë 30.04.2014 për "Përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë" përafuron pjesërisht Direktivën 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 16 dhjetor 2008, "Normat e cilësisë mjedisore në fushën e politikave të ujit".

VKM nr. 379, datë 25.5.2016 për "Miratimin e Rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm" në përafrim të Direktivës 98/83/EC të Këshillit të Europës "Mbi cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit".

Direktiva e Këshillit në lidhje me "Mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes së shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore" datë 12.12.1991, është në fazën fillestare të përafrimit, ku vetëm 4 dispozita të Direktivës janë transpozuar në legjislacionin kombëtar.

VKM nr. 797, datë 29.09.2010 për "Miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për manaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes", përafuron plotësisht Direktiva e Ujërave të Larjes.

Ligj nr. 9700, datë 26.3.2007 për "Mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkuftare" zbatohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar".

Ligji nr. 9103, datë 10.7.2003 për "Mbrojtjen e liqeneve ndërkuftare" është përafuar pjesërisht me Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23 tetor 2000 mbi "Ngritjen e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave".

Ligj nr. 64/2012, datë 31.05.2012 për “Peshkimin” është përafuar pjesërisht me dispozitat e përkatëse të Direktivës 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2000 mbi “Krijimin e një politike kuadër në fushën e ujit.” si dhe me rregulloret e Këshillit të Evropës të kësaj fushe.

Ligj nr. 8756, datë 26.3.2001 për “Emergjencat civile” rregullon, krahas të tjerave, masat që duhen marrë për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që vjen nga fatkeqësitë natyrore si psh, përmbytja.

Ligj nr. 8681, datë 2.11.2000 për “Projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” rregullon kuadrin bazë ligjor dhe institucional, nga i cili do të rrjedhë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për procesin e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave/dambave.

1.3.1.2. Strategjitë

Gjatë viteve të fundit janë miratuar një sërë dokumentash strategjike të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me fushën e ujit.

Këto dokumenta janë ndarë në dy grupe, ato të cilat janë miratuar me aktin nënligjor përkatës dhe ato të cilat janë ende në proces përgatitje, si më poshtë:

Dokumentet strategjike të miratuar:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim është miratuar me VKM-në nr. 348, datë 11.5.2016 për "Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020".
- Strategjia Kombëtare e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve është miratuar me VKM-në nr. 643, datë 14.9.2011 për “Miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017”.
- Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020 është miratuar me VKM-në nr. 709, datë 29.10.2014 për “Miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020”.
- Strategjia Kombëtare e Sigurisë është miratuar me ligjin 103/2014 për “Miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.
- Plani kombëtar i veprimit në zbatim të Strategjisë Rajonale të Evropës Juglindore 2014-2020, është miratuar me VKM-në nr. 611, datë 17.9.2014.
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2015 – 2020 është miratuar me VKM-në nr. 31, datë 20.1.2016 për “Miratimin e dokumentit të politikave të mbrojtjes së biodiversitetit”.
- Strategjia e Kombëtare të Shëndetësisë miratur me VKM nr. 439, datë 17.05.2017 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2016-2020”

Dokumentet strategjike në proces:

- Strategjia Kombëtare për Ujitje – Kullimin dhe Mbrojtjen nga Përmbytja.
- Strategjia Kombëtare e Manaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018 – 2028.
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2017 – 2030.
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Zvogëlimin e Rrezikut të Katastrofave dhe Mbrojtjes Civile.
- Strategjia Kombëtare për Turizmin 2014 – 2020.

Vlen të theksohet se miratimi i këtyre dokumenteve është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e kuadrit strategjik për trajtimin e sfidave me të cilat përballet sektori i ujit. Kryesisht këto strategji po hartohen nga konsulentë të huaj në bashkëpunim me ekspertë vendas.

1.3.2. *Kuadri institucional*

Nga pikëpamja e ndarjes hierarkike ekzistojnë katër nivele kryesore të ndarjes së roleve dhe përgjegjësisë në sektorin publik, të cilat janë: udhëheqës, drejtues, manaxhues dhe operacional. Për sektorin e ujit, institucionet udhëheqëse janë Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Ujit, Komiteti i Planifikimit Strategjik; në nivel drejtues janë ministritë e linjës të lidhura me çështjet e ujit; në nivel manaxherial janë Agjencitë Kombëtare, Bordet Rajonale të Kullimit, këto të fundit kryejnë edhe detyra operationale; në nivel operacional janë autoritetet lokale respektivisht për probleme të ndryshme të sektorit (ndërtim infrastrukturë, mirëmbajtje, rehabilitim etj.).

Për qëllime manaxhimi të burimeve ujore, territori i Shqipërisë ndahet në 6 basene administrative: Drin-Bunë, Mat, Ishëm-Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë. Baseni Drin-Bunë dhe ai i Vjosës e kanë pellgun e tyre hidrologjik të shtrirë përtej kufijve shtetërorë duke e ndarë respektivisht me Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë dhe Greqinë për basenin Drin-Bunë dhe me Greqinë për basenin e Vjosës. Për çdo basen ujqor funksionon Këshilli i Basenit Ujqor, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për manaxhimin e integruar të burimeve ujore, organ ekzekutiv i të cilit është Agjencia e Basenit Ujqor.

Është vënë re se aktorët institucionalë të përfshirë në këtë sektor hasin konflikte kompetencash, në nivel horizontal dhe vertikal, shpesh duke mos respektuar piramidën e ndarjes hierarkike të roleve dhe përgjegjësisë, kjo edhe për pasojë të kuadrit ligjor. Ky manaxhim i fragmentuar ka sjellë edhe një mungesë llogaridhënie dhe mbivendosje apo mungesë të monitorimit të zbatimit të dokumenteve politike apo strategjike.

Në praktikën e përditshme, të zbatimit të detyrave sipas fushës së përgjegjësisë, institucionet hasin vështirësi në përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësisë në sektorin e ujit. Për problematika të caktuara është e vështirë të ndahen qartësisht përgjegjësitë që kanë institucione të ndryshme nisur edhe nga kompleksiteti i sektorit. Është i nevojshëm forcimi i instrumenteve koordinues për të harmonizuar objektivat, ndërmjet sektorëve por edhe brenda tyre, të cilat kanë sjellë izolim të proceseve politikbërëse nga njëri institucion tek tjetri, e për rrjedhojë planifikime në mënyrë të paintegruar. Pasojë e kësaj është ulja e efikasitetit të investimeve të realizuara që shoqërohet me rritje të kostove. Bashkëpunimi i pushtetit qendror me atë lokal është në nivele të ulëta, çka sjell vështirësi në përkthimin e politikave, të përcaktuara nga ministritë e linjës, në veprime konkrete.

Monitorimi është mekanizmi i vetëm për të verifikuar rezultatet e politikave dhe investimeve, dhe mbetet ndër shqetësimet kryesore të të gjithë sistemit. Institucionet e kanë të vështirë të prodhojnë rezultate të integruara që shërbejnë si indikatorë për politikën e sektorit.




Figura 7. Harta administrative e Shqipërisë dhe kufijtë hidrografikë të baseneve ujore.

1.3.3. *Kuadri financiar*

1.3.3.1. *Financimi aktual i sektorit*

Mbështetja financiare në sektorin e ujit paraqet një nga elementët më të rëndësishëm për arritjen e objektivave në këtë sektor. Ashtu sikurse përcaktohet në metodologjinë për hartimin e strategjive sektoriale apo ndërsektoriale¹⁹, kërkohet të bëhet hartimi i planeve buxhetore, sipas Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili konsiston në përgatitjen nga çdo ministri, e planit trevjeçar brenda kufijve të përcaktuar të shpenzimeve dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, si dhe strategjitë sektoriale, ndërsektoriale, Master Planet dhe Planet e Veprimit. Theksojmë se pjesë e rëndësishme gjatë procesit të Programimit Buxhetor Afatmesëm të ministrive të linjës është sigurimi i përfshirjes në buxhet të të gjitha projekteve me financim të huaj, në të cilat ato janë përfituese.

Qëllimi i këtij procesi është të sigurojë një lidhje të qartë midis shpërndarjeve të buxhetit dhe qëllimeve të politikave të programit, duke arritur kështu një parashikim dhe efikasitet më të lartë të shpërndarjes së burimeve financiare. Gjatë dy dekadave të fundit pjesa më e madhe e investimeve në sektorin e ujit është realizuar nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga partnerët zhvillimorë në formën e kredive dhe granteve.

Parashikimi i kostove lokale dhe TVSH-së për projektet me financim të huaj gjithashtu është i domosdoshëm edhe për të respektuar detyrimet nga ana jonë që burojnë nga marrëveshjet kuadër me partnerët zhvillimorë.

Me qëllim përfshirjen e të gjitha kostove të parashikuara për sektorin e ujit, janë identifikuar gjithsej nëntë programe buxhetore të ministrive të linjës si dhe programi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, përkatësisht si më poshtë:

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Programi: Ujësjellës-Kanalizime

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Programi: Manaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes

Programi: Administrimi i ujërave

Programi: Mështetje për peshkim (përfshirë akuakulturën)

Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Programi: Mbështetje për burimet natyrore

Programi: Mbështetje për energjinë

Ministria e Mjedisit

Programi: Mbrojtja e Mjedisit

Ministria e Punëve të Brendshme

Programi: Emergjencat Civile (Mbrojtja nga përmytjet)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Programi: Programe Zhvillimi

Nga një analizë e përgjithshme e këtyre programeve vërehet qartë domosdoshmëria e përcaktimit të saktë të programeve që lidhen dretpërdrejt me sektorin e ujit, për të shmangur mbivendosjet e mundshme, pasi shpesh jo të gjitha projektet apo produktet brenda një programi e sigurojnë këtë lidhje.

¹⁹ Referuar Urdhrit të Kryeministrit nr. 134, datë 12.06.2006

Në Tabelën 2 janë paraqitur vlerat e programeve buxhetore që lidhen me sektorin e ujit sipas të dhënave zyrtare për buxhetet e miratuara për periudhën 2015-2016 si dhe buxhetet e parashikuara për periudhën 2017-2019.

Tabela 2. Të dhënat e financimit të sektorit të ujit sipas programeve (2015-2019).

(në 000 lekë)

BUXHETI I PROGRAMEVE BUXHETORE PËR SEKTORIN E UJIT							
Institucionet	Programi Buxhetor	Buxhet i miratuar		Buxhet i parashikuar			TOTAL
		Buxheti 2015	Buxheti 2016	Buxheti 2017	Buxheti 2018	Buxheti 2019	
MTI	Ujësjiellës Kanalizime	11,659,079	12,972,691	8,996,000	10,770,780	11,268,378	55,666,928
MBZHRAU	Ujitje Kullim	2,624,599	4,505,140	2,376,753	2,199,750	1,630,161	13,336,403
	Administrim i Ujërave	34,842	96,100	312,657	122,600	122,537	688,736
	Mbështetje për Peshkim	485,042	369,474	191,600	199,650	250,547	1,496,313
MM	Mbrojtja e Mjedisit	1,191,234	2,613,274	2,486,803	2,280,492	2,138,859	10,710,662
MPB	Emergjencat Civile	1,483,082	637,856	203,000	414,740	366,387	3,105,065
MEI	Mbështetje për Burimet Natyrore	488,633	457,744	308,500	308,500	277,339	1,840,716
	Mbështetje për Energjinë	96,961	489,345	441,120	336,922	337,254	1,701,602
FSHZH	Programe Zhvillimi	5,985,298	4,247,162	8,550,000	10,240,000	10,362,000	39,384,460
Totali		24,048,770	26,388,786	23,866,433	26,873,434	26,753,462	127,930,885

Burimi: Ministria e Financave

Nga të dhënat për financimin e sektorit, të cilat i referohen buxheteve të miratuara për periudhën 2015-2016 si dhe planifikimit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, rezulton se totali i buxhetit të miratuar për periudhën 2015-2016 është 50,437,556,000 lekë ndërsa parashikimi për tre vitet e tjera 2017-2019 ka vlerën 77,493,329,000 lekë.

Duke ditur se një pjesë e konsiderueshme e investimeve në sektorin e ujit është realizuar nëpërmjet financimit të huaj, tabela më poshtë ofron një informacion më të qartë lidhur me burimin e financimit si dhe shpërndarjen e tyre në nivel programi për periudhën 2015-2019.

Tabela 3. Llojit i financimit për periudhën 2015-2019

(në 000 lekë)

Viti	Shpenzime Korrente	Shpenzime Kapitale		Totali i shpenzimeve buxhetore
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	
Viti 2015	2,969,629	7,157,652	18,357,758	28,485,039
Viti 2016	2,092,380	9,392,678	12,054,050	23,539,108
Viti 2017	2,465,380	7,771,348	12,054,050	22,290,778
Viti 2018	2,465,380	7,771,348	12,054,050	22,290,778
Viti 2019	2,989,350	10,612,111	13,152,000	26,753,461
Totali	2,989,350	10,612,111	13,152,000	26,753,461

Burimi: Ministria e Financave

Sikurse vihet re edhe nga Tabela 3, një pjesë e konsiderueshme e investimeve në sektor realizohen nëpërmjet burimeve të huaja të financimit, të cilat, në raport me totalin e shpenzimeve kapitale llogariten në 55.3% të tyre. Një informacion më i detajuar lidhur me llojin e financimit sipas programeve buxhetore të institucioneve përgjegjëse gjendet në Tabelën 31, Shtojca 4.

Mbështetja që ofrojnë partnerët zhvillimorë në sektor është shumë e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të tij, ndaj është e domosdoshme të maksimizohet kontributi që ata japin në përmbushjen e prioriteteve të sektorit përmes ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me ta.

Ndër partnerët zhvillimorë aktivë që kanë dhënë kontribute të konsiderueshme në sektor mund të përmendim: Bankën Botërore, Delegacionin e Bashkimit Evropian, Gjermania, Italia, Holanda, Austria, Japonia, Zvicra, Suedia, SHBA etj.

Në Tabelën 4 paraqiten në mënyrë të detajuar angazhimet aktuale të partnerëve zhvillimorë në sektor duke theksuar se financimet e dhëna nga partnerët zhvillimorë përfshihen si pjesë e planifikimit buxhetor vjetor, sipas vlerës së financimit vjetor për çdo projekt.

Tabela 4. Të dhënat e financimeve aktuale të partnerëve zhvillimorë sipas llojit të financimit.*(në 000 lekë)*

Donatori	Lloji i Financimit	Vlera totale e financimit	Disbursimi deri në 2016
Gjermania	Grant	130,541,447	67,881,472
	Kredi	345,754,178	150,251,231
Mbretëria e Arabisë Saudite	Kredi	34,020,592	2,797,130
Austria	Grant	10,303,955	5,173,783
	Kredi	26,493,856	19,495,077
BE (IPA)	Grant	506,036,702	324,685,132
BE (WBIF)	Grant	2,450,000	742,497
Italia	Grant	28,254,954	17,455,835
	Kredi	156,375,059	68,861,846
Japonia	Kredi	73,843,440	15,125,491
Hollanda	Grant	2,854,598	2,704,600
Suedia	Grant	46,671,984	23,749,344
Zvicra	Grant	172,465,956	72,543,767
SHBA (USAID)	Grant	89,050,085	71,048,838
Banka Botërore	Kredi	1,035,788,900	90,645,751

Tabela 5 siguron informacion më të detajuar lidhur me këto fonde të dhëna nga partnerët zhvillimorë sipas nënsektorëve, nga ku vërehet se nënsektorët ujësjellës kanalizime dhe ujitje kullimi kanë edhe financimet më të mëdha.

Tabela 5. Të dhënat për financimet aktuale të partnerëve zhvillimorë sipas nënsektorëve.*(në 000 lekë)*

Partenrët zhvillimorë	Nënsektorët	Vlera totale e financimit	Disbursimi deri në vitin 2016
Gjermania	UK	118,274,703	83,696,641
	Mjedis	18,568,058	14,393,058
Mbretëria e Arabisë Saudite	UK	34,020,592	-
Austria	UK	9,798,856	4,446,362
	UK	92,047,653	63,409,602
BE (IPA)	Ujitje kullim	12.400.000	-
	Mjedis (ndryshimet klimatike)	9,700,000	8,008,740
BE (WBIF)	UK	750.000	-
Italia	UK	10,766,000	-
	Mjedis	2,866,191	2,670,551
Japonia	UK	73.843.440	15.125.491
Hollanda	Ndryshimet klimatike & manaxhimi i ujërave	123.800	111.420
Suedia	Ujitje kullim	3,701,530	3,655,402
	Mjedis (ndryshimet klimatike)	15,675,803	9,979,744
Zvicra	UK	22,250,000	17,375,000
SHBA(USAID)	UK	1,236,591	848,546
Banka Botërore	UK	76.770.000	18.255.247
	Ujitje kullim	36.000.000	13,063,489

1.3.3.2. Buxheti i Pushtetit Vendor

Pjesë e rëndësishme për financimin e sektorit është edhe buxheti i pushtetit vendor. Aktualisht struktura e financimit të pushtetit vendor funksionon në trajtën e transfertave, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Financave, si pjesë integrale e buxhetit vjetor të miratuar. Në paketën e buxhetit të vitit 2016 ka pasur edhe disa transferta specifike për bashkitë, ku në lidhje me sektorin e ujit identifikohet vetëm zëri për Ujitje Kullim, ndërsa sa i takon ndërmarrjeve të UK-ve, fondet e akorduara nga buxheti qëndror kanë qënë kryesisht për shlyrjen e detyrimeve të këtyre ndërmarrjeve, për energjinë elektrike apo për pagat e punonjësve. Transferta specifike për financimin e funksioneve të shpërndara sipas bashkive për vitin 2016 për nënsektorin Ujitje Kullim ka vlerën 2,822,500,000 lekë.

1.3.3.3. Situata e koncesioneve në fushën e hidroenergjisë

Në sektorin e ujit një nga format kryesore në ofrimin e shërbimeve është kryesisht në fushën e hidroenergjisë nëpërmjet kontratave koncesionare. Tabela më poshtë paraqet informacion lidhur me kontratat koncesionare dhe numrin e HEC-ve duke filluar nga viti 2002 dhe në vazhdim si dhe vlerën e investimeve të tyre bazuar në Ligjin Nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar.

Të dhënat tregojnë se që prej vitit 2002 e deri tani janë 502 HEC-e nga ku 65% e tyre nuk kanë filluar ende punimet, 15% janë HEC-e në ndërtim dhe pjesa tjetër me 20% janë HEC-e të cilat prodhojnë energji. Vlera totale e këtyre investimeve është 313,450,000,000 lekë.

Tabela 6. Numri i koncesioneve dhe vlera totale e investimit.

Numri i HEC-ve që nuk kanë filluar ende punimet ndërtimore	Vlera e parashikuar e investimeve për HEC-t që nuk kanë filluar ende punimet ndërtimore (në Lekë)	Numri i HEC-ve në ndërtim	Vlera e parashikuar e investimeve për HEC-t në ndërtim	Numri i HEC-ve në prodhim energjie	Vlera e investimeve për HEC-t që prodhojnë energji
327	161.6 mld	73	127.35 mld	102	24.5 mld

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

1.3.3.4. Monitorimi financiar

Monitorimi financiar në sektorin e ujit realizohet kryesisht në nivel dokumentash strategjike dhe mbi realizimin e zbatimit të programeve buxhetore të ministrive të linjës. Një nga mekanizmat monitorues është ai i bazuar në performancën e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale që lidhen me sektorin e ujit. Ky mekanizëm është pjesë e proceseve të Sistemit të Planifikimit të Integruar, duke monitoruar në këtë mënyrë performancën në nivel rezultati të secilit objektivave. Nëpërmjet këtij sistemi synohet sigurimi i një qasje më të mirë midis politikave dhe buxhetimit, duke i reflektuar problemet e identifikuar nga Raporti Vjetor i Monitorimit në programet buxhetore të ardhshme.

Një mekanizëm monitorues, i aplikueshëm vetëm për vlerësimin e performancës së ndërmarrjeve të UK-ve, është Benchmark i cili realizohet periodikisht nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Gjithashtu, një tjetër mekanizëm në monitorimin e financave publike në tërësi, përfshirë edhe ato në sektorin e ujit në veçanti është monitorimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Objekti i punës së këtij insitucioni është përmirësimi i administrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve cilësore dhe raportimit mbi rregullsinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në interes të së mirës publike.

Ndër problemet kryesore që vërehen aktualisht në lidhje me financimin e sektorit është mungesa e një lidhje të qartë midis politikave dhe objektivave me financimet sipas Programeve Buxhetore Afatmesme. Mungesa e një strukture të mirëpërcaktuar ka krijuar shumë vështirësi, jo vetëm në shpërndarjen e fondeve në mënyrë të drejtë me nevojat reale të sektorit, por edhe me grumbullimin e të ardhurave dhe rikthimin e tyre sërish në buxhet.

Bazuar në të dhënat financiare të programeve buxhetore rezulton se edhe brenda një programi jo të gjitha projektet apo produktet lidhen me sektorin e ujit. Ndarja e qartë e programeve buxhetore sipas nënsektorëve të ndryshëm të lidhur me ujin është e vështirë, pasi aktualisht një pjesë e aktiviteteve apo financimeve përfshihen në programe që trajtojnë çështje të ndryshme nga ato të ujit ose në rastin më të keq nuk mund të identifikohen.

Një tjetër problematikë që vërehet dhe që parashtrohet edhe nga raporte apo analiza të ndryshme, lidhet me investimet në sektorin e ujit të lidhura ngushtë me procesin e planifikimit dhe mënyrën e prioritizimit të këtyre investimeve. Në këtë kontekst, sigurimi i bashkëpunimit mes pushtetit qendror dhe atij vendor në përcaktimin e prioriteteve për financim, merr një rëndësi të veçantë, duke mundësuar që buxheti që i alokohet pushtetit vendor të jetë në linjë me këto prioritete, dhe në përputhje me funksionet që mbulohen prej tij.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se, vetë sektori i ujit gjeneron të ardhura nëpërmjet tarifave të përdorimit të burimeve ujore dhe të ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve problemi i evidentuar në këtë rast mbetet alokimi i këtyre fondeve në funksion të sektorit. Aktualisht këto fonde rishpërndahen në buxhetin e shtetit sipas prioriteteve kryesore të vendit duke bërë që këto të ardhura të alokohen edhe në sektorë të tjerë.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm lidhur me mirëmanaxhimin e burimeve të financimit konsiderohet edhe marrja e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare pjesë e së cilës janë edhe të ardhurat që sigurohen nga tarifat e siguruara nga përdorimi i ujit, të cilat grumbullohen dhe administrohen nga vetë ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve kryesisht për kosto operationale dhe mirëmbajtje. Theksojmë se, aktualisht grumbullimi i tarifave përfshirë këtu tarifat e kontratave konçensionare, lejeve mjedisore apo tarifat e përdorimit të burimeve ujore nuk kanë ndarje të posaçme me përjashtim të tarifave të miratuara sipas VKM nr. 662, datë 21.9.2016 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta” dhe VKM nr.876, datë 14.12.2016 “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative”, duke e bërë të vështirë identifikimin e të ardhurave që gjenerohen nga vetë sektori.

1.3.4. *Burimet njerëzore*

Manaxhimi i burimeve njerëzore konsiderohet i rëndësishëm për institucionet publike në vendin tonë përfshirë këtu edhe sektorin e ujit, për shkak të hendekut që ka ekzistuar lidhur me trajnimin e burimeve njerëzore gjatë viteve të kaluara në të cilin kanë ndikuar shumë faktorë me karakter social, ekonomik dhe kulturor gjithashtu.

Nga gjithë informacioni i grumbulluar nga takimet e shumta me punonjës të sektorit të ujit, të të gjitha niveleve qofshin këto qëndrore apo vendore, përfshirë këtu edhe diskutimet në mbledhjet e nëngrupeve tematike si pjesë e mekanizmit të GMIP-së, vërehet se mungon informacioni lidhur me trajnimet e zhvilluara, apo edhe nevojat e tyre për trajnime të mëtejshme.

Gjatë viteve të fundit nuk ka patur studime konkrete lidhur me burimet njerëzore që lidhen drejtpërdrejt me sektorin ujit dhe aq më tepër lidhur me nevojat specifike për trajnime apo kualifikime të tyre. Analizat e kryera janë kryesisht në nivel projektsh duke qënë të pjesëshme dhe duke mos u ndalur në elementët e trajnimit apo certifikimit të punonjësve të këtij sektori. I vetmi studim i plotë²⁰ i cili ofron një informacion të detajuar lidhur me burimet njerëzore të sektorit të ujit është ai i fokusuar tek ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve, për arsye se ato zënë edhe peshën më të madhe të burimeve njerëzore të sektorit. Ky studim veç të tjerash thekson edhe faktin se procesi i trajnimeve apo kualifikimeve të punonjësve të këtij nënsektori nuk ka qënë në nivelet e kërkuara.

Nga informacionet e grumbulluara në sektor lidhur me trajnimet janë evidentuar disa probleme që kanë të bëjnë kryesisht me planifikimin e nevojave për trajnime për punonjësit e këtij sektori, si dhe efektivitetin e këtyre trajnimeve, duke sjellë kështu në vëmendje domosdoshmërinë e ngritjes së një mekanizmi efikas dhe të qëndrueshëm lidhur me këtë çështje. Për këtë arsye, programet e ndërtimit të një sistemi të integruar të ujit duhet të përfshijnë forcimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në nivel qëndror dhe vendor, ku komponentë integralë të ndërtimit të kapaciteteve njerëzore janë arsimi, trajnimi i vazhdueshëm për rritjen profesionale si dhe kërkimi shkencor gjithashtu.

Nga informacionet e marra nga institucionet publike që lidhen me sektorin e ujit por edhe nga analiza e të dhënave të anketës pilot së organizuar në mënyrë të veçantë për këtë çështje, janë evidentuar një sërë problemesh që lidhen me burimet njerëzore sa i takon manaxhimin dhe mirëfunksionimit të tyre. Disa prej këtyre problemeve kryesore të cilat kërkojnë zgjidhje të menjëhershme janë:

- Mungesa e një regjistri unik lidhur me trajnimet e kryera nga punonjësit e sektorit në nivel qëndror dhe lokal. Gjatë këtyre viteve janë kryer trajnime edhe me mbështetjen e partnerëve zhvillimorë por nuk ka një bazë të dhënash unike lidhur me këto trajnime, llojin e tyre apo edhe faktin nëse këto trajnime janë shoqëruar apo jo me certifikime.
- Realizimi i trajnimeve pa u bazuar në nevojat që lidhen me pozicionin e punës. Trajnimet e kryera nuk kanë dhënë rezultate konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale pasi shpesh temat e trajnimeve nuk lidhen me nevojat konkrete të punonjësve por me planifikimin dhe ekspertizën e institucioneve dhe organizatave të huaja që i organizojnë ato.
- Kryerja e trajnimeve pa u shoqëruar me certifikim nëpërmjet testimit të njohurive. Një pjesë e konsiderueshme e trajnimeve të kryera deri më sot nuk janë shoqëruar me certifikime mbi baza testimi por thjesht me certifikatë pjesëmarrje.
- Mungesa e një kalendari të mirëpërcaktuar trajnimesh në nivel kombëtar bazuar në nevojat specifike të punonjësve të këtij sektori. Trajnimet kryhen si rezultat i bashkëpunimit me organizata vendase dhe të huaja të cilat janë trajnime kryesisht periodike dhe me target grupe specifike duke bërë që trajnimet dhe nevojat të mos koordinohen midis tyre ose në rastin më të mirë realizimi i trajnimeve me tema të përgjithëshme madje shpesh herë edhe të përsëritura.
- Pjesëmarrja në trajnime e personave, puna e të cilëve nuk lidhet drejtpërdrejt me temat dhe informacionin e trajnimeve. Shpesh institucionet caktojnë si pjesëmarrës në trajnime apo kualifikime edhe persona ku pozicioni i punës dhe detyrat e tyre nuk lidhen direkt me temat e trajnimeve.

²⁰ *Workforce Snapshot Analysis of Water and Sewage Companies in the light of the "Territorial and Administrative Reform", përgatitur nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Gusht, 2015 dhe financiar nga Austrian Development Cooperation.*

- Paqëndrueshmëria e personelit të trajnuar. Në administratën publike ndodh shpesh që punonjësit e trajnuar nga institucioni largohen nga vendi i punës duke krijuar vështirësi dhe kosto shtesë për trajnimin e punonjësve të rinj.
- Emërimet e punonjësve të rinj shpesh pa arsimin përkatës por edhe pa eksperiencën e duhur apo edhe largimet me karakter politik kanë sjellë gjithashtu paqëndrueshmëri të sektorit duke sjellë edhe keqmanaxhim të tij. Shpesh herë në administratë janë evidentuar largime të punonjësve për të cilët është investuar edhe në drejtim të trajnimit apo kualifikimit të tyre. Nga ana tjetër vërehen mospërputhje të përshkrimit të punës me cilësitë e personave të rekrutuar.

Pra, përfundimisht mund të themi se, deri tani janë gjetur zgjidhje të përkohshme dhe shpesh jo eficiente duke arritur në përfundimin se ka ardhur koha për ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm me qëllim forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore si një nga instrumentat kryesorë që do të realizojë reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për këtë sektor.

Për këtë qëllim ngritja e një dege trajnimi pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike posaçërisht për punonjësit e sektorit të ujit do të ishte një hap i rëndësishëm në funksion të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të sektorit.

1.3.5. *Sistemi i informacionit*

Sistemi i informacionit është një nga komponentët kryesorë të nevojshëm për sektorin e ujit. Informacioni që prodhohet dhe manaxhohet sot mund të konsiderohet i fragmentuar dhe për sektorë të ndryshëm nuk ekziston.

Aktualisht sistemi i integruar i informacionit në Shqipëri ka mangësi, sa i përket kapaciteteve teknike, bazës së të dhënave dhe infrastrukturës së nevojshme. Nisur nga rezultatet e prodhuara nga një pyetësor i plotësuar nga institucionet e evidentuara në fushën e ujit, në shumë institucione mungon një bazë shtetërore të dhënash, informacioni dixhital dhe ai në formatin GIS. Gjithashtu, shkëmbimi ruajtja apo përpunimi i të dhënave ndërmjet institucioneve të ndryshme nuk është gjithmonë një bashkëpunim i kënaqshëm për shkak se mungon një bazë ligjore mbi të cilën këto marrëdhënie të bazohen.

Megjithëse kadastra kombëtare e burimeve ujore është në proces dhe parashikohet të plotësojë një pjesë të madhe të këtij hendeku përse i përket burimeve ujore dhe pjesërisht infrastrukturës, kjo sërish nuk është e mjaftueshme pasi nevojitet që të gjithë sektorët të zhvillojnë sistemet e tyre të informacionit dhe shkëmbejnë të dhënat e tyre në kohë reale. ASIG ka miratuar standardin e hidrografisë në përputhje me direktivën INSPIRE të BE-së.

Në këto kushte është e nevojshme ngritja e një sistemi ndërinstitutional për manaxhimin e informacionit në fushën e ujërave, ku të gjithë aktorët që kanë lidhje direkte ose indirekte me këtë fushë, kontribuojnë me informacionin që disponojnë dhe gjithashtu marrin informacion nga aktorë të tjerë, në bazë të fushës së veprimtarisë që ushtrojnë aktivitetin e tyre. Ky informacion do të jetë i aksesueshëm në një portal të përbashkët.

1.3.6. *Studimet*

Studimet janë baza e të dhënave për hartimin e dokumenteve strategjike, ato shërbejnë për të pasur një planifikim sa më realist dhe të bazuar në kushtet aktuale në një periudhë të caktuar. Ndryshimet institucionale dhe riformatimi i instituteve studimore dhe projektuese të para viteve 1990, në vitet e fundit kanë krijuar një hendek të madh të bazës shkencore në fusha të ndryshme të sektorit të ujit. Këtu mund të përmendim mungesën e të dhënave mbi tendencën e burimeve ujore, referuar sasisë dhe cilësisë, normave të përdorimit të ujit për fusha të ndryshme, duke marrë në konsideratë avancimin e teknologjisë dhe zhvillimin ekonomik sikurse edhe ndryshimin e mënyrës së jetesës. Studime për vlerësimin e statusit të trupave ujore mungojnë dhe nuk ka referenca të sakta shkencore për të gjithë trupat ujqor sa i përket sasisë dhe cilësisë. Megjithatë gjatë 20 viteve të fundit janë hartuar dokumenta strategjik, masterplane, plane veprimi, për fusha të ndryshme të sektorit të ujit, por zbatimi i tyre nuk është bërë në përputhje me sa është parashikuar. Mungesa e referencave shkencore dhe bazës së të dhënave të përditësuara, edhe pse në shumicën e rasteve janë hartuar me ndihmën e konsulentëve të huaj, ka prodhuar dokumente të cilët kanë pasur vështirësi në zbatim. Një problematikë tjetër është gjithashtu mungesa e koordinimit të dokumentave dhe studimeve të ndryshme, si në aspektin e referimit të të dhënave bazë, ashtu edhe në shtrirjen kohore të tyre.

1.3.7. *Investimet*

Investimet zënë peshën më të madhe të shpenzimeve buxhetore në të gjithë sektorët e lidhur me ujin. Ato janë finalizimi i një procesi të gjatë planifikimi dhe procedurash institucionale të cilat në fund të të gjithë këtij cikli japin një perceptim direkt të rezultateve të prekshme. Megjithatë nëse do të kishim të gjithë potencialin financiar për të bërë investime, kjo jo detyrimisht do të sillte rezultate të prekshme. Mungesa e një kuadri institucional dhe planifikimi jo në përputhje me objektivat e parashikuara apo të miratuara, apo investime të izoluara kanë rezultuar shpesh në një mungesë efience të këtyre financimeve. Investime nga nivele të ndryshme qeverisje (pushtet qendror apo pushtet vendor), shpesh janë të pakoordinuara sa i përket planifikimit dhe në rastin më të keq financohen duke mos krijuar sinergji dhe pa arritur rezultatet e parashikuara.

Sa i përket burimeve të financimit mungon një integrim specifik (rreth rezultateve të pritshme), për sektorin e ujit në lidhje me financime që vijnë nga partnerë të ndryshëm zhvillimorë apo mekanizma financiare.

Në planifikimin e investimeve shpesh vihet re një mungesë e përfshirjes dhe planifikimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së këtyre veprave të ndërtuara. Kjo çon në një amortizim më të shpejtë të investimeve, rritje të kostove totale të objekteve. Mungon një mekanizëm i unifikuar institucional dhe teknik, i cili bën të mundur vlerësimin dhe monitorimin e efektivitetit të investimeve për fusha dhe komponentë të ndryshëm ku mund të përmendim impaktin në aspektet mjedisore, sociale dhe ekonomike të këtyre investimeve.

Në këto kushte është i nevojshëm përmirësimi i planifikimit dhe koordinimi i investimeve të cilat parashikohen dhe financohen nga nivele dhe mekanizma të ndryshëm.

1.4. Vizioni

Qeverisja e sektorit të ujit në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.




1.5. Qëllimet dhe Objektivat




Për të realizuar vizionin për një periudhë trembëdhjetëvjeçare (2018-2030) për sektorin e ujit janë identifikuar dhe propozuar tre qëllime, të cilat shprehen në funksion të tre shtyllave të sektorit të ujit: përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe mbrojtja nga uji. Për arritjen e këtyre qëllimeve janë propozuar trembëdhjetë objektiva të cilat tregojnë pozicionimin e sektorit të ujit për këtë periudhë.




Këto tre qëllime prekin ciklin natyror të ujit dhe nuk ndryshojnë pavarësisht kuadrit institucional, i cili ka rolin kryesor në harmonizimin e tyre.

Shtylla	Qëllimi
<i>Përdorimi i Ujit</i>	<i>Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre ndërmjet përdoruesve, duke maksimizuar përfitimet ekonomike në respekt të kushteve mjedisore dhe parimeve të manaxhimit të qëndrueshëm.</i>
<i>Mbrojtja e Ujit</i>	<i>Mbrojtja e ekosistemeve ujore, përfshirë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga ndotja shpërdorimi dhe mbishfrytëzimi, duke mirëkoordinuar të gjitha aktivitetet të cilat shkaktojnë presione mbi to si dhe duke respektuar parimet e manaxhimit të qëndrueshëm.</i>
<i>Mbrojtja Nga Uji</i>	<i>Mbrojtja e popullsisë dhe e pronës nga efektet e pakthyeshme të shkaktuara nga uji, përfshirë këtu përmbytjen dhe erozionin, në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.</i>

Në përcaktimin e objektivave për arritjen e këtyre tre qëllimeve janë marrë në konsideratë, krahas dokumenteve politike dhe strategjike në fuqi apo drafteve në proces të lidhura me sektorin e ujit, edhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UN Sustainable Development Goals 2030), Strategjia e Evropës Juglindore 2014–2020 (Southeast Europe Strategy 2014-2020), MSA shoqëruar me të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrja e statusit të vendit kandidat në BE në 2014, SKZHI 2015-2020 dhe objektivat e Programit të Qeverisë, të cilat paraqiten në tabelën më poshtë.

		Nr.	Objektivat e sektorit	2015	2020	2027	2030
PERDORIMI I UJIT	 FURNIZIMI ME UJË	Objektivi nr. 1	<p>Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim të sigurt dhe të vazhdueshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të sigurt i popullatës: <ul style="list-style-type: none"> në zonën urbane në zonën rurale 	89% 36%	92% 40%	97% 60%	98% 72%
	 LARGIMI I UJËRAVE TË NDOTURA URBANE	Objektivi nr. 2	<p>Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbimin të zonave urbane dhe rurale.</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbulimi me kanalizime i popullatës <ul style="list-style-type: none"> në zonën urbane në zonën rurale 	64% 6%	65% 15%	70% 25%	71% 28%
	 UJITJA	Objektivi nr. 3	<p>Përmirësimi i sistemeve ujëtare për tokat e ujëtare bujqësore me synim plotësimin e nevojave të fermerëve me ujë, për të ofruar kushte optimale për rritjen e kulturave bujqësore.</p>	135,000 ha	250,000 ha	330,000 ha	360,000 ha
	 KULTIVIMI I TOKAVË BUIQËSORE	Objektivi nr. 4	<p>Përmirësimi i sistemeve të drenazhimit për sipërfaqet e ujëtare bujqësore, me synim garantimin e kushteve optimale për rritjen e kulturave bujqësore.</p>	130,000 ha	272,000 ha	280,000 ha	280,000 ha
	 AKUAKULTURA	Objektivi nr. 5	<p>Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA), me synim zhvillimin e ekonomive të akuakulturës duke respektuar kushtet mjedisore.</p>	0%	60%	100%	100%
	 HIDROENERGJIA	Objektivi nr. 6	<p>Shfrytëzimi i potencialeve hidroenergjetike, me synim rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të burimeve ujore për hidroenergji, duke pasur parasysh detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare duke respektuar kushtet mjedisore.</p>	45%	80%	80%	80%
	 UJË PËR INDUSTRI	Objektivi nr. 7	<p>Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve përkatëse, si dhe duke respektuar kushtet mjedisore.</p>	100% e kërkesës	100% e kërkesës	100% e kërkesës	100% e kërkesës

	Nr.	Objektivat e sektorit	2015	2020	2027	2030	
MBROJTJA E UJIT		Objektivi nr. 8	Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë”, për ato trupa ujqorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat sipërfaqësore-lumenj, liqene, ujëra tranzitore/kalimtare, trupa ujqorë artificialë dhe shumë të modifikuar).	-	10%	20%	25%
		Objektivi nr. 9	Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht të mirë, për ata trupa ujqorë që kanë status “më pak se mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët” (ujërat nëntokësore).	-	-	20%	25%
		Objektivi nr. 10	Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht “e mirë” për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetar e kalimtar).	-	-	20%	25%

		Nr.	Objektivat e sektorit	2015	2020	2027	2030
MBROJTJA NGA UJI		Objektivi nr. 11	<p>Reduktimi i rrezikut nga përmbytja për humbjen e jetës së banorëve të kërcënuar, dëmtimin e aseteve ekonomike, veprave publike, aseteve kulturore dhe vlerave mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve.</p>	14000 banorë të prekur	9000 banorë të prekur	7000 banorë të prekur	6000 banorë të prekur
				1100 ndërtesa të prekura	700 ndërtesa të prekura	500 ndërtesa të prekura	400 ndërtesa të prekura
				5900 ha të prekura	4800 ha të prekura	4000 ha të prekur	3600 ha të prekur
		Objektivi nr. 12	<p>Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e digave në përputhje me kushtet teknike, sipas rekomandimeve të ICOLD-it, me synim rritjen e sigurisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre, të cilat shfrytëzohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ujitjen e tokave bujqësore; • hidroenergji; • furnizim me ujë. 	130 diga 10 diga 2 diga	240 diga 10 diga 2 diga	540 diga 10 diga 2 diga	540 diga 10 diga 2 diga
		Objektivi nr. 13	<p>Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit me synim mbrojtjen e tokave me rrezik të lartë erozioni duke forcuar infrastrukturën përkatëse në përgjigje të këtij fenomeni.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit për: <ul style="list-style-type: none"> ○ Zonat pak të rrezikuara (20% e territorit) ○ Zonat shumë të rrezikuara (70% e territorit) 	5 t/ha/vit 20 t/ha/vit	4.5 t/ha/vit 18 t/ha/vit	3 t/ha/vit 15 t/ha/vit	2.5 t/ha/vit 13 t/ha/vit

1.6. Parimet e përgjithshme për qeverisjen e sektorit të ujit

Parimet mund të konsiderohen kuadri rregullues i mënyrës së qeverisjes së sektorit dhe orientimit të investimeve. Këto parime kanë për qëllim të japin një kornizë të qartë për zhvillimin e politikave, duke zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse. Ato shërbejnë si një platformë orientuese për ruajtjen e standardeve në gjithë procesin e hartimit të politikave, kuadrin ligjor dhe institucional, orientimin e financimeve dhe monitormit të vazhdueshëm të përputhshmërisë. Në çdo rast këto parime mbeten të përgjithshme duke gjetur zbatim në çdo sektor të lidhur me ujin.

Efektiviteti ka të bëjë me kontributin që jep qeverisja në përcaktimin e objektivave dhe indikatorëve të qartë dhe të qëndrueshëm të sektorit të ujit, në të gjitha nivelet e qeverisjes, zbatimin e tyre dhe arritjen e këtyre objektivave.

Eficienca ka të bëjë me kontributin që jep qeverisja për të maksimizuar benefitet e manaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe mirëqënies, me koston më të ulët për shoqërinë dhe mjedisin.

Angazhimi dhe besueshmëria ka të bëjë me kontributin që jep qeverisja në ndërtimin e besueshmërisë së publikut të gjerë dhe garantimin e gjithëpërfshirjes së grupeve të interesit nëpërmjet legjitimitetit demokratik dhe drejtësisë për shoqërinë.

Në vijim, paraqiten parimet për zbatimin rigoroz të tyre, nga të gjithë grupet e interesit të përfshirë në sektorin e ujit.

Rritja e efektivitetit në qeverisjen e ujit

- Shpërndarja dhe ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësi për të gjitha nivelet e qeverisjes: udhëheqës, politikbërës, manaxhues dhe operacional në sektorin e ujit, si dhe përsheptimin e koordinimit ndërmjet këtyre autoriteteve përgjegjëse.
- Qeverisja “e vogël” e ujit.
- Manaxhimi i ujit në nivel baseni ujqor duke mundësuar një vendimmarrje gjithëpërfshirëse të politikave kombëtare, qeverisjes vendore, përdoruesve të ujit, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile.
- Inkurajimi i politikave koherente nëpërmjet koordinimit efektiv ndërsektorial, veçanërisht ndërmjet politikave për ujin dhe mjedisin, shëndetësinë, bujqësinë, industrinë, planifikimin hapësinor dhe përdorimin e tokës.
- Përshtatja e nivelit të kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse me natyrën komplekse të sfidave të sektorit, si dhe me grupin e kompetencave për zbatim, me qëllim realizimin e detyrave të tyre.

Rritja e eficiencës në qeverisjen e ujit

- Hartimi, përditësimi dhe shkëmbimi i të dhënave, informacioneve dhe politikave të krahasueshme, në kohë reale dhe konsistente, të lidhura me sektorin e ujit, si dhe përdorimi i tyre për të drejtuar, vlerësuar dhe përmirësuar politikën e ujit.
- Garantimi i një kuadri qeverisës që ndihmon për të mobilizuar financimin e sektorit të ujit dhe shpërndarjen e burimeve financiare në mënyrë eficiente, transparente dhe në kohë reale duke aplikuar dhe masat incentivuese.
- Garantimi që kuadri rregullator për manaxhimin e ujit të zbatohet në mënyrë efektive dhe të forcohet në ndjekje të interesit të publikut të gjerë.
- Aktet ligjore dhe nënligjore të jenë të harmonizuara dhe në një numër të kufizuar me qëllim përfshirjen brenda një akti ligjor/nënligjor trajtimin e një numri sa më të lartë çështjesh për aspekte të ngjashme.

- Promovimi dhe aplikimi i praktikave më të mira të modeleve inovative të qeverisjes së ujit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, niveleve të qeverisjes dhe grupeve të ndryshme të interesit.

Rritja e besueshmërisë dhe angazhimit në qeverisjen e ujit

- Drejtimi i praktikave të integritetit dhe transparencës midis politikave të sektorit të ujit, institucioneve të lidhura me ujin dhe kuadrit të qeverisjes së ujit për një llogaridhënie më të madhe dhe besueshmëri në proceset vendimmarrëse.
- Promovimi i angazhimit të grupeve të interesit të mirë-informuara dhe të orientuara për të rritur mundësinë e dhënies së kontributeve në përgatitjen e politikave të ujit dhe zbatimin e tyre.
- Ngritja e një kuadri qeverisës i cili ndihmon në manaxhimin e konflikteve ndërmjet përdoruesve të ujit, planifikimit dhe zhvillimit urban dhe rural dhe gjeneratave.
- Në përmbushje të detyrimeve sipas sanksioneve të përcaktuara në legjislacionin vendas dhe atë Evropian, duhet të bëhet çdo përpjekje për të krijuar marrëdhënie dhe bashkëpunim maksimal në kontekstin ndërkufitar.
- Promovimi i monitorimit dhe vlerësimit të rregullt për politikën e ujit dhe qeverisjen aty ku shihet e nevojshme, ndarjes së rezultateve me publikun e gjerë dhe përmirësimin aty ku nevojitet.

1.7. Risqet e programit

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit është një dokument planifikues, ku jepet vizioni dhe korniza kryesore e perspektivës së sektorit të ujit për 13 vitet e ardhshme dhe ku përfshihen të gjitha nivelet e qeverisjes së ujit. Në këtë dokument trajtohen një numër i madh aktesh ligjore dhe nënligjore, prandaj zbatimi i tij, kërkon angazhimin e shumë institucioneve të nivelit qendror dhe vendor, kapacitete të përshtatshme, një sistem të integruar informacioni, vendosjen në dispozicion të një sasive të madhe burimesh financiare dhe zbatimin e duhur të investimeve.

Nisur nga ky kompleksitet, vlerësojmë që zbatimi në praktikë i tij mund të ndeshë pengesa të ndryshme. Në vijim, gjendet një analizë e përgjithshme e risqeve me të cilat mund të përballet ky program.

1.7.1. Risqe për kuadrin ligjor dhe nënligjor

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit mund të hasë pengesa ligjore në formën e vonesave në hartimin dhe miratimin e akteve nga institucionet përgjegjëse, apo konflikteve ligjore lidhur me kompetencat ligjhartuese.

Për shmangien e këtyre vështirësive rekomandohet paraprakisht marrja e masave me natyrë ligjore nga drejtoritë përkatëse të institucioneve përgjegjëse dhe zgjidhja e konflikteve ligjore ndër-institucionale.

1.7.2. *Risqe për kuadrin institucional*

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit mund të hasë pengesa institucionale në formën e: mungesës së vullnetit politik nga niveli drejtues; vështirësive në perceptimin e qasjes që sjell ky dokument; vështirësive në përcjelljen e qasjes në institucionet e varësisë në nivel qendror dhe lokal.

Për shmangien e këtyre vështirësive rekomandohet komunikim i ngushtë ndërinstitucional i nëngrupeve tematike dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, si institucioni koordinues i hartimit dhe zbatimit të PKS-së, i cili do të mbështesë çdo institucion të përfshirë gjatë këtij procesi.

1.7.3. *Risqe për kapacitetet njerëzore*

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit mund të hasë pengesa lidhur me kapacitetet njerëzore në formën e: pamjaftueshmërisë numerike të stafeve; mungesës së stafit të kualifikuar; mungesës së mekanizmave motivues për vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

Për shmangien e këtyre vështirësive rekomandohet marrja e masave nga institucionet përgjegjëse për: shtimin e stafeve, plotësimin e stafit me kapacitete njerëzore të përshtatshme dhe të kualifikuara për pozicionet e punës, ndërmarrjen e programeve të trajnimit dhe kualifikimit të mëtjshëm dhe zbatimin e ligjit për nëpunësin civil ose Kodit të Punës, sipas rastit.

1.7.4. *Risqe për kuadrin financiar*

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit mund të hasë pengesa financiare, për të zbatuar masat e parashikuara në këtë dokument.

Për shmangien e këtyre vështirësive rekomandohet marrja e masave përkatëse në parashikimet buxhetore vjetore të institucioneve përgjegjëse sikurse koordinimi i programeve dhe strategjive të ndryshme të financimit nga donatorët për të patur burime financiare të mjaftueshme për realizimin e masave të parashikuara në këtë dokument.

1.7.5. *Risqe për informacionin*

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit mund të hasë pengesa në lidhje me shpërndarjen e informacionit midis institucioneve qendrore, midis institucioneve vendore apo midis institucioneve qendrore dhe vendore. Mungesa e informacionit në kohën e duhur dhe cilësinë e kërkuar, kompromenton zbatimin e masave të parashikuara në këtë dokument.

Për shmangien e këtyre vështirësive rekomandohet respektimi i legjislacionit në fuqi për komunikimin zyrtar. Vënia në funksion e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore pritet që të ndikojë pozitivisht në këtë proces.

1.7.6. *Risqe për investimet*

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit mund të hasë pengesa në formën e moszbatimit të investimeve të parashikuara në kohën e duhur ose në cilësinë e duhur.

Për shmangien e këtyre vështirësive rekomandohet marrja e masave nga institucionet përgjegjëse për zbatimin në kohë dhe në cilësi të investimeve duke siguruar burimet financiare të nevojshme, burimet njerëzore dhe shkëmbimin e informacionit.

Kapitulli II: STRATEGJIA DHE PLANI I MASAVE

Për të arritur objektivat për sektorin e ujit, për periudhën 2018-2030, nga anëtarët e nëngrupeve tematike janë propozuar një sërë masash të nevojshme. Programi i masave është tërësia e veprimeve me karakter qeverisës, studimor dhe infrastrukturor të cilat duhet të ndërmerren brenda një periudhe 12-vjeçare dhe të integrohen me njëra-tjetrën, në funksion të arritjes së secilit nga objektivat e parashikuar në program.

2.1. Struktura e masave

Programi i masave është hartuar në funksion të arritjes së objektivave të vendosura për periudhën afatmesme (2018-2020) dhe afatgjatë (2021-2030). Masat janë instrumentet kryesore ku mbështetet arritja e objektivave. Tërësia e masave të identifikuara japin orientimin e duhur të veprimeve dhe proceseve që duhet të ndërmerren brenda një periudhe 12-vjeçare, në funksion të arritjes së objektivave të sektorit të ujit.

Këto masa, për nga natyra e tyre, janë ndarë në dy kategori:

1. Masa me karakter qeverisës, ku përfshihen masa të lidhura me kuadrin institucional, kuadrin ligjor, sistemin financiar, burimet njerëzore dhe informacionin.
2. Masat infrastrukturore, ku përfshihen studimet e nevojshme dhe investimet konkrete.




Figura 8. Struktura e masave për zbatimin e Programit Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit.

Është e domosdoshme që masat qeverisëse dhe masat infrastrukturore, të zbatohen paralelisht me njëra-tjetrën, pasi në mungesë të vëmendjes tek secila prej tyre, objektivat bëhen të pa arritshëm. Për secilën masë përcaktohet institucioni lider, i cili udhëheq procesin, sikurse edhe institucionet e tjera, të cilat, në fushën e tyre të veprimtarisë kanë ndërthurje me masën përkatëse.

Gjithashtu për secilën nga masat është përcaktuar kohëzgjatja dhe kosto e përafërt. Për studimet dhe një pjesë të masave qeverisëse me karakter rregullator dhe institucional, është synuar që të përfundohen brenda periudhës afatmesme 2018-2020. Kjo për faktin se këto kanë një rol të rëndësishëm në planifikimin e infrastrukturës së nevojshme, për të zbatuar PKS-në në tërësi. Në rastin kur kemi masa qeverisëse, të cilat janë objekt i ndryshimeve dhe rishikimeve të vazhdueshme, por që nuk mund të identifikohen në këtë fazë (psh. kuadri ligjor, direktivat e rishikuara të BE-së, studime të nevojshme në mënyrë të vazhdueshme etj.), është pranuar një kosto shtesë për vitet në vazhdim e cila varion nga 20%-50% të kostos së identifikuar për periudhën afatmesme.

Nisur nga fakti që disa prej masave qeverisëse, studimet dhe investimet kanë mundësi të grupohen me njëra-tjetrën në mënyrë që të krijojnë një sinergji dhe eficiencë më të mirë për të gjithë sektorin. Për lehtësi të kuptimit të këtij programi, më poshtë janë identifikuar disa masa të grupuara:

1. Kuadër ligjor i harmonizuar dhe i plotësuar me të gjithë aktet nënligjore.
2. Transpozim i direktivave të BE-së, me kuadrin ligjor kombëtar.
3. Forcimi i strukturave drejtuese / politikëbërëse.
4. Forcimi i strukturave manaxheriale.
5. Forcimi / ngritja e strukturave operationale (qendrore / vendore).
6. Forcimi i strukturave të kontrollit dhe zbatueshmërisë së ligjit.
7. Forcimi i strukturave të kërkimit shkencor dhe monitorimit.
8. Forcimi i kapaciteteve njerëzore.
9. Ngritja e një sistemi të integruar informacioni.
10. Ndërtimi i sistemeve të qendrueshme financiare.
11. Koordinimi ndërinstitutional për t'iu përgjigjur sfidave të integrimit Evropian në sektorin e ujit.
12. Hartimi i studimeve për sektorin e ujit.
13. Koordinimi i investimeve infrastrukturore.

2.2. Masat e grupuara dhe plani total i masave

Më poshtë jepen masat e grupuara qeverisëse dhe infrastrukturore, për të cilat është përcaktuar qëllimi i masës, indikator, institucioni udhëheqës dhe kohëzgjatja për zbatimin e saj. (Tab. 7).

Programi i plotë i masave qeverisëse për arritjen e objektivave për sektorin e ujit, 2018-2030 paraqitet në tabelën 8, ndërsa programi i masave infrastrukturore paraqitet në tabelën 9.

Tabela 7. Masat e grupuara.

1	KUADËR LIGJOR I HARMONIZUAR DHE I PLOTËSUAR ME TË GJITHË AKTET NËNLIGJORE
Qëllimi	Rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe plotësimi me aktet e nevojshme nënligjore, për t'ua bërë të zbatueshëm në të gjithë sektorët. Këto akte duhet të jenë në harmoni me afatet, termat, përgjegjësitë dhe të shmangin mbivendosjet duke krijuar sinergji me kuadrin ligjor të fushave të ndryshme.
Institucioni përgjegjës	Ministri përgjegjës për legjislacionin apo marrëdhëniet me parlamentin
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Synohet që fillimisht të plotësohet legjislacioni aktual me aktet nënligjore të nevojshme për ti bërë ato funksionale nga të gjitha institucionet përgjegjëse. Gjithashtu në të njëjtën kohë duhet të fillojë edhe rishikimi i legjislacionit për ato fusha në të cilat janë hasur vështirësi gjatë zbatimit të tyre. Ministrinë përkatëse sipas fushave të përgjegjësisë draftojnë aktet ligjore dhe nënligjore, në përputhje me detyrat e përcaktuara në planet e veprimit. Ky proces do të ndiqet dhe koordinohet nga Ministria përgjegjëse për legjislacionin apo marrëdhëniet me parlamentin. Është e rëndësishme që problematikat dhe temat specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit. Në planet e veprimit, hartimi i këtyre akteve duhet të jetë i harmonizuar sa i përket kronologjisë së zbatimit të tyre.
2	TRANSPOZIM I DIREKTIVAVE TË BE-SË, ME KUADRIN LIGJOR KOMBËTAR
Qëllimi	Traspozimi i direktivave të BE-së me kuadrin ligjor shqiptar, duke përshtatur këto standarde me kushtet e vendit, zhvillimin socio-ekonomik, kuadrin institucional dhe kushtetues. Pjesë e kësaj mase është edhe ratifikimi i konventave, protokolleve dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkufitare. Këto akte duhet të jenë në harmoni me afatet, termat, përgjegjësitë dhe të shmangin mbivendosjet duke krijuar sinergji me kuadrin ligjor të fushave të ndryshme.
Institucioni përgjegjës	Ministria përgjegjëse për Integrimin Evropian
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Synohet që direktivat të cilat nuk janë transpozuar ende, të fillojnë të përshtaten me akte nënligjore nga të gjitha institucionet përgjegjëse. Gjithashtu rishikimi i akteve ligjore duke i përputhur me direktiva të cilat mund të jenë rishikuar nga BE-ja. Këto masa duhet të harmonizohen me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), dhe të raportohet ecuria e tyre në progres raportet vjetore. Është e rëndësishme që problematikat dhe temat specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit. Në planet e veprimit, hartimi i këtyre akteve duhet të jetë i harmonizuar sa i përket kronologjisë së zbatimit të tyre.
3	FORCIMI I STRUKTURAVE DREJTUESE / POLITIKBËRËSE
Qëllimi	Zbatimi i suksesshëm i Programit Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit shoqërohet me një ngarkesë të shtuar sa i përket detyrave dhe akteve ligjore që duhet të plotësohen dhe hartohen. Niveli drejtues duhet të forcojë dhe riorganizojë kur është e nevojshme, në zbatim të PKS-së, strukturat që hartojnë politika, legjislacionin, standardet dhe rregulloret për fushat e përgjegjësisë që ato mbulojnë në sektorin e ujit.
Institucioni përgjegjës	Këshilli i Ministrave / ministrinë e linjës
Kohëzgjatja	2018-2020

Në vëmendje	Fillimisht do të bëhet vlerësimi i ngarkesës së stafëve aktuale duke harmonizuar volumin e punës, me numrin dhe profilet e punonjësve. Ministrinë përkatëse duhet të propozojnë strukturën e nevojshme në funksion të zbatimit të PKS-së për secilin nga sektorët që drejtojnë. Gjithashtu ato duhet të propozojnë rregulloret e funksionimit, sipas një standardi të unifikuar. Është e rëndësishme që propozimet specifike të diskutohen dhe konsultohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit.
4	FORCIMI I STRUKTURAVE MANAXHERIALE
Qëllimi	Forcimi i strukturave manaxheriale është shumë i rëndësishëm dhe një nga hallkat kryesore të kuadrit institucional. Ky është niveli qeverisës i cili lidh politikën dhe investimet e pushtetit qendror me ato të pushtetit vendor. Të gjithë ministrinë e linjës në sektorin e ujit duhet të konfigurujnë në mënyrën e duhur përfaqësimin e këtij niveli qeverisës, për manaxhimin e furnizimit me ujë, ujitjen dhe kullimin, hidroenergjinë, industrinë, akuakulturën, sigurinë e digave, mbrojtjen nga përmbytjet, sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore etj. Këto struktura do të zbatojnë politikën dhe udhëzimet nga ministrinë përkatëse, do të aplikojnë matricat e prioritizimit për projekt propozimet që vijnë nga niveli operacional, duke propozuar listën e prioritizuar të projekteve për secilin nga sektorët që ata mbulojnë.
Institucioni përgjegjës	Ministrinë përkatëse të linjës / Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore
Kohëzgjatja	2018-2020
Në vëmendje	Fillimisht do të vlerësohet forcimi i strukturave aktuale brenda mundësive dhe kapaciteteve njerëzore që ato kanë për të zbatuar PKS-në. Në rastet kur strukturat manaxheriale në nivel lokal rezultojnë me kapacitete të dobëta sa i përket aftësive teknike, fillimisht mbështetja teknike e tyre do të bëhet nga një bërthamë e specializuar në nivel kombëtar. Degët e tyre në nivel basenesh/qarqesh/rajonesh do të funksionojnë si zyra lokale duke ndjekur nga afër problematikat e ndryshme sipas fushës së përgjegjësisë. Konsulenca teknike mbi projekte, plane dhe studime do të jepet nga këto bërthama teknike të cilat fillimisht do të ngrihen apo ristrukturohen për secilën nga fushat e ujit. Vendimmarrja për burimet ujore do të bëhet nga Këshillat e baseneve në nivel lokal sipas fushës së përgjegjësisë që ato kanë. Për sa i përket perspektivës, gradualisht do të fillojë forcimi i strukturave manaxheriale në nivel baseni duke tentuar drejt autonomisë së qeverisjes së basenit dhe pavarësisë financiare, për ata sektorë për të cilët rikuperimi i kostove është fizibël deri në përfundim të këtij programi. Është e rëndësishme që problematikat dhe temat specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit.
5	FORCIMI / NGRITJA E STRUKTURAVE OPERACIONALE (QENDRORE / VENDORE)
Qëllimi	Forcimi/ngritja e strukturave të dedikuara për sektorin e ujit në secilën bashki/rajon/basen do të plotësojë hendekun institucional të krijuar edhe nga reforma e decentralizimit të disa shërbimeve në pushtetin vendor. Këto struktura janë më afër përdoruesve të ujit dhe duhet të forcojnë kapacitetet për të ofruar shërbimet dhe mundësuar një lidhje funksionale të strukturave manaxhuese në nivel kombëtar apo baseni me komunitetin dhe përfituesit e shërbimeve për sektorë të ndryshëm të ujit.
Institucioni përgjegjës	Ministri përgjegjës për çështjet vendore
Kohëzgjatja	2018-2020
Në vëmendje	Pushteti vendor është i pavarur dhe mund të organizojë sipas nevojave të tij kuadrin dhe strukturat insitucionale përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve ligjore. Është e rëndësishme që Ministria dhe institucionet qendrore përgjegjëse për çështjet vendore, të orientojnë dhe mbështesë të gjitha bashkitë për të gjetur zgjidhjen optimale, specifike për secilën bashki.

	<p>Synohet që fillimisht strukturat përgjegjëse qendrore të fillojnë një program orientues dhe trajnues në 61 bashkitë, për të përshtatur dhe organizuar strukturat institucionale vendore, për të përmbushur funksionet e decentralizuara të sektorit të ujit. Në rastet kur infrastruktura e tyre shtrihet në më shumë se një bashki dhe ofrimi i shërbimit nuk merret përsipër nga pushteti vendor, ministrinë përkatëse krijojnë ndërmarrjet operationale për përmbushjen këtyre detyrave. Është e rëndësishme që problematikat dhe temat specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse. Planet e veprimit të strukturave vendore duhet të jenë të harmonizuara sa i përket kronologjisë së hartimit të PBA-së.</p>
6	FORCIMI I STRUKTURAVE TË KONTROLLIT DHE ZBATUESHMËRISË SË LIGJIT
Qëllimi	<p>Ngritja/forcimi i strukturave të inspektimit dhe kontrollit të organizuar në nivel qendror dhe vendor, është i domosdoshëm për secilin sektor për të forcuar zbatueshmërinë e ligjit dhe aplikimin e sanksioneve. Qartësimi i kompetencave dhe ndarja e qartë e funksioneve duhet të plotësohen nga të gjitha strukturat.</p>
Institucioni përgjegjës	Inspektorati Qendror
Kohëzgjatja	2018-2020
Në vëmendje	<p>Të gjithë ministrinë e linjës duhet të ngrenë apo forcojnë inspektoratet përkatëse për sektorët që ata mbulojnë. Varësia e tyre administrative do të jetë nën ministrinë e linjës apo pushtetin vendor dhe veprimtaria e tyre rregullohet dhe kontrollohet nga inspektorati qendror shtetëror. Raportet vjetore të kontrollit për secilin nga inspektoratet përkatëse do të paraqiten në KKU, dhe konkluzionet do të ndihmojnë nivelin politikbërës për të përmirësuar dhe harmonizuar politikën në të gjithë sektorët.</p> <p>Është e rëndësishme që problematikat dhe temat specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit. Planet e veprimit të tyre duhet të jenë të harmonizuara sa i përket kronologjisë së zbatimit të tyre.</p>
7	FORCIMI I STRUKTURAVE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE MONITORIMIT
Qëllimi	<p>Forcimi dhe ngritja e një strukturë studimore shkencore në nivel qendror me departamente dhe specialistë nga fusha të ndryshme, dhe forcimi i laboratorëve në nivel lokal, për të forcuar bazën studimore së i përket tendencave të fushave të ndryshme të ujit. Të gjitha strukturat aktuale kërkimore, shkencore, monitoruese, për ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe detare do të bashkohen në një strukturë të vetme kombëtare për ujin. Laboratorët e vendosur në nivel basenesh do të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm të të gjithë parametrave cilësorë dhe sasiorë dhe raportojnë në kohë reale dhe në përputhje me standardet e direktivave të BE-së. Në nivel kombëtar do të ngrihet një strukturë shkencore, e cila do të analizojë rezultatet dhe do të prodhojë konkluzione dhe rekomandime, për t'u përshtatur dhe marrë në konsideratë nga niveli politikbërës dhe manaxherial. Kjo strukturë do të mbulojë ujin e pijshëm, ujitjen, hidroenergjinë, industrinë, veprat hidroteknike, cilësinë dhe sasinë e burimeve ujore, duke përfshirë ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe detare.</p>
Institucioni përgjegjës	Ministria përgjegjëse për shkencën / ministrinë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë
Kohëzgjatja	2018-2025
Në vëmendje	<p>Institucione të ndryshme sipas fushave të përgjegjësisë do të përcaktojnë nevojat e tyre për konsulentë shkencore. Akademia e Shkencave dhe universitetet do të konsultohen për departamentet dhe strukturën e institucionit, si dhe kriteret kualifikuese të stafit. Në fazën e parë do të bëhet bashkimi i strukturave ekzistuese të shpërndara në institucione të ndryshme në një strukturë të vetme kombëtare. Në fazën e dytë do të plotësohen hap pas hapi departamentet për fusha të ndryshme të ujit, në bashkëpunim të ngushtë të institucioneve shkencore dhe ministrive përkatëse. Është e rëndësishme që problematikat dhe temat</p>

	specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit.
8	FORCIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE
Qëllimi	Ngritja e një sistemi të integruar për manaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin e ujit ku pjesë integrale e këtij sistemi është forcimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimit dhe certifikimit të punonjësve të sektorit si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Hallkë e rëndësishme e këtij procesi është ngritja pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) e një dege të posaçme për trajnimin e punonjësve të sektorit të ujit, si dhe hartimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi.
Institucioni përgjegjës	ASP / Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike do të propozojë projektin ngritjen e një strukture trajnuese për sektorin e ujit në përmbushje të nevojave të sektorit. Nevojat për trajnime të stafeve, në nivele të ndryshme të qeverisjes së ujit do të adresohen në mënyrë periodike pranë kësaj strukture. Kjo strukturë do të analizojë gjithashtu performancën dhe eficientësinë e trajnimeve të realizuar për vitin paradhës dhe do të raportojë pranë KJU. Kalendari vjetor i trajnimeve miratohet çdo vit nga KJU.
9	NGRITJA E NJË SISTEMI TË INTEGRUAR INFORMACIONI
Qëllimi	Ngritja e një sistemi informacioni kombëtar për sektorin e ujit ku të gjitha institucionet përgjegjëse të përditësojnë në kohë reale të dhënat specifike të sektorëve që mbulojnë dhe të aksesojnë lehtësisht të dhënat që i atribuohen me ligj. Koordinimi i të gjithë projekteve në proces, të planifikuar dhe në perspektivë, për sistemin e informacionit sipas një standardi të unifikuar kombëtar dhe integrimi i të dhënave nga sektorët të ndryshëm. Ngritja, forcimi i strukturave institucionale të cilat gjenerojnë, analizojnë dhe përditësojnë informacionin për fusha të ndryshme të sektorit të ujit në plotësim të standardeve të BE-së.
Institucioni përgjegjës	ASIG / AKSHI / Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore
Kohëzgjatja	2018-2020
Në vëmendje	Ministritë dhe institucionet përkatëse duhet të planifikojnë nevojat dhe llojin e sistemeve të informacionit që i nevojitet dhe kanë detyrim ligjor të disponojnë. Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore së bashku me ASIG-un duhet të propozojnë ngritjen e një sistemi kombëtar informacioni për sektorin e ujit në Shqipëri, duke përcaktuar standardet dhe procedurat e prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit. Ministritë duhet të hartojnë aktet ligjore dhe rregulloret përkatëse të gjenerimit, nalizimit dhe përditësimit të informacionit specifik sipas fushave të përgjegjësisë që mbulojnë. Është e rëndësishme që problematikat dhe temat specifike të diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike, sipas fushave përkatëse, për të integruar dhe lehtësuar procesin e hartimit dhe miratimit. Në planet e veprimit hartimi i këtij programi duhet të jetë i harmonizuar sa i përket kronologjisë së zbatimit nga të gjitha institucionet.
10	NDËRTIMI I SISTEMEVE TË QËNDRUESHËM FINANCIARË
Qëllimi	Ndërtimi i një mekanizmi të qëndrueshëm financiar në secilën nga fushat e ujit, me qëllim rritjen e të ardhurave nga përdorimi i burimeve ujore, duke mundur mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, rikuperimin e dëmit mjedisor shkaktuar në mjediset ujore, për të arritur deri në qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e plotë financiare në sektor. Ky program synon orientimin drejt mbështetjes buxhetore si formë e buxhetimit të sektorit të ujit, duke

	krijuar një program buxhetor të veçantë për sektorin e ujit me qëllim përmbushjen e objektivave të PKS-së. Orientimi i manaxhimit të burimeve ujore drejt pavarësisë buxhetore do të arrinte krijimin e buxhetit të basenit ujor të dedikuar për ujin.
Institucioni përgjegjës	MF
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Ministria e Financave së bashku me ministrinë e linjës dhe Institucionin qendror për administrimin e burimeve ujore propozon rishikimin e programeve buxhetore respektive në përputhje me objektivat e PKS-së. Rishikimi i mundësive për rritjen e të ardhurave nga taksat, tarifat, si dhe rritja e transfertave, me synim sigurimin e performancës më të mirë në sektor për të garantuar gradualisht një sistem të qendrueshëm financiar. Strukturat manaxheriale duhet të orientohen drejt funksionimit si modele “biznesi”, për të mundësuar rikthimin në buxhetin e dedikuar për ujin e të ardhurave që gjenerohen nga vetë sektori, duke krijuar kështu pavarësinë financiare nga buxheti qendror, dhe për të krijuar mundësinë e realizimit të investimeve nga vetë sektori.
11	KOORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR T’JU PËRGJIGJUR SFIDAVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN NË SEKTORIN E UJIT.
Qëllimi	Forcimi i mekanizmit institucional për t’ju përgjigjur sfidave të integrimit Evropian të vendit. Me hapjen e negociatave për integrimin në BE sektori i ujit duhet të jetë i gatshëm për t’u përballur me nevojat dhe detyrimet që lindin nga ky proces. Të gjitha nivelet qeverisëse duhet të jenë të koordinuara në mënyrë të tillë që të japin kontributin e duhur sipas fushave të përgjegjësisë që ata mbulojnë.
Institucioni përgjegjës	MIE / Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Mekanizmi i GMIP-së në të gjitha nivelet qeverisëse do të organizohet dhe përmbushë detyrimet që do të lindin për sektorin e ujit në kuadër të integrimit Evropian. Nëngrupet tematike do të jenë grupet ndërinstitucionale dhe ministrinë përkatëse do të jenë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve. I gjithë procesi do të koordinohet nga sekretariati i GMIP-së dhe Ministria e Integrimit Evropian.
12	HARTIMI I STUDIMEVE PËR SEKTORIN E UJIT
Qëllimi	Hartimi i studimeve të nevojshëm për fusha të ndryshme të ujit do të krijojë një bazë të fortë shkencore mbi të cilën do të bazohet orientimi i politikave dhe shpërndarja e investimeve. Këto studime do të ndihmojnë jo vetëm në saktësimin e situatës dhe ecurisë faktike të secilit nga 13 objektivat, por edhe në vendosjen e pikësnyimeve realiste për vitet e ardhshme. Vlerësimi i performancës dhe efikasitetit të investimeve do të bazohet në indikatorë të matshëm të cilat i referohen studimeve përkatëse shkencore.
Institucioni përgjegjës	Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore / Ministrinë e linjës
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Fillimisht do të bëhet një vlerësim i studimeve aktuale në dispozicion, duke vlerësuar efektshmërinë dhe përputhshmërinë e tyre me problematikat aktuale. Në funksion të secilit nga 13 objektivat e përcaktuar në PKS, duhen evidentuar studimet e nevojshme për krijimin e një reference me bazë shkencore. Këto studime do të ndihmojnë në vlerësimin e aspekteve sasiore dhe cilesore të burimeve ujore, efikasitetin e përdorimit të ujit, përfitueshmërinë ekonomike dhe vlerësimin e impaktit në mjedis që veprimtaritë njerëzore kanë shkaktuar apo shkaktojnë në fusha të ndryshme të ujit. Institucioni qendror për administrimin e burimeve ujore dhe institucionet përgjegjëse fillimisht do të hartojnë listën e prioritizuar të studimeve të nevojshme të cilat duhet të plotësohen deri në periudhën afatmesme të këtij dokumenti.

	Studimet e evidentuara përfshihen në planin e veprimit dhe i adresohen për zbatim institucioneve përkatëse.
13	KOORDINIMI I INVESTIMEVE INFRASTRUKTURE
Qëllimi	Koordinimi i investimeve infrastrukturore është i nevojshëm për ti orientuar ato drejt përdorimit të integruar, për të ulur kostot e investimit, rritur përfitueshmërinë ekonomike, plotësuar nevojat sociale dhe duke rruajtur harmonin me mjedisin.
Institucioni përgjegjës	GMIP / Ministrinë e linjës
Kohëzgjatja	2018-2030
Në vëmendje	Investimet shumëfunktionale në sektorin e ujit do të kenë prioritet kundrejt projekteve të dedikuara vetëm për një fushë në këtë sektor. Kjo do të realizohet duke prioritetizuar ato investime që shërbejnë në më shumë se një fushë në sektori e ujit dhe sjellin më shumë përfitime. Matricat e prioritizimit orientojnë investimet drejtë shumëfunktionalitetit dhe efektshmërisë. Këtu synohet që të bëhet integrimi ndërmjet investimeve jo vetëm brenda sektorit publik por edhe ndërmjet investimeve të sektorit privat. Politikat incentivuese të këtyre investimeve të interguara do ndrihmojë në uljen e kosotve të ndërtimit, mirëmbajtjes dhe operimit, duke synuar drejtë pavarësisë financiare, për fazën e operimit.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikator	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
1 Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim, të sigurt dhe të vazhdueshëm								
Qeverisja e Mirë								
Kuadër ligjor / rregullator i harmonizuar dhe i plotë								
1.1	Rishikimi i kuadrit ligjor aktual për shërbimin e furnizimit me ujë	Ministria përgjegjëse për mjedisin / Ministria përgjegjëse për administrimin e ujërave / Ministria përgjegjëse për furnizimin me ujë / ERU	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Ligj për furnizimin me ujë të pijshëm i rishikuar, dhe aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara sipas matricës respektive	akte ligjore dhe nënligjore	Rishikimi i kuadrit ligjor për shërbimin e furnizimit me ujë synon rregullimin e sektorit, përmirësimin e shërbimit dhe mirëpërcaktimin e roleve, detyrave dhe përgjegjëseve për të gjitha nivelet e qeverisjes. Këtu përfshihet jo vetëm rishikimi i ligjit por edhe plotësimi i tij me aktet nënligjore të nevojshme.
1.2	Plotësimi me akte nënligjore të legjislacionit ekzistues për realizimin e reformës së furnizimit me ujë	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e furnizimit me ujë / ERU	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Aktet nënligjore në zbatim të reformës së furnizimit me ujë të hartuara dhe të miratuara sipas matricës respektive	akte nënligjore	Shërbimi i furnizimit me ujë aktualisht ka vështirësi në zbatimin e legjislacionit gjë e cila vështirëson realizimin e reformave dhe arritjen e objektivave të vendosura në strategjinë përkatëse. Në këto kushte lind nevoja për plotësim.
1.3	Përshtatja e kuadrit ligjor mundësinë e aplikimit të koncesioneve dhe PPP-ve në shërbimin e furnizimit me ujë	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e furnizimit me ujë / ERU	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Akte nënligjore respektive për përfshirjen e dispozitave rregulluese të shërbimit të furnizimit me ujë në PPP-të e miratuara	akte nënligjore	Për të përmirësuar menaxhimin dhe mundësuar qëndrueshmërinë financiare të shërbimit të furnizimit me ujë, nga praktika evropiane ka rezultuar i suksesshëm aplikimi i Partneritetit Publik Privat dhe koncesioneve drejt të cilave edhe legjislacioni shqiptar është orientuar së fundi. Në këto kushte duhet të krijohet kuadri dhe hapësira e nevojshme ligjore për aplikimin e këtyre formave të menaxhimit.
1.4	Rishikimi i kriterëve të licencimit të shoqërive UK	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e furnizimit me ujë në bashkëpunim me ERU / KM	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Akte nënligjore respektive për përcaktimin e kriterëve të licencimit të shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, të miratuara	akte nënligjore	Rishikimi i kriterëve të licencimit të shoqërive UK është i nevojshëm për të forcuar mekanizmat rregullatorë të shërbimit të furnizimit me ujë, duke synuar kështu përmirësimin e shërbimit dhe zbatuar të gjitha standardet e përcaktuara në kuadrit ligjor kombëtar dhe direktivat e BE-së.
9.19	Përmirësimi i kurrikulave për përgatitjen e specialistëve të rinj të ujit	Ministria përgjegjëse për shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kurrikula universitare për specialistët e rinj të ujit të rishikuara	Numri i kurrikulave të rishikuara	Përgatitja e ekspertëve të ardhshëm të ujit është një instrument i rëndësishëm për të siguruar kapacitetet e nevojshme për të zbatuar standardet e BE-së në menaxhimin e ujërave nëntokësore. Aktualisht nuk ka një instrument që të orientojë kuotat e specialistëve në fushën e ujërave me kërkesat dhe nevojat që ka dhe do të ketë tregu në perspektivë. Nëpërmjet kësaj mase synohet që të orientohen kurrikulat universitare me kërkesën e tregut të punës për mbrojtjen e burimeve ujore dhe cilësisë së tyre.
9.20	Përmirësimi i kurrikulave parauniversitare për përfshirjen e edukatës mjedisore	Ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kurrikula të rishikuara	Numër kurrikulash të rishikuara	Përfshirja e edukatës mjedisore në sistemin parauniversitar është një instrument i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e brezave të rinj me ndikimin e mjedisit në jetën tonë të përditshme. Me anë të kësaj mase synohet rritja e njohurive për mjedisin dhe ndërgjegjësimin të brezave të rinj me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.
9.21	Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për gjithëpërfshirjen	Ministri për çështjet vendore / Ministria përgjegjëse për mjedisin / Bashkitë / Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Sistem i qëndrueshëm për përfshirjen e të gjithë aktorëve i hartuar	Plani i takimeve për çdo bashki	Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm gjithëpërfshirës është një instrument shumë i rëndësishëm për përfshirjen e komuniteteve lokale në çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Me anë të kësaj mase synohet rritja e ndërgjegjësimin të komuniteteve lokale, qeverisjes lokale dhe qendrore dhe përfshirja aktive e komuniteteve lokale.
Sistem total i integruar informacioni								
9.22	Integrimi i të dhënave të burimeve ujore nëntokësore në format GIS / Geo data bazë (Kadastri e burimeve ujore)	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Sistem informacioni për ujërat nëntokësore i ngritur dhe funksional	akte ligjore dhe nënligjore	Me ngritjen e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore (KKBU), lind nevoja për të përditësuar dhe mbushur me të dhëna mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave nëntokësore nga të gjithë përdoruesit e ujit. Me anë të kësaj mase synohet që strukturat lokale të angazhohen dhe udhëzohen për të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me të dhëna sipas formateve të përcaktuara. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar nevojave për përditësimin në vazhdim me të dhëna.
9.23	Ngritja e një sistemi të integruar informacioni për burimet njerëzore	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Sistem informacioni për burimet njerëzore i ngritur dhe funksional	akt nënligjor	Kjo masë synon dixhitalizimin e të dhënave mbi burimet njerëzore që punojnë në menaxhimin e trupave ujore sipërfaqësore dhe përpunimin e statistikave për të orientuar më mirë, kërkesën e tregut për ekspertë të rinj, shpërndarjen e trajnimeve dhe tendencat tjera të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm.
10 Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht “e mirë” për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetarë e kalimtarë)								
Qeverisja e Mirë								
Kuadër ligjor / rregullator i harmonizuar dhe i plotë								

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikator	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
10.1	Forcimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e trupave ujorë detare, bregdetare dhe kalimtare	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për mjedisin / Ministria përgjegjëse për çështjet diplomatike	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Akte ligjore të lidhura me mbrojtjen e statusit të trupave ujorë detarë dhe bregdetarë të rishikuara / hartuara sipas matricave respektive	akte ligjore dhe nënligjore	Trupat ujorë janë pikat fundore të emetimeve të ndotjes nga uji dhe toka dhe si rrjedhojë kuadri ligjor që rregullon këtë fushë është kompleks dhe i shpërndarë në komponentë të ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Parimet bazë të direktivës kuadër të ujit për mbrojtjen e statusit të trupave ujorë bregdetare, janë referenca bazë nga i cili do të udhëhiqet ky proces. Me anë të kësaj mase synohet një harmonizim i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues, duke shmangur mbivendosjet dhe mospërputhjet. Gjithashtu përputhja e kuadrit ligjor për ujërat të cilat shtrihen edhe jashtë kufijve territorialë, me standardet e direktivës kuadër të ujit dhe konventave ndërkombëtare do të harmonizohet nëpërmjet kësaj mase. Kuadri ligjor për liqenet dhe ujërat detare të cilët shpesh trajtohen me kuadër ligjor të dedikuar do të harmonizohen nëpërmjet kësaj mase. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ndryshime ligjore, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
10.1	Përafrimi i plotë i Direktivës 2008/56/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të dates 17 Qershor 2008, e cila përcakton kuadrin për veprimet në komunitet në fushën e politikës mjedisore detare (<i>Direktiva Kuadër e Strategjisë Mjedisore Detare</i>)	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	6,800,000	13,600,000	20,400,000	Transpozimi i dispozitave të direktivës përkatëse të BE-së në legjislacionin kombëtar në përputhje edhe me PKIE	akte ligjore dhe nënligjore	Nëpërmjet kësaj mase synohet të përafrohet kuadri ligjor i cili do të aplikojë standardet më të mira të BE-së në menaxhimin e mjedisit ujor detar, përfshi edhe mënyrën e monitorimit dhe atë të raportimit. Realizimi i këtij procesi është një nga detyrimet e Shqipërisë në zbatim të MSA dhe procesit të integritimit në BE. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert të huaj, referuar ndryshimeve të vazhdueshme të kesaj direktive të BE-së.
10.3	Miratimi i marrëveshjeve me vendet fqinje bazuar në direktivën kuadër të ujit	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për çështjet diplomatike	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Marrëveshje me vendet fqinje të firmosura	numër marrëveshesh të firmosura	Me anë të kësaj mase synohet të arrihen marrëveshjet me vendet fqinje duke respektuar parimet e direktivës kuadër të Ujit.
Mekanizëm eficient organizimi institucional								
10.4	Forcimi i strukturave institucionale politikbërëse për ujërat detare dhe bregdetare	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për mjedisin	6,319,000	21,063,000	27,382,000	Strukture institucionale për mbrojtjen e ujërave detare dhe bregdetare e forcuar	akt nënligjor	Forcimi i strukturave politikbërëse në ministritë e linjës do të përmirësonte nivelin e planifikimit dhe do të forconte kuadrin ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e mjedisve ujore. Qëllimi i kësaj mase është që të përcaktojë dhe ndajë qartësisht strukturat në ministrinë përkatëse nga detyrat e tjera menaxheriale apo operationale dhe të fokusohet në hartimin e politikave, përmirësimin e standardeve dhe të rregulloreve. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
10.5	Forcimi i strukturave menaxhuese në nivel baseni ujor	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për mjedisin	18,956,000	63,187,000	82,143,000	Struktura menaxhuese në nivel baseni ujor të forcuar	akt nënligjor	Strukturat menaxhuese janë niveli qeverisës kryesor për implementimin e politikave dhe strategjive përkatëse. Me anë të kësaj mase synohet ngritja dhe bërja funksionale e një strukture menaxhuese në nivel baseni e cila do të menaxhojë ujërat bregdetare në përputhje me planet e menaxhimit të baseneve përkatëse. Gjithashtu këto struktura do të jenë përgjegjëse edhe për përgatitjen e bazës së të dhënave dhe luajnë rolin kryesor për rishikimin periodik të planeve të menaxhimit sipas kërkesave të Direktivës Kuadër të Ujit. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim sa i përket menaxhimit, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjëse	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
10.6	Forcimi i strukturave për mbrojtjen e mjedisit ujor detar pranë qeverisjes vendore	Ministria përgjegjëse për mjedisin / Ministri për çështjet vendore / Bashkitë	11,585,000	38,614,000	50,199,000	Struktura specifike në nivel vendor për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave detarë të forcuara	akt nënligjor	Përfshirja e bashkive në strukturat menaxhuese të ujërave detare për disatribute jo komplekse, nisur nga fakti që janë më afër me përdoruesit, do të lehtësonte procedurat si edhe do të prodhonte rezultate konkrete në afate kohore të shkurtra, për përdorimin dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave. Për çdo bashki me vijë bregdetare për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për forcim kapacitetesh në këtë fushë.
10.7	Ngritja dhe konsolidimi i një strukture kombëtare studimore shkencore për sektorin e ujit ku pjesë e rëndësishme e saj do të jetë dhe trajtimi i çështjeve të ujërave detare dhe bregdetare	Ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave / Ministria përgjegjëse për mjedisin	6,319,000	21,063,000	27,382,000	Strukturë studimore shkencore e krijuar dhe funksionale	akt nënligjor	Aktualisht në Shqipëri ka disa institucione të cilat merren me monitorimin e ujërave detare dhe bregdetare. Ky fragmentim e bën të vështirë koordinimin dhe përcaktimin e përgjegjëseve institucionale dhe krijon shpeshherë mbivendosje. Ngritja e një strukture studimore shkencore për ujërat detare dhe bregdetare është e domosdoshme për të përcaktuar tendencat nga pikëpamja sasiore dhe cilësore që lidhen me presionin që vjen nga shkarkimet dhe ndryshimet klimatike, për të realizuar dhe testuar modelet e ndryshme fizike. Njëpërmjet kësaj strukture synohet të propozohen dhe nxiten sisteme inovatore, në funksion të marrjes së masave eficiente për parandalimin e ndotjes, të zgjidhjeve shkencore për zonat me tendenca erozioni detar përfshirë këtu edhe vlerësimin tekniko-ekonomik të secilës zgjidhje, duke konsideruar edhe faktorin e ndryshimeve klimatike. Kjo strukturë synon të krijojë bazën shkencore për të përshtatur kushtet natyrore të vendit tonë me zgjidhjet e duhura. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt, bazuar në nevojat e vazhdueshme për forcimin e kërkimit shkencor për nevojat e zhvillimit të vlerësimit, analizimit dhe klasifikimit të trupave ujorë detare, sipas direktivave të BE-së.
10.8	Forcimi i sistemit të monitorimit për ujërat detare dhe bregdetare	Ministria përgjegjëse për mjedisin / IGJEUM / SHGJSH / AKM	6,319,000	21,063,000	27,382,000	Struktura monitorimi për ujërat detare dhe bregdetare të rishikuara	akt nënligjor	Monitorimi i ujërave detare dhe bregdetare, në cilësi dhe në sasi, është treguesi bazë mbi të cilin orientohen politikat, hartohen planet e menaxhimit dhe adresohen investimet. Aktualisht monitorimi është i kufizuar në aspektin financiar dhe teknik. Njëpërmjet kësaj mase synohet të forcohen institucionet monitoruese në nivel qendror dhe të ngrihen strukturat përkatëse në nivel baseni duke plotësuar të gjitha standardet dhe e direktivave të Bashkimit Evropian. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim sa i përket monitorimit në zbatim të satndaveve të direktivave të BE-së për ujërat detare.
10.9	Forcimi i strukturave të kontrollit për ujërat detare dhe bregdetare	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për mjedisin / Ministria përgjegjëse për shëndetësinë / Ministria përgjegjëse për punët e brendshme	6,319,000	21,063,000	27,382,000	Struktura kontrolli për ujërat detare dhe bregdetare të forcuara	akt nënligjor	Mbrojtja e statusit të ujërave detare dhe bregdetare ka nevojë të ketë një strukturë kontrolli e cila do të aplikojë sanksionet që përcakton kadri ligjor, përveç financimeve dhe monitorimit. Ngritja e kësaj strukture do të forcojë zbatueshmërinë e ligjit dhe aplikimin e sanksioneve përkatëse, për shkelje të ndryshme duke pasur parasysh zbatimin e parimit "ndotësi paguan". Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim sa i përket kontrollit në zbatim të satndaveve të direktivave të BE-së për ujërat detare.
10.10	Forcimi i strukturave institucionale për menaxhimin e ujërave ndërkufitare detare	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Strukturë për menaxhimin e ujërave ndërkufitare funksionale	akt nënligjor	Me anë të kësaj mase synohet të forcohen strukturat e menaxhimit të ujërave ndërkufitare detare

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
10.11	Ngritja e një sistemi financiar të vlerësimit dhe rikuperimit të kostove mjedisore	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për mjedisin / ERRU	4,400,000	8,800,000	13,200,000	Sistem financiar mbi bazë rikuperimin e kostove i krijuar dhe funksional	akt nënligjor	Rikuperimi i kostove mjedisore është një nga parimet bazë të direktivës kuadër të ujit. Aktualisht mungon një sistem i vlerësimit të kostove mjedisore të shkaktuar nga ndotës të ndryshëm në ujërat detare dhe bregdetare. Sistemi aktual i tarifimit mbi kostot mjedisore të shkaktuar në trupat ujorë nuk arrin të rikuperojë dhe në shumicën e rasteve nuk aplikohet fare. Kjo masë synon të ngrejë një sistem të unifikuar për vlerësimin dhe unifikimin e dëmit mjedisor të shkaktuar në ujërat detare dhe bregdetare sikurse edhe të përcaktojë mekanizmat e duhur për rikuperimin e kostove. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspertizë të huaj, bazuar në nevojat e vazhdueshme për konsulencë mbi kostot financiare të presioneve mbi ujërat detare, në përputhje me standardet dhe kërkesat e direktivave të BE-së.
10.12	Ndërtimi i një instrumenti financiar në nivel baseni ujor (fondi për ujin)	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për financat / KKKU	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Fondi i ujit i krijuar dhe funksional	akt nënligjor	Krijimi i një fondi të dedikuar për mbrojtjen e ujërave detare dhe bregdetare është një instrument i rëndësishëm financiar i cili mund të përdoret për të orientuar rikuperimin e kostove mjedisore në trupat ujorë drejt modeleve të biznesit. Ky fond do të mund të përdoret për nxitjen e zhvillimit në ato zona ku gjenerimi i të ardhurave nga përdorimi i burimeve ujore paraqet vështirësi.
Kapacitete njerëzore eficiente								
10.13	Rishikimi i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së stafëve teknike	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore / Ministria përgjegjëse për mjedisin	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kriteret e përzgjedhjes së stafëve teknike të punësuar në strukturat përgjegjëse për menaxhimin e ujërave detare dhe bregdetare, të rishikuara	akt nënligjor	Rishikimi i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së stafëve teknike dhe menaxhuese do të sigurojë rritje të nivelit profesional dhe teknik të stafëve dhe rrjedhimisht përmirësimin dhe zbatimin më të thjeshtë të politikave në menaxhimin e integruar të burimeve ujore.
10.14	Organizimi i trajnimeve për çështje specifike që lidhen me ujërat detare dhe bregdetare	ASP / ministritë e linjës	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Ngritja dhe funksionimi i degës së trajnimit për sektorin e ujit pranë ASPA	trajnime/ orë trajnimi	Trajnimi në mënyrë të vazhdueshme i stafëve në të gjitha nivelet, që punojnë në menaxhimin dhe monitorimin e burimeve ujore është një masë e domosdoshme. Për këtë synohet që të gjitha strukturat të koordinohen nëpërmjet njëdege specifike për sektorin e ujit, e cila do të mund të koordinojë të gjitha trajnimet dhe kurrikulat në të gjitha nivelet. Këto trajnime do të konkludojnë me certifikimin e punonjësve dhe matjen e performancës dhe efektivitetit të trajnimeve. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert trajnues, referuar nevojave teknike të stafëve për tu trajnuar në periudhën në vazhdim.
10.15	Përmirësimi i kurrikulave për përgatitjen e specialistëve të rinj të ujit	Ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kurrikula universitare për specialistët e rinj të ujit të rishikuara	numër kurrikulash të rishikuara	Përgatitja e specialistëve të ardhshëm të ujit është një instrument i rëndësishëm për të siguruar kapacitetet e nevojshme për të zbatuar standardet e BE-së në menaxhimin e ujërave detare. Aktualisht nuk ka një instrument që të orientojë kuotat e specialistëve në sektorin e ujit me kërkesat dhe nevojat që ka tregu i punës. Nëpërmjet kësaj mase synohet që të orientohen kurrikulat universitare me kërkesën e tregut të punës për mbrojtjen e burimeve ujore dhe cilësisë së tyre.
10.16	Përmirësimi i kurrikulave parauniversitare për përfshirjen e edukatës mjedisore	Ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kurrikula të rishikuara	numër kurrikulash të rishikuara	Përfshirja e edukatës mjedisore në sistemin parauniversitar është një instrument i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e brezave të rinj me ndikimin e mjedisit në jetën tonë të përditshme. Me anë të kësaj mase synohet rritja e njohurive për mjedisin dhe ndërgjegjësimin e brezave të rinj me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
10.17	Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për gjithëpërfshirjen	Ministri për çështjet vendore / Bashkitë / Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Sistem i qëndrueshëm për përfshirjen e të gjithë aktorëve i hartuar	plani i takimeve për çdo bashki	Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm gjithëpërfshirje është një instrument shumë i rëndësishëm për përfshirjen e komuniteteve lokale në çështjet e mbrojtjes së mjedisit ujor. Me anë të kësaj mase synohet rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale, qeverisjes lokale dhe qendrore dhe përfshirja aktive e komuniteteve lokale.
Sistem total i integruar informacioni								
10.18	Integrimi i të dhënave të burimeve ujore detare dhe bregdetare në format GIS / Geo data bazë (Kadastri e burimeve ujore)	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Sistem informacioni për ujërat detare dhe bregdetare i ngritur dhe funksional	akte ligjore dhe nënligjore	Me ngritjen e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore (KKBU), lind nevoja për të përditësuar dhe për të mbushur me të dhëna mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave detare nga të gjithë përdoruesit e ujit. Me anë të kësaj mase synohet që strukturat lokale të angazhohen dhe të udhëzohen për të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme të dhënat mbi sasinë dhe cilësinë sipas formateve të përcaktuara. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar nevojave për përditësimin në vazhdim me të dhëna.
10.19	Ngritja e një sistemi të integruar informacioni për burimet njerëzore	Ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Sistem informacioni për burimet njerëzore i ngritur dhe funksional	akt nënligjor	Kjo masë synon dixhitalizimin e të dhënave mbi burimet njerëzore që punojnë në strukturat përgjegjëse për menaxhimin e ujërave detare dhe bregdetare dhe përpunimin e statistikave për të orientuar më mirë kërkesën e tregut për ekspertë të rinj, shpërndarjen e trajnimeve dhe tendenca të tjera të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm.
11	Reduktimi i rrezikut dhe i humbjeve nga përmbytja për jetën, jetesën dhe shëndetin dhe asetet ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve me synim përmirësimin e menaxhimit të situatave të mbrojtjes nga përmbytja; përmirësimin e infrastrukturës në përgjigje të fatqësive natyrore; garantimin e kushteve të sigurta të jetesës për njerëzit, florën dhe faunën në zonat e rrezikuara; sigurimin e asetet ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore për personat, bizneset dhe komunitetet							
Qeverisje e mirë								
Kuadër ligjor / rregullator i harmonizuar dhe i plotë								
11.1	Forcimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen nga përmbytja	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Ligj "për mbrojtjen civile" i rishikuar dhe akte nënligjore të hartuara sipas matricës respektive	akte ligjore dhe nënligjore	Nëpërmjet kësaj mase synohet që të hartohet dhe miratohet ligji i ri për emergjencat civile dhe të plotësohet me akte nënligjore të nevojshme për zbatim. Ky ligj do të përcaktojë dhe koordinojë nivelet dhe strukturat menaxhuese të emergjencave civile, duke harmonizuar reagimin ndaj përmbytjeve me masat parandaluese dhe lajmëruese. Aktualisht është ngritur grupi i punës për hartimin e ligjit të ri për emergjencat civile. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile ka hartuar draftin përfundimtar të ligjit të ri për Mbrojtjen Civile së bashku me relacionin përkatës.
11.2	Përafrimi i plotë i Direktivës 2007/60/EC Për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmbytjet.	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	6,800,000	13,600,000	20,400,000	Transpozimi i dispozitave të direktivës përkatëse të BE-së në legjislacionin kombëtar, në përputhje edhe me PKIE	akte ligjore dhe nënligjore	Përmbytja në Shqipëri, sidomos vitet e fundit, është një fenomen shumë i hasur i cili ka shkakuar pasoja dhe dëme të mëdha deri edhe në humbje jetë njerëzish. Megjithatë kosto ka rezultuar tepër e lartë, mungesa e një programi konkret dhe realist për parashikimet në kohë reale dhe vlerësimin financiar paraprakisht ka bërë që fatura financiare të rritet edhe më shumë. Nëpërmjet kësaj mase synohet të përafrrohet kuadri ligjor i cili do të aplikojë standardet e BE-së në programim, planifikim dhe ndjekjen e hapave të mirëpërcaktuara. Realizimi i këtij procesi është një nga detyrimet e Republikës së Shqipërisë në zbatim të MSA dhe procesit të integritimit në BE. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert të huaj, referuar ndryshimeve apo përditësimit që mund të ketë kjo direktivë për periudhën në vazhdim.
Mekanizëm eficient organizimi institucional								

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikator	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
11.3	Konsolidimi i strukturave institucionale politikbërëse për mbrojtjen nga përmbytja	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Skema institucionale për mbrojtjen nga përmbytja e rishikuar	akt nënligjor	Riorganizimi i strukturave politikbërëse në ministritë e linjës do të përmirësojë nivelin e planifikimit dhe forcë të kuadrin ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e mjedisit ujor. Qëllimi i kësaj mase është përcaktimi dhe ndarja e qartë e detyrave në ministri dhe fokusimi i tyre në hartimin e politikave, përmirësimin e standardeve dhe rregulloreve. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
11.4	Forcimi i strukturave menaxhuese për mbrojtjen nga përmbytja	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Institucione menaxhuese të mbrojtjes nga përmbytja të forcuar dhe funksionale	akt nënligjor	Strukturat menaxhuese janë themelore për zbatimin e politikave dhe strategjive përkatëse. Me anë të kësaj mase synohet ngritja dhe bërja funksionale e një strukture menaxhuese në nivel baseni ujor, e cila do të menaxhojë strukturat dhe masat e parashikuara në përputhje me planet e mbrojtjes nga përmbytja e baseneve përkatëse. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert për menaxhimin e përmbytjeve, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
11.5	Forcimi i strukturave menaxhuese në qeverisjen vendore	Bashkitë	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Struktura specifike në nivel vendor për mbrojtjen e mjedisit ujor të forcuar	vendime të pushtetit vendor	Përfshirja e bashkive në strukturat menaxhuese të mbrojtjes nga përmbytja është një domosdoshmëri për të zbatuar planet e menaxhimit të përmbytjeve. Forcimi i strukturave lokale qeverisëse do të lehtësojë procedurat e hartimit të planeve dhe do të prodhojë rezultate konkrete në afate kohore të shkurtra për mbrojtjen nga përmbytja.
11.6	Ngritja dhe konsolidimi i një strukture kombëtare studimore shkencore për sektorin e ujit ku pjesë e rëndësishme e saj do të jetë dhe trajtimi i çështjeve për mbrojtjen nga përmbytja	Ministria përgjegjëse për shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave / Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	6,319,000	21,063,000	27,382,000	Strukturë studimore shkencore e krijuar dhe funksionale	akt nënligjor	Aktualisht në Shqipëri ka disa institucione të ndryshme të cilat merren me menaxhimin e përmbytjeve. Ky fragmentim e bën të vështirë koordinimin dhe përcaktimin e përgjegjëseive institucionale si edhe krijon shpeshherë mbivendosje. Ngritja e një strukture studimore shkencore për të vlerësuar riskun dhe efektin e përmbytjeve është e domosdoshme për të përcaktuar zgjidhjet shkencore më të përshtatshme për kushtet e vendit tonë duke realizuar dhe testuar modelet e ndryshme fizike. Nëpërmjet kësaj strukture synohet të propozohen dhe nxiten sisteme inovatore, në funksion të marrjes së masave eficientë për parandalimin e ndotjes, të zgjidhjeve shkencore për zonat me tendencë erozioni detar përfshirë këtu edhe vlerësimin tekniko-ekonomik të secilës zgjidhje, duke konsideruar edhe faktorin e ndryshimeve klimatike. Kjo strukturë synon të krijojë bazën shkencore për të përshtatur kushtet natyrore të vendit tonë me zgjidhjet e duhura. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt, bazuar në nevojat e vazhdueshme për forcimin e kërkimit shkencor për nevoja të zhvillimit të vlerësimit, analizimit dhe klasifikimit të mbrojtjes nga përmbytja, në përputhje me direktivat e BE-së
11.7	Forcimi i strukturave të monitorimit për mbrojtjen nga përmbytja	ABU	18,956,000	63,187,000	82,143,000	Struktura monitorimi të rishikuara	akt nënligjor	Nëpërmjet kësaj mase synohet të forcohen institucionet monitoruese në nivel qendror por veçanërisht në nivel basenesh për parashikimin e hershëm të përmbytjes por edhe menaxhimin e situatave pas saj, duke respektuar të gjitha standardet dhe parametrat e direktivave të Bashkimit Evropian. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim sa i përket monitorimit, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
11.8	Forcimi i strukturave të kontrollit të objekteve në funksion të mbrojtjes nga përmbytja	ABU	18,956,000	63,187,000	82,143,000	Struktura kontrolli të rishikuara	akt nënligjor	Kjo masë do të ndihmonte në realizimin e kontrolleve periodike mbi nivelin e eficientësisë së strukturave mbrojtëse të ndërtuara ose të projektuara. Mbikëqyrja e operimit të tyre është shumë e rëndësishme dhe për këtë nevojitet një staf i përgatitur. Ngritja e këtyre strukturave në nivel baseni ujor është një domosdoshmëri. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim sa i përket kontrollit dhe zbatueshmërisë së ligjit.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
11.9	Ngritja e një sistemi financiar për rikuperimin e kostos	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja / Bashkitë	4,400,000	8,800,000	13,200,000	Sistem financiar mbi bazë rikuperimin e kostove i krijuar dhe funksional	akt nënligjor	Rikuperimi i kostove të përmbytjeve në raste fatkeqësish natyrore jo vetëm nga buxheti i shtetit por edhe nga burime të tjera alternative është një domosdoshmëri dhe një nga parimet bazë të Direktivës Kuadër të Ujit. Aktualisht mungon një sistem vlerësimi i kostove mjedisore të shkaktuara nga fenomenet e përmbytjeve. Sistemi aktual i tarifimit mbi kostot e përmbytjeve, nuk rikuperon kostot dhe në shumicën e rasteve nuk aplikohet. Kjo masë synon ngritjen e një sistemi të unifikuar për vlerësimin dhe unifikimin e dëmit të shkaktuar nga përmbytjet, si edhe përcaktimin e mekanizmave të duhur për rikuperimin e kostove. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspertizë të huaj, bazuar në nevojat e vazhdueshme për vlerësimin, analizimin dhe planifikimin të kostove njësi për mbrojtjen nga përmbytja si dhe vlerësimi i mundësive të rikuperimit të kostove.
11.10	Përmirësimi i politikave të subvencionimit	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja / Bashkitë	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Politika subvencionuese të mbrojtjes nga përmbytja të përmirësuara	akt nënligjor	Nëpërmjet kësaj mase synohet hartimi i një kuadri rregullues për shpërndarjen e subvencioneve në rastin e përmbytjeve, duke marrë parasysh raportin e riskut të parashikuar në planet e menaxhimit të përmbytjeve si edhe pamundësinë për rikuperimin e kostove.
11.11	Ngritja e një sistemi financiar për sigurimin e jetës / pronës	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja / Bashkitë	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Sistem për sigurimin e jetës/pronës i ngritur dhe funksional	akt nënligjor	Buxheti i shtetit nuk mund të mbulojë plotësisht kostot financiare të përmbytjeve. Sigurimi i pronës dhe i pasurive të cilat vlerësohen si me risk të lartë përmbytjeje duhet të kthehet në një detyrim ligjor. Kjo masë do të realizonte një shpërndarje më të drejtë për palët e dëmtuara, por edhe për taksapaguesit e tjerë, duke shpërndarë sigurimin në proporcion të drejtë me riskun.
Kapacitete njerëzore eficiente								
11.12	Rishikimi i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së stafëve teknike	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kriteret e përzgjedhjes së stafëve teknike përgjegjëse për mbrojtjen nga përmbytja të rishikuara	akt nënligjor	Rishikimi i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së stafëve teknike dhe menaxhuese do të sigurojë rritje të nivelit profesional dhe teknik të stafëve dhe rrjedhimisht përmirësimin dhe zbatimin më të thjeshtë të politikave në menaxhimin e integruar të burimeve ujore.
11.13	Organizimi i trajnimeve për çështjet që lidhen me rrezikun nga përmbytja	ASP / ministritë e linjës	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Ngritja dhe funksionimi i degës së trajnimit për sektorin e ujit pranë ASPA	orë trajnimi	Trajnimi në mënyrë të vazhdueshme i stafëve që punojnë në menaxhimin e përmbytjeve është një masë e domosdoshme. Për këtë synohet që të gjitha strukturat të koordinohen nëpërmjet një dege uji pranë ASPA e cila do të koordinojë të gjitha trajnimet dhe kurrikulat në të gjitha nivelet. Këto trajnime do të finalizohen me certifikimin e punonjësve dhe matjen e performancës dhe efektivitetit të trajnimeve. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert trajnimi, referuar nevojave teknike të stafëve që të trajnohen për periudhën në vazhdim.
11.14	Përmirësimi i kurrikulave për përgatitjen e specialistëve të rinj të ujit	Ministria përgjegjëse për shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kurrikula universitare të rishikuara	numër kurrikulash të rishikuara	Përgatitja e ekspertëve të ardhshëm për mbrojtjen nga përmbytja është një instrument i rëndësishëm për të siguruar kapacitetet e nevojshme dhe për të zbatuar standardet evropiane. Nëpërmjet kësaj mase synohet orientimi i kurrikulave universitare me kërkesën e tregut të punës për mbrojtjen nga përmbytja.
11.15	Përgatitja e një programi sensibilizimi të publikut mbi rrezikun dhe reagimin e nevojshëm në rast përmbytjesh	Ministria përgjegjëse për shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Program ndërgjegjësimi i publikut mbi rrezikun në rast përmbytjesh i hartuar	Program i përgatitur	Nëpërmjet kësaj mase synohet që qytetarët të orientohen drejt përfshirjes së masave të mbrojtjes nga përmbytja në të gjitha veprimtaritë rutinë të jetës së përditshme. Risku nga përmbytja vitet e fundit ka ardhur duke u rritur ndaj edhe gatishmëria e qytetarëve duhet të vijë në rritje.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikator	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
Sistem total i integruar informacioni								
11.16	Integrimi i të dhënave të përmbytyjeve në format GIS / Geo database (Kadastra e burimeve ujore)	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Sistem informacioni për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja i ngritur dhe funksional.	akt nënligjor	Kjo masë synon forcimin e sistemit të monitorimit të situatave të përmbytyjes dhe ndihmon proceset e parashikimit të këtyre fenomeneve në të ardhmen. Ngritja e sistemeve GIS për hedhjen e hartave të përmbytyjeve dhe ngritja e një sistemi paralajmërimi është një masë e domosdoshme. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar nevojave për përditësimin në vazhdim me të dhëna.
12 Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e digave në përputhje me kushtet teknike, sipas rekomandimeve të ICOLD-it, me synim rritjen e sigurisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre.								
Qeverisje e mirë								
Kuadër ligjor / rregullator i harmonizuar dhe i plotë								
12.1	Forcimi i kuadrit ligjor për sigurinë e digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Akte ligjore dhe nënligjore për sigurinë e digave të hartuara	akte ligjore dhe nënligjore	Kuadri ligjor për sigurinë e digave është hartuar në vitin 2000 dhe nuk transponon asnjë nga direktivat e BE-së. Në këto kushte, me zhvillimin e sektorit të ujit dhe për shkak të nevojës për arritjen së standardeve të BE-së, lind nevoja e rishikimit të tij. Kjo masë synon integrimin e ligjit mbi sigurinë e digave me kuadrin ligjor të sektorëve të tjerë, duke përcaktuar gjithashtu institucionet përgjegjëse në të gjitha nivelet.
Mekanizëm eficient organizimi institucional								
12.2	Konsolidimi i strukturave institucionale politikkbërëse për sigurinë e digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Skema institucionale për sigurinë e digave e hartuar	akt nënligjor	Riorganizimi i strukturave politikkbërëse në ministritë e linjës do të përmirësonte nivelin e planifikimit dhe do të forconte kuadrin ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e brigjeve nga erozioni. Aktualisht nuk ka një strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave mbi sigurinë e digave dhe funksionimin e tyre. Kjo masë synon rishikimin e roleve dhe përgjegjëseve në ministritë dhe orientimin e tyre drejt politikbërjes. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
12.3	Ngritja dhe konsolidimi i një strukture kombëtare studimore shkencore për sektorin e ujit ku pjesë e rëndësishme e saj do të jetë dhe trajtimi i çështjeve të sigurisë së digave	Ministria përgjegjëse për shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave / Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	6,319,000	21,063,000	27,382,000	Strukturë studimore shkencore e krijuar dhe funksionale	akt nënligjor	Aktualisht në Shqipëri ka disa institucione të cilat merren paralelisht me monitorimin e sigurisë së digave. Ky fragmentim e bën të vështirë koordinimin dhe përcaktimin e përgjegjëseve institucionale si edhe krijon shpeshherë mbivendosje. Ngritja e një strukture studimore shkencore për projektimin dhe monitorimin e digave është e domosdoshme për të aplikuar në mënyrë të suksesshme të gjitha standardet si edhe për të realizuar dhe testuar modelet fizike për situata të ndryshme. Nëpërmjet kësaj strukture synohet të propozohen dhe nxiten sisteme inovatore në funksion të marrjes së masave për rritjen e nivelit të sigurisë së digave, përfshirë këtu edhe vlerësimin tekniko-ekonomik të secilës zgjidhje duke konsideruar edhe faktorin e ndryshimeve klimatike. Kjo strukturë synon të krijojë bazën shkencore për të përshatur kushtet natyrore të vendit me zgjidhjet eficiente. Kjo strukturë do të jetë gjithashtu përgjegjëse për sistemin e informacionit për të gjithë sektorin e ujit ku pjesë e rëndësishme e saj do të jetë dhe trajtimi i problematikave të sigurisë së digave. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt, bazuar në nevojat e vazhdueshme për forcimin e kërkimit shkencor për nevoja të zhvillimit të vlerësimit, analizimit dhe klasifikimit të riskut të sigurisë së digave, në përputhje me direktivat e BE-së.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
12.4	Forcimi i strukturave menaxhuese për sigurinë e digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Struktura menaxhuese të ngritura dhe funksionale	akt nënligjor	Strukturat menaxhuese janë themelore për zbatimin e politikave dhe strategjive përkatëse. Me anë të kësaj mase synohet ngritja dhe bërja funksionale e një strukture menaxhuese në nivel baseni ujor e cila do të menaxhojë problemet e sigurisë së digave në përputhje me planet e menaxhimit të baseneve përkatëse. Gjithashtu këto struktura do të jenë përgjegjëse edhe për përgatitjen e bazës së të dhënave dhe do të luajnë rolin kryesor për rishikimin periodik të planeve të emergjencave të sigurisë së digave. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim sa i përket menaxhimit, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
12.5	Riorganizimi i strukturave të monitorimit të sigurisë së digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	9,478,000	31,594,000	41,072,000	Struktura monitorimi të rishikuara	akt nënligjor	Monitorimi i sigurisë së digave dhe të dhënave mbi gjendjen e tyre është treguesi bazë mbi të cilin orientohen politikat, hartohen planet e menaxhimit dhe adresohen investimet. Monitorimi aktualisht është i kufizuar në aspektin financiar dhe teknik. Njëpërmjet kësaj mase synohet të forcohen institucionet monitoruese në nivel qendror dhe të ngrihen strukturat përkatëse në nivel baseni duke plotësuar standardet e BE-së. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, referuar ndryshimeve apo nevojave për ristrukturim, bazuar në detyrimet shtesë që lindin për tu zbatuar nga ndryshimet e direktivave të BE-së.
12.6	Riorganizimi i strukturave të kontrollit të digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	9,478,000	31,594,000	41,072,000	Struktura kontrolli të forcuar	akt nënligjor	Inspektorati i digave është një strukturë e parashikuar me ligj por jo funksionale. Kjo masë do të ndihmojë në realizimin e një kontrolli periodik mbi sigurinë e digave funksionale apo ato në fazë projektimi. Mbikëqyrja e operimit të tyre është mjaft e rëndësishme dhe për këtë nevojitet një staf i përgatitur. Ngritja e këtyre strukturave në nivel baseni është një domosdoshmëri. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert, në kuadër të forcimit të kontrollit mbi sigurinë e digave.
Sistem i qëndrueshëm financiar								
12.7	Ngritja e një sistemi financiar për rikuperimin e kostos për mirëmbajtjen e digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	4,400,000	8,800,000	13,200,000	Sistem financiar mbi bazë rikuperimin e kostove i krijuar dhe funksional	akt nënligjor	Rikuperimi i kostove mbi sigurinë e digave jo vetëm nga buxheti i shtetit por edhe nga burime të tjera alternative, është një domosdoshmëri dhe një nga parimet bazë të Direktivës Kuadër të ujit. Aktualisht, mungon një sistem i vlerësimit të kostove të shkaktuara nga risku i sigurisë së digave. Sistemi aktual i tarifimit mbi mirëmbajtjen e digave, nuk arrin të rikuperojë kostot dhe në shumicën e rasteve nuk aplikohet. Kjo masë synon ngritjen e një sistemi të unifikuar për vlerësimin dhe unifikimin e kostove për mirëmbajtjen e digave, si edhe përcaktimin e mekanizmave të duhur për rikuperimin e kostove. Për periudhën 2021-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspertizë të huaj, bazuar në nevojat e vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve drejt të vlerësimit, analizimit dhe planifikimit të masave për sigurinë e digave bazuar në metodologji të rikuperimit të kostove në përputhje me sandardet dhe direktivat e BE-së.
Kapacitete njerëzore eficiente								
12.8	Rishikimi i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së stafeve teknike	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kriteret e përzgjedhjes së stafeve teknike të punësuar në strukturat përgjegjëse për sigurinë e digave të rishikuara	akt nënligjor	Rishikimi i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së stafeve teknike dhe menaxhuese do të sigurojë rritje të nivelit profesional dhe teknik të stafeve dhe rrjedhimisht përmirësimin dhe zbatimin më të thjeshtë të politikave për sigurinë e digave.
12.9	Organizimi i trajnimeve për çështje që lidhen me sigurinë e digave	ASP / ministritë e linjës	3,160,000	10,532,000	13,692,000	Ngritja dhe funksionimi i degës së trajnimit për sektorin e ujit pranë ASPA	trajnime/ orë trajnimi	Trajnimi në mënyrë të vazhdueshme i stafeve që punojnë në menaxhimin dhe monitorimin e digave është një masë e domosdoshme. Për këtë arsye synohet që të gjitha strukturat të koordinohen njëpërmjet një dege specifike pranë ASPA e cila do të mund të koordinojë të gjitha trajnimet dhe kurrikulat në të gjitha nivelet. Këto trajnime do të finalizohen me certifikimin e punonjësve dhe matjen e performancës dhe efektivitetit të trajnimeve. Për periudhën 2018-2030 është parashikuar një kosto e përafërt për ekspert trajnues, referuar nevojave teknike të stafeve duhet të trajnohen për periudhën në vazhdim.

Tabela 7. Programi i masave qeverisëse

Nr. Ref.	Emërtimi	Institucioni përgjegjës	Buxheti i nevojshëm 2018 - 2020 (lekë)	Buxheti i nevojshëm 2021 - 2030 (lekë)	Buxheti Total i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse	Qëllimi/Shpjegim
12.10	Përmirësimi i kurrikulave për përgatitjen e specialistëve të rinj të ujit	Ministria përgjegjëse për shkencën / universitetet / Akademia e Shkencave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Kurrikula universitare të rishikuara	numër kurrikulash të rishikuara	Përgatitja e ekspertëve të ardhshëm të ujit është një instrument i rëndësishëm për të siguruar kapacitetet e nevojshme për të zbatuar standardet e BE-së për menaxhimin e digave. Aktualisht nuk ka një instrument që të orientojë kuotat e inxhinierëve në fushën e projektimit të digave, me kërkesat dhe nevojat që tregu i punës. Nëpërmjet kësaj mase synohet orientimi i kurrikulave univeristare me kërkesën e tregut të punës për projektimin dhe mirëmbajtjen e digave.
12.11	Përgatitja e një programi sensibilizimi të publikut mbi rrezikun dhe reagimin e nevojshme në rastet e kolapsit të digave	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	<i>Parashikohet të mbulohet me buxhetin dhe kapacitetet aktuale</i>	Program ndërgjegjësimi i publikut mbi rrezikun dhe reagimin e nevojshëm në raste kolapsi të digave.	program i përgatitur	Kjo masë synon hartimin e programeve dhe broshurave informuese për publikun mbi sigurinë e digave dhe rëndësinë që kanë këto struktura për qëllime jetike, mbrojtje nga përmytjet, por edhe zhvillimin ekonomik të zonave përkatëse.
Sistem total i integruar informacioni								
11.29	Rehabilitimi / rikonstruksioni dhe ndërtimi i argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytjet në lumenjtë Mat, Drini i Lezhës, Droje, Drin i Zi, Shkumbin, Devoll, Osum, Seman, Vjosë, Drinos, Bistricë, Pavëlla etj, në pjesën e poshtme të rrjedhës, 300 km	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	2018-2025	6,000,000,000	Argjinatura të rehabilituara	km argjinaturë

Nr.Ref.	Emërtimi	Institucioni Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse
11.30	Ndërtimi/rikonstruksioni i argjinaturave mbrojtëse përgjatë lumenjve kryesore në pjesën e ultësirës perëndimore për të minimizuar rrezikun e përmytjeve në rreth 100 000 ha	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmytja	2018-2020	2,637,752,000	Argjinatura të rehabilituara	km argjinaturë
11.31	Pajisja me rrjetin e monitorimit dhe vendosjen e radarëve në të gjithë territorin	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmytja	2018-2020	45,040,000	Mbulimi i territorit me radarë	% e mbulimit
11.32	Investime për rikthimin e ekosistemeve të dëmtuara nga përmytja	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmytja	2018-2030	68,000,000	Ekosisteme të përmirësuara	sipërfaqe e rehabilituar
Projekte mbështetëse dhe subvencionuese						
11.33	Mirëmbajtje vjetore e argjinaturave ekzistuese dhe përmirësimi I sistemeve ekzistuese	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmytja	2018-2030	250,000,000	Argjinatura të rehabilituara	km argjinaturë
11.34	Subvencionimi i dëmeve nga përmytjet (Ndhmë financiare shtetasve për banesa të dëmtuara)	Ministria përgjegjëse për emergjencat civile / ministria përgjegjëse për financat	2018-2030	9,940,000,000		lekë dëme në vit
11.35	Mirëmbajtja e rrjetit të monitorimit të paralajmërimit të riskut nga përmytja	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmytja / Ministria përgjegjëse për emergjencat civile	2018-2030	54,600,000	Rrjeti i monitorimit funksional	% e mbulimit me monitorim
12	Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e digave në përputhje me kushtet teknike, sipas rekomandimeve të ICOLD-it, me synim rritjen e sigurisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre.					
Studime						
12.13	Analiza bazuar në të dhënat aktuale dhe propozimi i investimeve të nevojshme për të garantuar sigurinë e digave, sipas prioritetit	KKDM / Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2020	10,000,000	Analiza e sigurisë së digave e kryer	analiza lista e propozimeve për investime
12.14	Studimi i gjendjes aktuale dhe evidentimi i ndërhyrjeve emergjente për 416 diga	KKDM / Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2020	140,000,000	Analiza e gjendjes aktuale e hartuar	inventari i ndërhyrjeve


Nr.Ref.	Emërtimi	Institucioni Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse
12.15	Studimi dhe modelimi matematik i përhapjes së valës për të gjithë digat në rast kolapsi	KKDM / Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2030	600,000,000	Modelimi matematik për përhapjen e valës në diga i përgatitur	modelimi matematik
12.16	Përgatitja e projekteve të zbatimit dhe investimi për infrastrukturën e rritjes së sigurisë së digave (rreth 300 diga)	KKDM / Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2020	2,055,000,000	Projekte zbatimi dhe investimi të përfunduara	numër projektesh listë investimesh
12.17	Përgatitja e projekteve për braktisjen e digave që nuk kanë më vlera funksionale (rreth 200 diga)	KKDM / Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2020	275,000,000	Projekte për braktisjen e të digave jo funksionale të përfunduara dhe miratuara	numër projektesh
Investime						
Projekte për të rritur sigurinë e digave						
12.18	Zbatimi i investimeve në 210 digat e analizuar (studimi i Bankës Botërore)	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2030	9,000,000,000	Diga me standarde sigurie të plotësuara	numër digash
12.19	Rehabilitimi i 90 digave të tjera për garantimin e burimit ujqor për ujat dhe rritjen e sigurisë së tyre (vlerësuar paraprakisht nga strukturat e varësisë së MBZHRAU-së)	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2025	1,800,000,000	Diga me standarde sigurie të plotësuara	numër digash
12.20	Rehabilitimi i 40 digave kryesisht për rritjen e sigurisë së tyre (vlerësuar paraprakisht nga strukturat e varësisë së MBZHRAU-së)	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2025	720,000,000	Diga me standarde sigurie të plotësuara	numër digash
12.21	Ristrukturimi i 70 digave për garantimin e sigurisë së tyre dhe nxjerrjen jashtë funksioni (vlerësuar paraprakisht nga strukturat e varësisë së MBZHRAU-së)	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave	2018-2020	840,000,000	Diga me standarde sigurie të plotësuara	numër digash
Projekte mbështetëse dhe subvencionuese						
12.22	Mirëmbajtje vjetore e digave ekzistuese	Ministria përgjegjëse për administrimin e digave / bashkitë	2018-2030	6,260,000,000	diga të mirë mbajtura	numër digash
13	Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit me synim mbrojtjen e tokave me rrezik të lartë erozioni duke forcuar infrastrukturën përkatëse në përgjigje të këtij fenomeni					
Studime						
13.13	Studimi i shkallës dhe tendencave të erozionit në shtretërit dhe brigjet e lumenjve dhe liqeneve	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2030	160,000,000	Studime për vlerësimin e shkallës së erozionit të përgatitura	numër studimesh

Nr.Ref.	Emërtimi	Institucioni Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti i nevojshëm (lekë)	Indikatori	Njësia Matëse
13.14	Studimi i shkallës dhe tendencave të erozionit dhe dinamikës së aluvioneve në vijën bregdetare	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2030	109,769,000	Studime për vlerësimin e shkallës së dinamikës së aluvioneve të përgatitura	numër studimesh
13.15	Studimi në nivel baseni mbi situatën aktuale të inerteve lumore dhe identifikimi i zonave që kanë nevojë të pastrohen	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2020	100,859,000	Studime për vlerësimin e situatës aktuale të inerteve lumore të përgatitura	numër studimesh
13.16	Studim mbi përdorimin e praktikave të mira bujqësore për reduktimin e erozionit	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2020	50,000,000	Studime për reduktimin e erozionit nga praktikatat më të mira bujqësore të përgatitura	numër studimesh
13.17	Studim mbi projektet e pyllëzimit me kosto të ulët të zonave në rrezik erozioni, bazuar në kushtet vendore.	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2020	<i>kosto në buxhete e bashkive</i>	Studime mbi pyllëzimet e zonave nën risk	numër studimesh
13.18	Studim mbi projektet e pyllëzimit me kosto të ulët dhe rregullimi i regjimit të përrenjve të vegjël të zonave në rrezik të lartë erozioni, bazuar në kushtet lokale	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2020	<i>kosto në buxhete e bashkive</i>	Studime mbi pyllëzimet e zonave nën risk	numër studimesh
13.19	Përfshirja e çështjeve të ndryshimeve klimatike në të gjitha aspektet e administrimit e menaxhimit të fondit pyjor (për ndikimin në erozion)	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni / bashkitë	2018-2020	<i>lidhje me koston e parashikuar në planin kombëtar të veprimit për ndryshimet klimatike</i>	Studime mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në erozion	numër studimesh
Investime						
Projekte për të ulur shkallën e erozionit						
13.20	Rehabilitim të infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen nga erozioni (argjinatura, penela lumore)	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2030	<i>kosto e përfshirë në objektivin 11</i>	brigje të rehabilituara	km breg lumor
13.21	Ndërtim i pritave malore	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2025	1,316,250,000	prita malore të ndërtuara	volum materiali inert i depozituar (m3)
13.22	Pyllëzime të reja dhe shtim i vegjetacionit	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2025	7,020,000,000	sipërfaqe e pyllëzuar	ha
13.23	Ndërtim valëpritisish paralel me vijën bregdetare	Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbrojtjes nga erozioni	2018-2025	10,686,000,000	vijë bregdetare e mbrojtur	km vijë bregdetare

Kapitulli III: MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE

Ky kapitull trajton konceptin e ri të mekanizmit të bashkëveprimit të të gjithë aktorëve të sektorit, në funksion të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit eficient të programit kombëtar sektorial të ujit, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara. Ky mekanizëm do të mundësojë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent, për të gjitha aktorët në sektor pavarësisht rëndësisë, rolit dhe kontributit të tyre.

Mekanizmi është konceptuar si një sistem unik bashkëveprimi, funksionimi i të cilit nuk çënon, apo kufizon autonominë e aktorëve në vendimmarrje sipas fushave të tyre të veprimtarisë dhe përgjegjësisë. Pra sistemi i integruar institucional nuk ka si qëllim centralizimin e kompetencave dhe vendimmarrjeve, por në fokus të tij është harmonizimi i nismave që do të ndërmerren me qëllim krijimin e sinergjisë dhe përdorimit optimal të fondeve nga pushteti qendror dhe investimeve të vetë pushtetit vendor.



Ngritja e një mekanizmi të qëndrueshëm, gjykohet si zgjidhja e vetme optimale për përmirësimin e performancës dhe eficiencës së sektorit. Nisur nga kompleksiteti i sektorit, ndarja e qartë e rolit dhe e përgjegjësisë së funksionit të çdo aktori është një garanci, për të patur një planifikim efektiv, monitorim të vazhdueshëm dhe në kohë reale, por dhe një instrument efikas për garantimin e zbatimit të programit.

Në funksion të trajtimit të marrëdhënieve institucionale, në këtë kapitull trajtohet, struktura mbi të cilin mbështetet mekanizmi i bashkëveprimit të aktorëve dhe pozicioni i secilit prej tyre në hierarkinë e funksioneve dhe funksionaliteti i këtij mekanizmi kryesisht në kontekstin e planifikimit të integruar.

3.1. Mekanizmi institucional

Qasja sektoriale zbatohet nëpërmjet mekanizmit institucional, i cili funksionon duke pasur në konsideratë përputhshmërinë me parimet e ndarjes së qartë roleve dhe funksioneve të aktorëve. Ky mekanizëm garanton një ndërveprim vertikal dhe horizontal ndërmjet aktorëve.

3.1.1. Nivelet e mekanizmit institucional

Mekanizmi institucional ku përfshihen të gjithë aktorët në funksion të realizimit të qasjes sektoriale, në kontekstin hierarkik, është i ndarë në katër nivele:

- Nivelin udhëheqës;
- Nivelin drejtues;
- Nivelin manaxherial;
- Nivelin operacional;




Figura 9 Hierarkia e niveleve qeverisëse

3.1.2. Roli i niveleve hierarkike të mekanizmit institucional

3.1.2.1. Roli niveleve hierarkike

Në mënyrë të përmblëdhur roli i secilit niveli hierarkik të mekanizmit institucional janë është:

Niveli udhëheqës:

- Përcakton vizionin, si dhe miraton: Programin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e integruar të ujit, planin e veprimit, plane dhe projekte me rëndësi kombëtare që kanë komponent që lidhen me fushën e ujit;
- Harmonizon financimet nga burime të ndryshme në zbatim të programin kombëtar sektorial për menaxhimin e integruar të ujit;
- Monitoron programin dhe planin e veprimit dhe bën korrektimet përkatëse;

Niveli drejtues:

- Harton dhe propozon për miratim Programin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e integruar të ujit, planin e veprimit, plane dhe projekte me rëndësi kombëtare që kanë komponent që lidhen me fushën e ujit;

- Harton kuadrin rregullator duke përfshirë politika, strategji, standarde dhe rregulla në fushën e ujit;
- Planifikon në PBA-të përkatëse buxhetin e nevojshëm për investimet e pushtetit qendror në zbatim të planeve të veprimit.

Niveli menaxherial:

- Kontribuon në hartimin e programit sektorial dhe të planit të veprimit;
- Propozon listën e prioritizuar të projekteve që kanë nevojë për financim, sipas fushave të përgjegjësisë dhe ndjek zbatimin e tyre;
- Garanton përmbushjen e objektivave kombëtarë nga aktorët institucional, sikurse mbështet me asistencë dhe harmonizon punën e aktorëve të ndryshëm qoftë në planin horizontal, ashtu sikurse dhe në atë vertikal.

Niveli operacional:

- Kontribuon në hartimin e programit sektorial dhe të planit të veprimit;
- Identifikon dhe harton listën e nevojave për investime bazuar në nevojat e përdoruesve dhe raporton mbi ecurinë e investimeve në proces dhe nga burime të ndryshme financimi;
- Ofron drejtpërdrejtë shërbimet dhe ndjek operacionet e përditshme;

3.1.2.2. Mekanizmi institucional niveli udhëheqës

Aktorët

- Këshilli Kombëtar i Ujit

Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore. Ai është organ ndërministror që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Këshilli Kombëtar i Ujit kryen funksionin e GMIP-së për menaxhimin e integruar të ujit. Kryeministri është kryetari i GMIP-së për menaxhimin e integruar të ujit.

- Partnerët zhvillimorë

Në GMIP, Partnerët zhvillimorë përfaqësohen nëpërmjet përfaqësive diplomatike dhe shprehim qëndrimin e tyre mbi Programin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e integruar të ujit, planin e veprimit. Gjithashtu, partnerët zhvillimorë në takimet e GMIP-së, paraqesin strategjitë dhe prioritetet e tyre të investimeve në fushën e ujit, dhe identifikojnë objektivat, masat dhe investimet të cilat mund të mbështeten për zbatim nga secili prej tyre.

- Pushteti vendor

Pushteti vendor në GMIP përfaqësohet nga ministri përgjegjës për çështjet vendore dhe kryetarët e bashkive, të cilët kanë propozuar projekte të cilat kanë nevojë për mbështetje financiare në planet e veprimit.

- Fusha akademike

Në GMIP fusha akademike përfaqësohet nga drejtuesit e akademise së Shkencave të Shqipërisë, dekanët e fakulteteve që në kurrikulat e tyre trajtojnë tematika shkencore dhe teknike në fushën e ujit.

- Përfaqësues të biznesit

Në GMIP biznesi përfaqësohet nga drejtuesit e korporatave apo shoqërive të cilat në aktivitetin e tyre tregtar lidhen drejtëpërdrejtë me menaxhimin e burimeve ujore.

- Përfaqësues të shoqërisë civile

Në GMIP shoqëria civile përfaqësohet nga drejtues shoqatash apo OJF të cilat janë aktive dhe mbrojnë interesa që lidhen me fushën e ujit.

- Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit është organ ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit dhe njëkohësisht shërben si sekretariti teknik i GMIP-së për menaxhimin e integruar të ujit. STKKU-ja është institucioni koordinues që ndjek procesin e hartimit të PKS-së dhe planeve të veprimit nga nëngrupet tematike.

Forma e organizimit

GMIP-ja ofron një strukturë manaxhimi të nivelit të lartë për të siguruar përgatitjen implementimin, monitorimin dhe rregullimin e integruar të politikave dhe veprimeve sektoriale nëpërmjet përgatitjes dhe manaxhimit të koordinuar të Programit Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit, i cili siguron instrumentin transparent dhe të koordinuar për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të politikave në sektorin e ujit. GMIP-ja siguron mekanizmin e duhur për të aksesuar fondet e nevojshme nga buxheti i shtetit ose nga burime financimi të huaja për zbatimin e politikave dhe objektivave kombëtarë. GMIP-ja, si instrument kyç i këtij mekanizmi, siguron që Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) dhe komitetet e tjera të larta ministrore paralele të ruajnë fokusin e tyre strategjik dhe mbikëqyrin në mënyrë efektive zbatimin e programit dhe prioritetëve të qeverisë shqiptare. Rekomandimet strategjike të adresuara nga GMIP-ja për KPS-në dhe komitetet e tjera qeveritare të nivelit të lartë bazohen në një analizë të plotë, konsultime sistematike dhe gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët e sipër përmendur, anëtarë të GMIP-së, si dhe përafrimin e buxhetit dhe burimeve të tjera financiare me programin e prioritetet e qeverisë.

Sekretariti teknik i GMIP-së për menaxhimin e integruar të ujit harmonizon dhe standardizon rekomandimet e dhëna nga GMIP-ja me propozimet e dhëna nga nëngrupet tematike dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces. Sekretariati Teknik i GMIP-së siguron ofrimin e shërbimeve teknike, administrative, të komunikimit dhe koordinimit në të gjitha strukturat e

GMIP-së. Sekretariati ka autoritetin të lidhet me të gjithë anëtarët e GMIP-së dhe të sigurojë kontributet e tyre në punën e grupit.

Detyrat

Për zbatimin e kësaj qasjeje është ngritur Grupi për Manaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP) për Manaxhimin e Integruar të Ujit (MIU) miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 129 datë 21.09.2015“Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave“. Roli i GMIP-së është të këshillojë, drejtojë dhe koordinojë institucionet e përfshira në sektor, të zhvillojë dhe të zbatojë një Program Kombëtar Sektorial (përfshirë një Program për Mbështetje Sektoriale që tregon burimet e financimit, shtetërore dhe të huaja për masat e ndryshme), të sigurojë dakordësi për çështje kyçe që ndikojnë në sektor, të miratojë listën e vetme sektoriale të projekteve prioritare strategjike, të miratojë rezultatet e punës së ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm dhe të bëjë rekomandime për vendimmarrësit e nivelit të lartë.

Detyrat e GMIP listohen si më poshtë:

- Udhëheq procesin e hartimit të PKS-së dhe politikave sektoriale në përputhje me prioritetet e qeverisë Shqiptare, SKZHI-në, PBA-në dhe procesin e integritit evropian;
- Udhëheq dhe propozon mënyrën më eficiente të shfrytëzimit të burimeve financiare që janë në dispozicion;
- Mbikëqyr procesin e përgatitjes së PKS-së duke përfshirë në të edhe PMS-në;
- Garanton që PKS-ja (përfshi këtu planin e veprimit) të jetë në përputhje me etapat e rëndësishme të parashikuara në planin kombëtar për integrimin në BE dhe rekomandimet e Progres Raportëve vjetore të BE-së sipas rastit;
- Garanton një proces konsultimi gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm me të gjitha palët e interesuara duke përfshirë shpërndarjen e informacionit strategjik në sektor për të gjithë anëtarët dhe një audiencë më të gjerë;
- Rekomandon përshtatjen e strategjisë dhe planit të veprimit nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh arritjet, rrethanat e ndryshuara dhe mësimet e nxjerra si dhe progresin në procesin e integritit në BE;
- Kontribuon në një qëndrueshmëri më të madhe, në integrimin e reformave si edhe aktiviteteve sektoriale të sektorit si edhe në bashkërendimin mes sektorëve për çështjet ndërsektoriale;
- Promovon ndërgjegjësimin për arritjet dhe sfidat në sektor për publikun shqiptar dhe audiencat ndërkombëtare sipas rastit;
- Siguron menaxhimin efikas të ndihmës së huaj nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim, ku diskutohet për politikat/prioritetet, financimet dhe problematikat në sektor;
- Përcakton përbërjen e nëngrupeve tematike dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre;
- Përcakton objektivat dhe prioritetet e PKS-së duke analizuar propozimet e dhëna nga nëngrupet tematike;

- Miraton planin e punës dhe axhendën e GMIP-së;
- Miraton listën e vetme sektoriale të projekteve prioritare strategjike;
- Monitoron progresin në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në PKS, duke vlerësuar arritjet e treguesve përkatës të SKZHI-së dhe objektivat e PKS-së;
- Monitoron zbatimin e strategjive aktuale, programeve, dhe/ose politikave;
- Monitoron ecurinë e mbështetjes buxhetore të orfuar nga BE; si edhe realizimin dhe përthithjen e fondeve të tjera ofruara nga partnerët zhvillimorë;
- Siguron përfshirjen e qasjes së barazisë gjinore në proceset që zhvillon GMIP.

Gjithashtu, në mbështetje të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 129, datë 21.09.2015 “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave“, janë percaktuar edhe detyrat e sekretaritit të GMIP-së të cilat listohen si më poshtë:

- Udhëheq procesin e vendosjes së objektivave strategjikë të sektorit;
- Udhëheq procesin e hartimit dhe miratimit të matricës unike të prioritizimit të projekteve të sektorit;
- Udhëheq procesin e analizës së hendekut financiar, në bashkëpunim me nëngrupet tematike;
- Koordinon të gjithë palët e përfshira në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të PKS-së;
- Lehtëson procesin e komunikimit ndërmjet nëngrupeve tematike;
- Harmonizon raportet dhe dokumentet e përcjella nga nëngrupet tematike;
- Manaxhon sistemin e informacionit për nëngrupet tematike për zbatimin e PKS-së;
- Përgatit dhe monitoron programin e punës së nëngrupeve tematike;
- Përgatit programin vjetor të punës së GMIP-së bazuar në PKS-në dhe në kalendarin e SPI-së;
- Përgatit raportet e diskutimit dhe dokumentet informuese për takimet e GMIP-së dhe nëngrupeve tematike;
- Merr pjesë në të gjitha takimet e GMIP-së dhe nëngrupeve tematike në rolin e mbikqyrësit, mban minutat e takimeve dhe informon pjesëmarrësit për diskutimet dhe detyrat e lëna për ndjekje;
- Mirëmban një inventar të azhurnuar të të gjitha programeve të asistencës financiare dhe të të gjitha projekteve të sektorit;
- Identifikon nevojat për rritjen e kapaciteteve;
- Organizon takimet e GMIP-së dhe nëngrupeve tematike;
- Organizon mbledhjet mujore me kryetarët e nëngrupeve tematike;
- Monitoron përmbushjen e detyrave të çdo nëngrupi tematik, në bazë të planit vjetor të punës;
- Bashkëpunon dhe përgatit raporte mujore për Sekretariatit Teknik të KPS-së (Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, Kryeministri);
- Paraqet çështjet për vendimarrje pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik nëpërmjet Sekretariatit Teknik të KPS-së;

- Bashkëpunon me grupet ndërminstrore të punës të drejtuara nga Ministria e Integritimit Evropian, në kuadër të procesit të integritimit në BE;
- Bashkëpunon ngushtësisht me Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri;
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit/Drejtorinë e Programimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me PBA-në;
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve në zyrën e Kryeministrit dhe në ministrinë udhëheqëse, në lidhje me prioritetet e qeverisë;
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Koordinimit dhe Jetësimit të Prioriteteve të Politikave Ekonomike pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në lidhje me programin e investimeve publike;
- Bashkëpunon me sekretariatet e komiteteve respektive qeveritare të nivelit të lartë në lidhje me kontributet përkatëse nga GMIP-të për punën e këtyre komiteteve;
- Fton partnerët zhvillimorë në takimet e GMIP-ve dhe nëngrupeve tematike;
- Bashkëpunon me partnerët zhvillimorë dhe me pikat fokale të nëngrupeve tematike në lidhje me organizmin e mbledhjeve të GMIP-ve dhe nën-grupeve tematike, axhendat dhe çështjet respektive dhe koordinimin për sigurimin e kontributeve të pritshme;

3.1.2.3. Mekanizmi institucional niveli drejtues

Aktorët

- Nëngrupet tematike

Nëngrupet tematike janë instrumenti kryesor i këtij sistemi nisur nga fakti që i gjithë procesi i integritimit dhe dakordësimit ndërinstitucional mbi propozimet e ardhura, bëhet brenda këtyre nëngrupeve.

- Ministrinë e linjës

Ministrinë e linjës hartojnë politika, strategji, rregulla dhe standarde në përmbushje të detyrimeve të tyre ligjore. Ato kanë përfaqësuesit e tyre në nëngrupet tematike të cilët propozojnë dhe negociojnë mes tyre për objektivat, masat dhe aktivitetet e nevojshme në zbatim të tyre.

- Pikat fokale të partnerëve zhvillimorë

Pikat fokale të partnerëve zhvillimorë në nëngrupet tematike janë përfaqësuesit e përcaktuar, të cilët shprehin qëndrimin e partnerëve zhvillimorë, që në procesin e hartimit të PKS dhe planeve të veprimit. Këta përfaqësues organizojnë nga ana e tyre takime periodike ndërmjet partnerëve zhvillimorë ku informojnë mbi ecurinë, problematikat dhe nevojat e sektorit.

- Përfaqësuesit e pushtetit vendor

Përfaqësimi i pushtetit vendor në pamundësi të pjesëmarrjes së 61 bashkive bëhet nëpërmjet drejtuesve të shoqatave që përfaqësojnë këta të fundit. Këta përfaqësues raportojnë në mënyrë periodike mbi ecurinë, problematikat dhe nevojat e sektorit.

- Shoqatat dhe grupet e interesit

Shoqatat e dhe grupet e interesit janë të përfshirë në proces që në fazat e hartimit të PKS dhe planeve të veprimit. Ky përfaqësim që në këto faza i shërben transparencës dhe përfshirjes së këndvështrimeve dhe interesave të ndryshme në fushën e ujit.

Forma e organizimit

Në përbërje të nëngrupeve tematike sikurse përmendet edhe më sipër janë përfaqësues të ministrive të linjës që kanë në fushën e përgjegjësisë çështje që lidhen me ujin, ministritë përgjegjëse për financat, ekonominë dhe integrimin europian, pikat fokale të caktuara nga donatorët, përfaqësues të pushtetit vendor dhe përfaqësues të grupeve të interesit. Këto nëngrupe tematike udhëhiqen nga ministria e linjës që është më afër fushës së përgjegjësisë që trajton nëngrupi tematik. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë dhe objektivave nëpërmjet analizimit, vlerësimit dhe propozimit të ndryshimeve të nevojshme që synojnë respektivisht:

- **Nëngrupi tematik “Ujë për njerëz”**

Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura urbane duke siguruar respektimin e standardeve dhe mbrojtjen e mjedisit ujqor.

- **Nëngrupi tematik “Ujë për ushqim”**

Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ujitjes dhe kullimit, peshkimit, akuakulturës dhe zvogëlimit të pasojave nga përmytja dhe thatësira, duke respektuar standardet dhe mbrojtjen e mjedisit ujqor.

- **Nëngrupi tematik “Ujë për mjedis”**

Mbrojtjen e cilësisë dhe sasisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ruajtjen e biodiversitetit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

- **Nëngrupi tematik “Ujë për industri dhe përdorime të tjera”**

Përdorimin e burimeve ujore për qëllime industriale, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, duke respektuar standardet dhe mbrojtjen e mjedisit ujqor.

Detyrat

Nëngrupi tematik ka detyrat e mëposhtme:

- Identifikon dhe trajton problemet kryesore institucionale, ligjore dhe financiare në kuadër të hartimit të PKS-së, konform prioriteve të qeverisë, SKZHI-së, mundësive financiare dhe procesit të integritimit në BE;
- Kontribuon në hartimin e PKS-së sipas fushës së përgjegjësisë, që mbulon:
 - Qasja e përgjithshme ndaj politikave;
 - Strategjia/plani i masave;
 - Buxheti i nevojshëm.

- Monitoron zbatimin e PKS-së dhe propozon ndryshimet e nevojshme;
- Harton matricën e prioritizimit të projekteve të sektorit, sipas fushës së përgjegjësisë së nëngrupit tematik;
- Shqyrton PBA-në për t'u siguruar që kërkesat e parashikuara për financim të jenë në përputhje me prioritet e specifikuar në dokumentet strategjike të sektorit, me PKS-në, dhe propozon ndryshimet përkatëse;
- Trajton problematika emergjente të sektorit dhe propozon zgjidhje konkrete, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon;
- Harton planet vjetore, në bashkëpunim me sekretariatit e GMIP-së, për vitin pasardhës dhe për PKS-në;
- Harton listën e prioritizuar të investimeve për planin vjetor sipas formateve dhe afateve të përcaktuara;
- Integron në planin vjetor propozimet e ardhura nga niveli manaxherial, operacional dhe pushteti vendor sipas fushës që mbulon nëngrupi tematik;
- Përgatit materialet dhe raportet e ndryshme sipas fushës së përgjegjësisë;
- Bashkëpunon me grupet e interesit të cilët nuk janë anëtarë të nëngrupeve tematike;
- Bashkëpunon me nëngrupet e tjera, sipas rastit;
- Merr pjesë në hartimin e planit vjetor të punës së GMIP-së;
- I përcjell për dijeni ministrave të ministrive të linjës dhe sekretariatit të GMIP-së të gjitha përfundimet dhe propozimet e arritura gjatë diskutimeve të nëngrupeve tematike.

Ministritë e linjës janë përgjegjëse për një çështje të caktuar të lidhur me sektorin e ujit, referuar fushës së tyre të përgjegjësisë, udhëheqin punën e nëngrupeve tematike. Drejtoritë përkatëse në ministrinë udhëheqëse të nëngrupit tematik luajnë rolin e sekretarisë në veprimtarinë e çdo nëngrupi tematik.

Harmonizojnë planet e veprimit dhe përcjellin në nëngrupin tematik përkatës planin e veprimit dhe listën e prioritizuar të projekteve të propozuara, nga institucionet apo agjencitë në varësi të tyre, pushteti vendor dhe niveli operacional. Në fazën e zbatimit të planeve vjetore ministritë përmbushin të gjitha detyrimet e tyre referuar planit duke harmonizuar dhe përfshirë në programin e punës së ministrisë, komponentët përkatëse të PKS-së të miratuar.

Politikat dhe kuadri ligjor i propozuar duhet të pasqyrojnë plotësisht qëndrimet dhe rekomandimet e GMIP-së.

3.1.2.4. Mekanizmi institucional niveli menaxhues

Niveli manaxherial përbëhet nga agjencitë apo institucione në varësi të ministrive, të cilat në fushën e tyre të përgjegjësisë trajtojnë aspekte të ndryshme të sektorit të ujit.

Aktorët

- Agjencitë

Janë institucione varësie të organizuar në nivel qendror apo vendor, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujit që ato operojnë. Këto struktura institucionale shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për të lidhur politikën dhe investimet e pushtetit qendror me ato të pushtetit vendor në funksion të arritjes së objektivave kombëtare.

- Drejtoritë Rajonale

Drejtoritë rajonale janë institucione qendrore që operojnë në nivel vendor (qarqe, basene apo rajone). Këto struktura kanë funksione menaxhuese dhe administrojnë asetet dhe veprimtarinë në fushën e ujit, të cilat janë funksion i pushtetit qendror. Këto struktura institucionale shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për të lidhur me politikën dhe investimet e pushtetit qendror me ato të pushtetit vendor në funksion të arritjes së objektivave kombëtare.

- Institucionet shkencore

Institucionet kërkimore shkencore në fushën e ujit ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel qendror të mbështetura nga zyrat e tyre lokale. Këto institucione mbështesin me rekomandim dhe ekspertizë teknike të gjitha nivelet qeverisëse sipas nevojave.

Forma e organizimit

Agjencitë/drejtoritë rajonale janë institucionet që bëjnë të zbatueshme politikën dhe vendimmarrjet e GMIP-së në nivel baseni, duke harmonizuar dhe vlerësuar teknikisht nevojat për investime që vijnë nga niveli operacional dhe pushteti vendor njëkohësisht për sektorë të ndryshëm përpara dërgimit në nëngrupin tematik përkatës.

Në fazën e zbatimit këto struktura do të kujdesen për organizimin e punës dhe zbatimin e planeve në përputhje me parashikimin dhe politikën e miratuara. Me forcimin e strukturave menaxhuese në nivel vendor do të krijohet një lidhje më homogjene e nivelit politikbërës me atë operacional duke synuar drejt pavarësisë financiare të basenit, vetëfinancimit dhe rekuperimit të kostove. Niveli manaxherial duhet të ketë një marrëdhënie të vazhdueshme me rezultatet dhe konkluzionet shkencore duke i marrë këto të fundit në konsideratë dhe përfshirë në proceset e planifikimit dhe zbatimit të politikave.

Detyrat

Agjencitë/drejtoritë rajonale në veprimtarinë e tyre përvec detyrave të tjera që ngarkon kuadri ligjor përmbushin këto detyra si më poshtë:

- Të ndjekin dhe menaxhojnë zbatimin e strategjive e planeve në përputhje me politikën e qeverisë dhe PKS;
- Të menaxhojnë projekte të cilat shtrihen në më shumë se një bashki dhe ato projekte të cilat nuk administrohen, apo arrijnë të administrohen nga pushteti vendor;
- Të paraqesin pranë nëngrupeve tematike listën e prioritizuar të investimeve për secilën nga bashkitë përkatëse, duke aplikuar matricën e prioritizimit të miratuar në PKS;
- Të përgatisë raporte periodike dhe raportin vjetor të monitorimit dhe ecurisë së investimeve.

- Të kryejë detyra të tjera menaxheriale që i ngarkohen nga niveli udhëheqës dhe drejtues. Institucionet shkencore në veprimtarinë e tyre, përveç detyrave të tjera që ngarkon kuadri ligjor, përmbushin këto detyra si më poshtë:

- Kryejnë studime shkencore në fushën e ujit;
- Monitorojnë me anë të stacioneve dhe laboratorëve ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe detare nga pikëpamja sasisore dhe cilësore, në përputhje me standardet dhe kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit;
- Mbështesin me konsulencë teknike sipas nevojave të gjitha institucionet publike të interesuara;
- Çertifikojnë studimet dhe dokumentat teknikë me karakter shkencor të prodhuar nga konsulencia dhe institucione të tjera private apo publike;
- Propozojnë për miratim standardet teknike të projektimit, zbatimit, monitorimit dhe përdorimit të burimeve ujore për qëllime të ndryshme;
- Propozojnë rishikimin e këtyre standardeve çdo tre vjet duke i përshtatur me zhvillimet më të fundit të teknologjisë dhe ndryshimeve klimatike.

3.1.2.5. Mekanizmi institucional niveli operacional

Aktorët

- Bashkitë

Bashkitë me reformën e autonomisë vendore luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve në fushën e ujit të cilat janë decentralizuar. Ato evidentojnë nevojat për investime dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me përdoruesit dhe përfituesit e shërbimeve. Nisur nga pavarësia që ato gëzojnë, Bashkitë hartojnë politikat e tyre të zhvillimit në fushën e ujit, të cilat duhet të jenë në përputhje me strategjitë dhe objektivat kombëtarë.

- Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve

Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura tek qytetarët. Këto ndërmarrje evidentojnë problematikat dhe nevojat për investime me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e performancës.

- Ndërmarrjet shtetërore

Ndërmarrjet shtetërore kryejnë veprimtari operacionale në terren në fusha të ndryshme të ujit dhe mbulojnë ato shërbime të cilat nuk arrijnë të mbulohen nga pushteti vendor, apo shtrihen në më shumë se një bashki. Këto ndërmarrje janë në varësi të ministrive të linjës sipas fushave të përgjegjësisë që ato mbulojnë.

Forma e organizimit

Niveli operacional ofron shërbimin drejtëpërdrejtë tek konsumatori. Një pjesë e këtyre shërbimeve janë decentralizuar dhe realizohen nga vetë bashkitë. Për shërbime të tjera publike

të cilat nuk mbulohen nga pushteti vendor ministritë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë ofrojnë këto shërbime nëpërmjet ndërmarrjeve të ndryshme. Ky nivel është përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime dhe propozimin e tyre pranë bashkive apo agjencive përkatëse sipas rastit dhe varësisë institucionale. Gjithashtu ndjekja e zbatimit të investimeve dhe kur është e mundur kontraktimi i tyre.

Detyrat

Bashkitë, krahas detyrave të tjera që ngarkon kuadri ligjor, përmbushin këto detyra si më poshtë:

- Identifikojnë nevojat për investime për shërbimet në fushën e ujit të cilat janë në varësinë e tyre institucionale;
- Realizojnë investime në fushën e ujit me buxhetin e pushtetit vendor dhe i raporton treguesit dhe ecurinë e tyre për transparencë në nivelin menaxherial (sipas formateve përkatëse);
- Kontraktojnë investimet kur është e mundur për projektet e miratuara;
- Zbatojnë investimet e akorduara nga pushteti qendror në fushën e ujit brenda territorit të tyre administrativ për shërbime të decentralizuara;
- Raportojnë në mënyrë periodike sipas formateve të përcaktuara mbi ecurinë.

Ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, krahas detyrave të tjera që ngarkon kuadri ligjor, përmbushin këto detyra si më poshtë:

- Identifikojnë nevojat për investime për furnizimin me ujë, shkarkimin e ujërave të ndotur dhe trajtimin e ujërave të ndotur urbanë;
- Raportojnë në mënyrë periodike për treguesit teknik dhe financiarë të performancës së ndërmarrjes;
- Raportojnë në mënyrë periodike për ecurinë e zbatimit të investimeve;

Ndërmarrjet shtetërore, krahas detyrave të tjera që ngarkon kuadri ligjor, përmbushin këto detyra si më poshtë:

- Ofrojnë shërbimin sipas fushës së përgjegjësisë, duke u përgjigjur për funksionimin dhe administrimin e infrastrukturës;
- Identifikojnë nevojat për investime sipas fushës së përgjegjësisë që ato mbulojnë;
- Raportojnë në mënyrë periodike për treguesit teknik dhe financiarë të performancës së ndërmarrjes;
- Raportojnë në mënyrë periodike për ecurinë e zbatimit të investimeve;




Figura 10 Skema e aktorëve sipas niveleve qeverisëse

3.2. Metodologjia e zbatimit të PKS

Qëllimi i këtij mekanizmi institucional është përmbushja e vizionit të sektorit dhe arritja e objektivave nëpërmjet maksimizimit të efektshmërisë së masave si rezultat i harmonizimit. Për të munduruar këtë funksionalitet ky mekanizëm është përgjegjës për zbatimin e programit kombëtar sektorial, duke filluar nga planifikimi, menaxhimi dhe operimi.

Planifikimi është një proces kompleks i cili ka për synim harmonizimin e nevojave nga fusha të ndryshme me burimet financiare të kufizuara, duke u bazuar në standarde të unifikuara dhe duke siguruar një proces transparent dhe gjithë përfshirës. Qëllimi i planifikimit nëpërmjet këtij mekanizmi është edhe harmonizimi i projekteve që financohen nga pushteti qendror dhe ai vendor duke i orientuar drejt objektivave kombëtare.

3.2.1 Hierarkia e planifikimit

Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit 2018-2030 përcakton vizionin, objektivat dhe projektin pikësynimet e sektorit të ujit për një periudhë 13-vjeçare. Kjo është korniza kryesore që rregullon dhe orienton sektorin e ujit për periudhën e planifikuar. Në këtë dokument është përcaktuar programi i masave i cili përfshin masat kryesore qeverisëse, studimet e identifikuar dhe kategorizimin e projekteve infrastrukturore.

Në zbatim të këtij programi përgatitet plani i veprimit i cili ka një projektion 3 vjeçar. Planin e veprimit duhet detyrimisht të jenë brenda kornizës së përcaktuar nga PKS-ja dhe të jetë i strukturuar sipas formateve përkatëse në zbatim të masave qeverisëse, studimeve dhe investimeve infrastrukturore, të cilat detajohen deri në aktivitetet përkatëse.

Në zbatim të planit të veprimit institucionet përgjegjëse përgatisin planet e tyre institucionale, ku detajohen aktivitetet dhe proceset që duhet të ndiqen në zbatim të planeve të veprimit.




Figura 11. Metodologjia e hartimit të PKS, PV dhe planit vjetor institucional.

Planifikimi për zbatimin e PKS-së është procesi i përgatitjes së listës së masave, aktiviteteve qeverisëse dhe infrastrukturore të kostuara dhe shtrira në kohë në funksion të arritjes së objektivave. Transparenca e investimeve nga burime të ndryshme financimi, do të bëjë një identifikim më të mirë të situatës aktuale, do të shmangë mbivendosi dhe risë eficientë të investimeve.

Planifikimi bëhet për dy kategori masash, ato me karakter qeverisës dhe ato me karakter studimor dhe infrastrukturor.

Planifikimi i masave me karakter qeverisës lidhet me politikat në kuadrin ligjor, institucional, financiar, burimet njerëzore dhe sistemin e informacionit. Nga vetë karakteri që këto masa kanë lidhen kryesisht me nivelin drejtues, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave. Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe përshtatjes së standardeve, lind nevoja që edhe niveli manaxherial dhe operacional të planifikojnë masa dhe aktivitetet me karakter qeverisës. Të gjitha këto masa përfshihen në procesin e përgatitjes së planit të veprimit për trevjeçarin pasardhës.

Planifikimi i studimeve dhe investimeve infrastrukturore është i fokusuar në zbatimin e masave, që janë të domosdoshme për konkretizimin fizik dhe zbatimin me sukses të politikave, arritjen e objektivave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Këto investime zënë pjesën më

të madhe të buxhetit, krahasuar me masat me karakter qeverisë. Ky planifikim bazohet në nevojat e identifikuar nga pushteti vendor dhe investimet që orientohen nga pushteti qendror dhe pasi ndjekin të gjithë procesin dhe standardet e vendosura për këtë dokument harmonizohen në planin e veprimit të trevjeçarit pasardhës.

Me anë të kësaj qasje të re duke pasur objektiva kombëtar, synohet që në fazën e planifikimit të bëhet një integrim i masave qeverisëse dhe infrastrukturore duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e mundshme të financimit. Kjo mënyrë planifikimi harmonizon investimet e pushtetit qendror dhe ato të pushtetit vendor me objektivat kombëtare, por pa cënuar pavarësinë e këtyre dy pushteteve. Në Programin Kombëtar të Sektorit për manaxhimin e integruar të ujit planifikimi do të bëhet nëpërmjet një procesi të standardizuar, që është i koordinuar me fazat e përgatitjes së PBA-së për pushtetin qendror dhe buxhetit të pushtetit vendor. Kjo pasqyrohet në planet e veprimit të cilat shtrihen për një periudhë trevjeçare dhe rishikohen çdo vit.

3.2.2 Parimet e planifikimit

Parimet e planifikimit dhe vlerësimit të listës së projekteve të propozuara për të pasur një transparencë dhe shpërndarje të drejtë do të bazohet në këto parime:

- përparësia sektoriale dhe/ose territoriale, në përputhje me përparësitë e politikës shtetërore në zhvillimin rajonal e vendor;
- trajtimi në mënyrë të drejtë e të barabartë i njësive të qeverisjes vendore, në kushte të ngjashme ndërmjet tyre;
- zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;
- nxitja e pjesëmarrjes së komuniteteve vendore në identifikimin e nevojave e të përparësive vendore, zbatimin e projekteve dhe monitorimin e tyre;
- bashkëkontributi i njësive të qeverisjes vendore në financimin e projekteve;
- bashkëpunimi ndërmjet njësive të qeverisjes vendore;
- konkurrenca ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, sipas nevojave, dobishmërisë publike të projekteve dhe plotësimit më të mirë të parimeve të tjera, të miratuara;
- parime e kritere të tjera, të përcaktuara në marrëveshjet me donatorët apo në kushtet e përcaktuara për fondet e dhëna nga buxheti i shtetit.

3.2.3 Matricat e prioritizimit të projekteve

Matricat e prioritizimit janë instrumenti bazë i vlerësimit dhe i prioritizimit të projekteve të ndryshme nga aplikues të ndryshëm me të njëjtën standard dhe metodologji. Matricat e miratuara në këtë dokument rishikohen çdo vit nëse është e nevojshme për të shtuar, ose hequr elementë dhe rivlerësuar peshat e pikëzimit. Megjithatë, në raste kur është e nevojshme për të gjykuar përtej elementëve të këtyre matricave, çdo vendimmarrje bëhet në përputhje me parimet e procesit të planifikimit.

3.3. Metodologjia

3.3.1 Planifikimi i masave qeverisëse

Identifikimi i masave të nevojshme qeverisëse propozohet në formë kërkesash narrative duke shpjeguar qëllimin, problematikën dhe rezultatet e pritshme, sikurse edhe efektet financiare. Kjo bëhet nga të gjitha nivelet qeverisëse dhe i dërgohet ministrive përkatëse, për ta përfshirë në draftin e planit të veprimit. Të gjitha propozimet diskutohen në mbledhjet e nëngrupeve tematike.

3.3.2 Planifikimi i masave infrastrukturore

Planifikimi i investimeve infrastrukturore kryesisht bazohet në nevojat e nivelit operacional, ku përfshihen bashkitë, agjencitë, drejtoritë rajonale dhe ndërmarrje apo institucione në varësi të pushtetit qendror. Në këtë planifikim nuk përjashtohen edhe investime të identifikuar nga vetë pushteti qendror, të cilat kanë rëndësi kombëtare dhe strategjike.

Aplikuesi i cili identifikon projektet për tu përfshirë në planin e veprimit, është/janë persona juridik publik të cilët mund të jenë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që vetëfinancohen ose mbështeten nga buxheti i shtetit, bashkitë, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si persona juridikë. Aplikuesi mund të jetë vetë përfituesi direkt i financimit, ose institucioni i cili ka në varësi përfituesin, kur ky i fundit nuk ka statusin dhe kapacitetin e nevojshëm teknik dhe institucional për të bërë aplikimin. Ky nivel në kuadrin institucional përfaqësohet kryesisht nga niveli operacional.

Aplikuesit brenda javës së fundit të muajit janar, përgatisin listën e nevojave të cilat janë brenda fushës së përgjegjësisë që ata mbulojnë dhe lidhen drejtpërdrejt me një apo më shumë objektiva të përcaktuar në PKS. Aplikuesi, për të përfituar financime nga buxheti i shtetit për shërbime të sektorit të ujit, që janë decentralizuar tek pushteti vendor, është i detyruar që të plotësojë formatin e aplikimit sipas udhëzimit të ministrisë së financave si dhe elementet tregues të prioritizimit të projektit sipas formatit të aplikimit për investime (shih shtojcën 2). Projektet për të cilat kërkohet financim, duhet të jenë në funksion të plotësimit të një prej objektivave kombëtare të përcaktuar në PKS. Këto formate plotësohen për çdo projekt më vete. Projektet e propozuar mund të kenë nevojë për financim të plotë apo të pjesshëm. Në rastin e projekteve që kërkojnë financim të pjesshëm specifikohen edhe të dhënat e nevojshme, për pjesën e siguruar të financimit. Lista e projekteve plotësohet në përputhje me formatin e aplikimit për investime, sipas udhëzimeve përkatëse dhe i përcillet institucionit aplikues së bashku me udhëzimin përkatës të miratuar edhe nga ministria e financave.

Për tu mbështetur në mënyrë transparente dhe efikase me investime, të gjithë aplikuesit duhet detyrimisht të japin informacion edhe për projekte të cilat financohen nga buxhetet vetjake apo burime të ndryshme financimi. Formatin e raportimit të këtyre projekteve të planifikuara apo në proces jepet në shtojcën 2. Elementet tregues të prioritizimit të cilët përkohjnë me elementet e listuar në matricat e prioritizimit, plotësohen për çdo projekt në proces apo të planifikuar në të ardhmen.

Paketa e projekteve që kanë nevojë për financim, shoqërohet me një raport përmbledhës ku duhet të përshkruhen rezultatet e pritshme nga këto projekte, lidhja që ato mund të kenë me njëri-tjetrin dhe prioritizimi i renditur sipas vlerësimit të vetë aplikuesit.

Deri në javën e parë të muajit shkurt, aplikuesit dërgojnë listën e nevojave zyrtarisht në agjencitë apo drejtoritë rajonale përkatëse. Në rastet kur këto struktura nuk janë ngritur apo konsoliduar ende, aplikimet dërgohen pranë ministrive përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë që kanë, për ndjekjen e objektivave kombëtare.

Gjithsesi prioritizimi final i listës së projekteve, do të bëhet nga niveli manaxherial dhe drejtues bazuar në metodologjinë dhe matricat e prioritizimit të përcaktuara në këtë dokument.

3.3.3 Vlerësimi i listës së projekteve

Vlerësimi sipas matricave të prioritizimit aplikohen për të gjitha projekt propozimet e identifikuar. Formatet e aplikimit pas dërgimit nga aplikuesit kontrollohen për sa i përket përmbajtjes formale dhe brenda një jave plotësohen me të dhënat e nevojshme nga aplikuesi.

Vlerësimi i përpuethshmërisë së propozimeve është kompetencë e nivelit manaxherial, bazuar në kuadrin institucional të propozuar. Në rastet kur niveli manaxherial duke përfshirë këtu agjencitë, dhe drejtoritë rajonale e ka të pamundur nga pikëpamja institucionale dhe teknike për të aplikuar këtë proces vlerësimi, procesi i vlerësimit sipas matricave të prioritizimit për secilin nga projekt propozimet, bëhet nga një nivel më i lartë, deri në ministrinë e linjës, që ka në fushën e përgjegjësisë çështjet që trajtohen.

Brenda një periudhe dy javore institucioni që vlerëson matricën gjeneron listën e prioritizuar të projekteve rezultatet e të cilës i dërgon në nëngrupin tematik përkatës duke bërë me dije aplikuesin. Aplikuesi ka mundësi të bëjë vrejtitet dhe propozimet e tij, të bazuara në procedurën dhe formatet standart brenda një periudhe tre ditore nga publikimi i listës.

Institucioni vlerësues brenda një periudhe dy javore nga marrja zyrtare e listës së projekteve, aplikon vlerësimin e matricës së prioritizimit dhe gjeneron listën e projekteve të prioritizuara sipas një vlerësimi pikësor të gjeneruar.

Lista e projekteve të renditur i dërgohet zyrtarisht kryetarit të nëngrupit tematik, sipas formatit të planit të veprimit (shtojca 2) brenda javës së fundit të muajit shkurt. Gjithashtu lista e projekteve shoqërohet me një raport përmbledhës ku përshkruhet procedura dhe praktika shkresore e ndjekur, shpërndarja e projekteve në rang kombëtar dhe lidhja e rezultateve të pritshme me objektivin kombëtar. Lista e prioritizuar e projekteve dhe raportet përkatëse i shpërndahen anëtarëve të nëngrupeve tematike, duke njoftuar edhe mbledhjen e radhës dy javë nga dërgimi i këtyre materialeve.

3.3.4 Integrimi dhe përpuethshmëria e listës së projekteve

Nëngrupet tematike bëjnë vlerësimin e listës së prioritizuar të projekteve, sa i përket përpuethshmërisë së tyre me PKS-në dhe dokumente të tjerë. Në këtë nivel bëhet verifikimi i përpuethshmërisë së listës së projekteve të propozuara dhe prioritizuara me politikat dhe strategjitë përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë. Nëngrupet tematike, kur e gjykojnë

të nevojshme, kanë të drejtë të verifikojnë në çdo kohë procedurën dhe dokumentacionin përkatës, të dërguar nga aplikuesi dhe procedurat e ndjekura për vlerësimin sipas matricës. Kur në këto procedura identifikohen parregullsi institucionit vlerësues i kërkohet rishikimi i listës brenda një jave.



Nëngrupet tematike së bashku me ministrinë e financave, në bazë të tavaneve financiare të vendosura vlerësojnë mbi nivelin e financimit që mund të marrë secila nga listat me projekte prioritare të renditura.

Lista e projekteve që kanë mundësi të financohen nga buxheti i shtetit dhe lista e projekteve të prioritizuara por që nuk kanë mundur të mbështen

nga buxheti i shtetit i prezantohet donatorëve. Donatorët shqyrtojnë listën e projekteve për një periudhë dy javore dhe negociojnë brenda nëngrupeve tematike mbi mundësit e financimit.

Në rast kur propozimet për financime në projekte të caktuara propozohen nga donatorët, përfshihen në listën e projekteve të planit të veprimit duke plotësuar vetëm elementët tregues referuar matricave, por pa ju nënshtruar procesit të prioritizimit.

3.3.5 *Miratimi i listës së planit të veprimit*

Miratimi i planit të veprimit bëhet nga niveli udheheqës. Në këtë nivel, GMIP-ja dakordëson mbi planin e veprimit dhe për financimin e listës së projekteve dhe aktiviteteve pas një procesi të konsultuar edhe me partnerët zhvillimorë.

Në javën e parë të muajit mars kryetarët e nëngrupeve tematike dërgojnë pranë sekretariatit të GMIP-së zyrtarisht sipas formatit për planin e veprimit (shih shtojcën 2):

- listën e masave me karakter qeverisës për fushën e veprimtarisë së nëngrupit tematik përkatës;
- listën e studimeve dhe investimeve;
- raportin narrativ të përgatitjes së planit të veprimit të firmosur nga të gjithë anëtarët e nëngrupit tematik.

Sekretariati i GMIP-së brenda javës së tretë të muajit mars përgatit planin e veprimit dhe e shpërndan një javë përpara mbledhjes së GMIP-së në të gjithë anëtarët.


3.3.6 *Mekanizmat shtrëngues*

Të gjitha nivelet qeverisëse sipas kuadrit institucional për sektorin e ujit janë të detyruar të respektojnë afatet dhe procedurat përkatëse. Në rast të shkeljes së tyre, përgatitet një raport justifikues i cili vlerësohet nga kryetarët e nëngrupeve tematike dhe sekretariati i GMIP-së në mbledhjen mujore. Nëse justifikimi është i papranueshëm i propozohet drejtuesve të institucioneve marrjen e masave administrative për emrat konkretë të punonjësve të ngarkuar.

3.4. Zbatimi

Procesi i zbatimit fillon pas dakordësimit në GMIP të planeve të veprimit të hartuar dhe finalizuar nga nëngrupet tematike bashkë me STKKU-në. Buxhetet përkatëse të alokuara për sektorë të ndryshëm zbatohen sipas planeve të propozuara dhe shqyrtuara nga KPS-ja. Kjo, sa i përket buxhetit që vihet në dispozicion nga pushteti qendror.

Investimet që bëhen nga pushteti vendor të financuara nga buxheti i tyre apo kredi të marra nga vetë ata, nuk përfshihen në këtë proces prioritizimi, por raportohen në formë statistikore si indikatorë që kontribuojnë në realizimin e objektivave. Kjo procedurë i nënshtrohet procesit të monitorimit dhe hapave të parashikuar në kapitullin V të këtij dokumenti.



Kapitulli IV. BUXHETI I PROGRAMIT KOMBËTAR SEKTORIAL DHE BURIMET E FINANÇIMIT

Ky kapitull paraqet lidhjen ndërmjet objektivave të PKS-së dhe shpërndarjes së burimeve financiare në dispozicion për realizimin e tyre. Në këtë kontekst, do të parashikohen edhe parashikimet për nevojat për financim, të cilat mund të përmbushen drejtpërdrejt nga burimet e brendshme si dhe nga mbështetja nga partnerët zhvillimorë në formën e granteve apo kredive, përfshirë këtu edhe të gjitha mundësitë e tjera të financimit, të cilat parashikojnë shpenzimet kapitale, operacionale dhe asistencën teknike.

4.1. Hendeku Financiar

Një nga elementët kryesorë mbi të cilët funksion financimi i programeve buxhetore është Programi Buxhetor Afatmesëm i cili parashikon mundësitë e financimit për një periudhë tre vjeçare duke patur parasysh ndarjen e tyre në investime dhe shpenzime korente. Kështu, referuar këtij modeli financimi më poshtë paraqiten të dhënat për financimin e sektorit të ujit të ndara sipas objektivave të Programit Kombëtar Sektorial.

4.1.1. Financimi i nevojshëm për përmbushjen e objektivave

Në kapitullin II janë prezantuar objektivat e sektorit për periudhën 2018-2030, masat që do të ndërmerren për përmbushjen e tyre, aktivitetet me kostot përkatëse, si dhe institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre. Në Tabelën 10 paraqiten në formë të përmbledhur të dhënat mbi nevojat totale për financim, financimin e tyre sipas parashikimeve të PBA si dhe hendekun financiar për përmbushjen e secilit objektiv.

Projeksioni financiar i masave konkrete që parashikon ky dokument, siç janë parashikimi i trajnimeve, pagat e punonjësve të administratës etj, të cilat kategorizohen si shpenzime korente janë përfshirë në kostot e produkteve të PBA-ve respektive. Ndërsa shpenzimet e tjera korente të parashikuara në secilin prej produkteve të përfshira në këtë dokument lidhen kryesisht me shërbime konsulence, raporte monitorimi, oponentë teknike, leje/licenca, kontrata etj.

Tabela 10. Të dhëna lidhur me nevojat totale financiare, financimin sipas PBA si dhe hendeku financiar sipas objektivave për periudhën 2018-2030*(në 000 lekë)*

Objektivat	Totali i nevojave për financim (2018-2030)	Financimi sipas PBA-së (2018-2030)	Hendeku Financiar (2018-2030)
Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim të sigurt dhe të vazhdueshëm.	60.349.285	119.719.057	-59.369.772
Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbimin të zonave urbane dhe rurale.	124.169.202	31.993.055	92.176.147
Përmirësimi i sistemeve ujitëse për tokat e ujtitshme bujqësore me synim plotësimin e nevojave të fermerëve me ujë, për të ofruar kushte optimale për rritjen e kulturave bujqësore.	68.281.538	21.765.593	46.515.945
Përmirësimi i sistemeve të drenazhimit për sipërfaqet e ujtitshme bujqësore, me synim garantimin e kushteve optimale për rritjen e kulturave bujqësore.	8.576.641	9.000.640	-423.999
Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA), me synim zhvillimin e ekonomive të akuakulturës duke respektuar kushtet mjedisore.	635.846	15.235	620.611
Shfrytëzimi i potencialeve hidroenergjetike, me synim rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të burimeve ujore për hidroenergji, duke pasur parasysh detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare duke respektuar kushtet mjedisore.	394.168	393.453	715
Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve përkatëse, si dhe duke respektuar kushtet mjedisore.	88.781	30.468	58.313
Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë”, për ato trupa ujorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat sipërfaqësore-lumenj, liqene, ujëra tranzitore/kalimtare, trupa ujorë artificiale dhe shumë të modifikuar).	40.994.465	27.805.195	13.189.270
Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht të mirë, për ata trupa ujorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët” (ujërat nëntokësore).	8.185.331	10.215.049	-2.029.718
Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht “e mirë” për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetar e kalimtar).	1.138.885	8.746.181	-7.607.296

Objektivat	Totali i nevojave për financim (2018-2030)	Financimi sipas PBA-së (2018-2030)	Hendeku Financiar (2018-2030)
Reduktimi i rrezikut dhe humbjeve nga përmytja për jetën, jetesën dhe shëndetin dhe asetëve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve e cila synon përmirësimin e menaxhimit të situatave të mbrojtjes nga përmytja; përmirësimi i infrastrukturës në përgjigje të fatkeqësive natyrore; garantimi i kushteve të sigurta të jetesës për njerëzit, florën dhe faunën në zonat e rrezikuara; sigurimi i asetëve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore për personat, bizneset dhe komunitetet.	34.086.561	5.583.858	28.502.703
Përmirësimi i kushteve teknike të digave, të cilat shfrytëzohen për ujitjen e tokave bujqësore, me synim rritjen e sigurisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre.	21.877.577	1.631.068	20.246.509
Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit me synim mbrojtjen e tokave me rrezik të lartë erozioni duke forcuar infrastrukturën përkatëse në përgjigje të këtij fenomeni.	19.589.775	510.357	19.079.418
TOTALI	388.368.055	237.409.209	150.958.846

Tabela 11 tregon financimin sipas PBA-së të çdo objekti në baza vjetore për periudhën 2015-2018 i cili është paraqitur i detajuar në investime dhe shpenzime korente.

Tabela 11. Financimi për secilin objektiv sipas PBA-së për periudhën 2015-2018.

(në 000 lekë)

Objektivat	Ministria përgjegjëse	Programi Buxhtor	Buxheti 2015		Buxheti 2016		Buxheti 2017		Buxheti 2018	
			Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente
Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullatës me synim mbulimin me shërbim, të sigurtë dhe të vazhdueshëm	MTI	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	3.900.315	1.147.787	5.411.113	713.200	6.153.191	813.100	7.202.711	655.700
Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbim të zonave urbane dhe rurale			3.803.253	207.423	1.721.093	345.930	1.700.562	0	1.776.815	0
Përmirësimi i sistemeve ujitëse për tokat e ujitshme bujqësore me synim plotësimin e nevojave të fermerëve me ujë, për të ofruar kushte optimale për rritjen e kulturave bujqësore	MBZHRAU	Manaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	856.384	9.074	3.204.755	9.074	1.498.537	9.074	1.419.629	9.074
Përmirësimi i sistemeve të kullimit të tokave bujqësore, me synim garantimin e kushteve optimale për rritjen e kulturave bujqësore			965.215	0	446.056	0	580.856	0	590.806	0
Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda zonave të përcaktuara për		Mbështetje për peshkimin	0	1.000	0	1.000	0	1.000	0	1.000

Objektivat	Ministria përgjegjëse	Programi Buxhtor	Buxheti 2015		Buxheti 2016		Buxheti 2017		Buxheti 2018	
			Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente
Akuakulturën (ZPA), me synim zhvillimin e ekonomive duke respektuar kushtet mjedisore										
Shfrytëzimi i potencialeve hidroenergjitike, me synim rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të burimeve ujore për hidroenergj, duke pasur parasysh detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare duke respektuar kushtet mjedisore	MEI	Mbështetje për energjinë	0	17.800	0	21.000	0	21.000	0	26.000
	MTI	Furnizimi me ujë dhe kanalizime								
Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve përkatëse, duke respektuar kushtet mjedisore	MEI	Mbështetje për burimet natyrore	0	1.060	0	2.000	0	1.500	0	2.000
Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë” për ato trupa ujqorë që kanë status “më pak se të mirë” , “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat sipërfaqësore-lumenj, liqene, ujëra tranzitore/kalimtare, trupa	MM	Mbrojtja e mjedisit								
	MTI	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	3.285.102	165.773	965.964	345.908	1.787.179	227.234	1.619.036	206.109
	MBZHRAU	Administrimi i ujërave	2							
	MEI									

Objektivat	Ministria përgjegjëse	Programi Buxhtor	Buxheti 2015		Buxheti 2016		Buxheti 2017		Buxheti 2018	
			Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente
ujorë artificialë dhe shumë të modifikuar).		Mbështetje për burimet natyrore								
Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë”, për ato trupa ujorë që kanë status “më pak se të mirë” , “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat nëntokësore).	MTI MBZHRAU	Furnizim me ujë dhe kanalizime Administrimi i ujërave Mbështetje për burimet natyrore	1.300.555	86.288	394.736	130.348	445.085	97.926	569.050	85.961
Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht "e mirë" për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetar e kalimtar).	MM MTI MBZHRAU MIE	Mbrojtja e Mjedisit Administrimi i ujërave Furnizim me ujë dhe kanalizime Mbështetje për burimet Natyrore	1.917.117	54.288	498.377	79.419	605.924	63.665	495.000	65.824
Reduktimi i rrezikut dhe humbjeve nga përmytja për jetën, jetesën dhe shëndetin dhe aseteve ekonomike, fizike, social -kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve me synim përmirësimin e	MPB MEI MBZHRAU	Mbrojtja civile Mbështetje për burimet natyrore	208.908	46.806	71.009	46.840	241.009	46.840	311.009	47.040

Objektivat	Ministria përgjegjëse	Programi Buxhtor	Buxheti 2015		Buxheti 2016		Buxheti 2017		Buxheti 2018	
			Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente	Investime	Shpenzime korente
manaxhimit të situatave të mbrojtjes nga përmbytja; përmirësimin e infrastrukturës në përgjigje të fatkeqësive natyrore; garantimin e kushteve të sigurta të jetesës për njerëzit, florën dhe faunën në zonat e rrezikuara; sigurimin e aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore për personat, bizneset dhe komunitetet.		Manaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes								
Përmirësimi i kushteve teknike të digave, të cilat shfrytëzohen për ujitjen e tokave bujqësore, me synim rritjen e cilësisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre.	MBZHRAU	Manaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	1.167.329	9.074	124.614	9.074	99.032	9.074	97.990	9.074
Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit me synim mbrojtjen e tokave me rrezik të lartë erozioni duke forcuar infrastrukturën përkatëse në përgjigje të këtij fenomeni.	MBZHRAU	Manaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	26.000	0	23.500	0	23.500	0	33.500	0

Edhe për periudhën tjetër të PKS-së 2019-2030 janë parashikuar investimet dhe shpenzimet korente gjithashtu sipas rritjes së parashikuar në SKZHI.

4.1.2. Parashikimi i financimit sipas objektivave për periudhën 2019-2030

Tabela 12 synon të japë një parashikim të financimit sipas PBA-së për secilin nga objektivat për periudhën 2019-2030, duke aplikuar një rritje vjetore prej 2,6% bazuar kjo në parashikimet makroekonomike të bëra në SKZHI 2015-2020.

Tabela 12. Parashikimi mbi financimin sipas PBA për periudhën 2019-2030 për secilin objektiv

(në 000 lekë)


Objektivi	Lloji i financimit	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029	Viti 2030
O1	Investime	7.389.981	7.582.121	7.779.256	7.981.517	8.189.036	8.401.951	8.620.402	8.844.532	9.074.490	9.310.427	9.552.498	9.800.863
	Shpenzime Korente	672.748	690.240	708.186	726.599	745.490	764.873	784.760	805.163	826.098	847.577	869.614	892.223
O2	Investime	1.823.012	1.870.411	1.919.041	1.968.936	2.020.129	2.072.652	2.126.541	2.181.831	2.238.559	2.296.762	2.356.477	2.417.746
	Shpenzime Korente	354.924	364.152	373.620	383.334	393.301	403.527	414.019	424.783	435.827	447.159	458.785	470.713
O3	Investime	1.456.539	1.494.409	1.533.264	1.573.129	1.614.030	1.655.995	1.699.051	1.743.226	1.788.550	1.835.052	1.882.764	1.931.716
	Shpenzime Korente	9.310	9.552	9.800	10.055	10.317	10.585	10.860	11.142	11.432	11.729	12.034	12.347
O4	Investime	606.167	621.927	638.097	654.688	671.710	689.174	707.093	725.477	744.340	763.693	783.549	803.921
	Shpenzime Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O5	Investime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korente	1.026	1.053	1.080	1.108	1.137	1.166	1.197	1.228	1.260	1.293	1.326	1.361
O6	Investime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korente	26.676	27.370	28.081	28.811	29.560	30.329	31.118	31.927	32.757	33.609	34.483	35.379
O7	Investime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korente	2.052	2.105	2.160	2.216	2.274	2.333	2.394	2.456	2.520	2.586	2.653	2.722
O8	Investime	1.661.131	1.704.321	1.748.633	1.794.098	1.840.744	1.888.603	1.937.707	1.988.088	2.039.778	2.092.812	2.147.225	2.203.053
	Shpenzime Korente	211.467	216.966	222.607	228.394	234.333	240.425	246.676	253.090	259.670	266.422	273.349	280.456
O9	Investime	583.846	599.025	614.600	630.580	646.975	663.796	681.055	698.762	716.930	735.570	754.695	774.317
	Shpenzime Korente	88.196	90.489	92.842	95.256	97.732	100.273	102.880	105.555	108.300	111.116	114.005	116.969

Objektivi	Lloji i financimit	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029	Viti 2030
O10	Investime	507.870	521.075	534.623	548.523	562.785	577.417	592.430	607.833	623.637	639.852	656.488	673.556
	Shpenzime Korente	67.535	69.291	71.093	72.941	74.837	76.783	78.780	80.828	82.929	85.085	87.297	89.567
O11	Investime	319.095	327.392	335.904	344.637	353.598	362.792	372.224	381.902	391.831	402.019	412.471	423.195
	Shpenzime Korente	48.263	49.518	50.805	52.126	53.482	54.872	56.299	57.763	59.264	60.805	62.386	64.008
O12	Investime	100.538	103.152	105.834	108.585	111.409	114.305	117.277	120.326	123.455	126.665	129.958	133.337
	Shpenzime Korente	9.310	9.552	9.800	10.055	10.317	10.585	10.860	11.142	11.432	11.729	12.034	12.347
O13	Investime	34.371	35.265	36.182	37.122	38.087	39.078	40.094	41.136	42.206	43.303	44.429	45.584
	Shpenzime Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Duke pasur parasysh faktin se realizimi i objektivave të parashikuar në PKS nuk mund të financohet plotësisht nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit, një pjesë e konsiderueshme e këtyre nevojave mbeten të pambuluara me buxhet duke krijuar kështu një hendek financiar.

Grafiku 1, tregon pikërisht vlerat respektive të mundësive reale të financimit të parashikuar në PBA, nevojat totale për financim si dhe hendekun financiar për secilin nga tre shtyllat e sektorit të ujit. Të dhënat tregojnë se *përdorimi i ujit*, i cili përfshin objektivat 1–7 zë peshën më të madhe në nevojat për totale për financim me vlerë 262,495,461,000 lekë ose 67.6% e nevojave totale, i ndjekur nga *mbrojtja e ujit* i cili lidhet me objektivat 8-9-10 ka një kërkesë totale për financim në vlerën 75,553,913,000 lekë ose 19.4%. Në fund renditet *mbrojtja nga uji* e cila përfshin objektivat 11-12-13, me kërkesë totale për financim në vlerën 50,318,681,000 lekë ose 13%.

Grafiku 1. Të dhënat financiare sipas tre shtyllave të sektorit të ujit



Theksojmë gjithashtu se nevojat totale për financim për secilin objektiv janë parashikuar të kenë tre kategori kryesore të ndara në: studime, investime dhe nevojat për mirëqeverisjen. Tabela 13 paraqet në mënyrë të përmblëdhur vlerën e nevojave totale për financim referuar nevojave financiare për studime, investime dhe nevojat për mirëqeverisje, financimin sipas parashikimit në PBA si dhe hendekun financiar sipas secilit objektiv për periudhën 2018-2030.

Tabela 13. Të dhënat lidhur me nevojat totale për financim të ndara në studime, investime dhe nevojat për mirëqeverisjen, financimi sipas PBA-së dhe hendeku financiar sipas objektivave për periudhën 2018-2030
(në 000 lekë)

Objektivat	Totali i nevojave për financim (2018-2030)	Financimi sipas PBA (2018-2030)	Hendeku Financiar (2018-2030)
Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim të sigurt dhe të vazhdueshëm	60.349.285	119.719.057	- 59.369.772
Studime	4.365.694		
Investime	55.362.542		
Nevojat për Mirëqeverisjen	621.049		
Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbimin të zonave urbane dhe rural	124.169.202	31.993.055	92.176.147
Studime	427.011		
Investime	123.530.009		
Nevojat për Mirëqeverisjen	212.182		
Përmirësimi i sistemeve ujitëse për tokat e ujtitshme bujqësore me synim plotësimin e nevojave të fermerëve me ujë, për të ofruar kushte optimale për rritjen e kulturave bujqësore	68.281.538	21.765.593	46.515.945
Studime	1.730.802		
Investime	66.378.377		
Nevojat për Mirëqeverisjen	172.359		
Përmirësimi i sistemeve të drenazhimit për sipërfaqet e ujtitshme bujqësore, me synim garantimin e kushteve optimale për rritjen e kulturave bujqësore	8.576.641	9.000.640	- 423.999
Studime	1.441.742		
Investime	6.962.540		
Nevojat për Mirëqeverisjen	172.359		
Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA), me synim zhvillimin e ekonomive të akuakulturës duke respektuar kushtet mjedisore	635.846	15.235	620.611
Studime	128.110		
Investime	364.000		
Nevojat për Mirëqeverisjen	143.736		
Shfrytëzimi i potencialeve hidroenergjetike, me synim rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të burimeve ujore për hidroenergji, duke pasur parasysh detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare duke respektuar kushtet mjedisore	394.168	393.453	715
Studime	264.300		
Investime	-		

Nevojat për Mirëqeverisjen	129.868		
Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve përkatëse, si dhe duke respektuar kushtet mjedisore	88.781	30.468	58.313
Studime	27.300		
Investime	-		
Nevojat për Mirëqeverisjen	61.481		
Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë”, për ato trupa ujorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat sipërfaqësore-lumenj, liqene, ujëra tranzitore/kalimtare, trupa ujorë artificiale dhe shumë të modifikuar)	40.994.465	27.805.195	13.189.270
Studime	2.016.026		
Investime	38.433.638		
Nevojat për Mirëqeverisjen	544.801		
Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht të mirë, për ata trupa ujorë që kanë status “më pak se mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët” (ujërat nëntokësore)	8.185.331	10.215.049	- 2.029.718
Studime	518.805		
Investime	7.080.923		
Nevojat për Mirëqeverisjen	585.603		
Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht “e mirë” për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetar e kalimtar)	1.138.885	8.746.181	- 7.607.296
Studime	336.462		
Investime	499.500		
Nevojat për Mirëqeverisjen	302.923		
Reduktimi i rrezikut dhe humbjeve nga përmytja për jetën, jetesën dhe shëndetin dhe asetëve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve e cila synon përmirësimin e menaxhimit të situatave të mbrojtjes nga përmytja; përmirësimi i infrastrukturës në përgjigje të fatkeqësive natyrore; garantimi i kushteve të sigurta të jetesës për njerëzit, florën dhe faunën në zonat e rrezikuara; sigurimi i asetëve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore për personat, bizneset dhe komunitetet	34.086.561	5.583.858	28.502.703
Studime	1.872.256		

Investime	31.934.210		
Nevojat për Mirëqeverisjen	280.095		
Përmirësimi i kushteve teknike të digave, të cilat shfrytëzohen për ujitjen e tokave bujqësore, me synim rritjen e sigurisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre	21.877.577	1.631.068	20.246.509
Studime	3.080.006		
Investime	18.620.011		
Nevojat për Mirëqeverisjen	177.560		
Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit me synim mbrojtjen e tokave me rrezik të lartë erozioni duke forcuar infrastrukturën përkatëse në përgjigje të këtij fenomeni	19.589.775	510.357	19.079.418
Studime	420.638		
Investime	19.022.256		
Nevojat për Mirëqeverisjen	146.881		
TOTALI	388.368.055	237.409.209	150.958.846
Total studime	16.629.152		
Total investime	368.188.006		
Total nevojat për mirëqeverisjen	3.550.897		

4.1.3. Treguesit financiarë sipas secilit objektiv

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike nevojat për financime, për secilin objektiv, të specifikuar sipas kategorive: studime, investime dhe nevojat për mirëqeverisje si dhe parashikimi i financimit të tyre sipas PBA-së për periudhën 2018-2030, ku financimi sipas PBA është parashikuar me një trend rritje ekonomike prej 2.6 % (referuar SKZHI-së). Gjithashtu është përcaktuar hendeku financiar, si diferencë e nevojës për financim me buxhetin e projektuar nga PBA-ja.

4.1.3.1. Objektivi 1

Sa i përket Objektivit 1 (*Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim, të sigurt dhe të vazhdueshëm*), trendi i investimeve i është referuar draft strategjisë së financimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Këtyre kostove i janë shtuar edhe kostot e nevojave për mirëqeverisjen. Nëse i referohemi trendit të parashikimit buxhetor të PBA-së, vihet re se këto investime mund të mbulohen nga PBA-ja (grafiku 2). Kjo nuk nënkupton që nënsektori i furnizimit me ujë ka në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme financiare por që shpërndarja aktuale sa i përket parashikimit buxhetor nuk është në përputhje me tendencat e përcaktuara nga kjo draft strategji. Këtu vlen të theksohet se në PBA-në aktuale nëse i referohemi programit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, buxheti në dispozicion nuk është i mjaftueshëm për arritjen e objektivave, ndërsa nëse totalin e buxhetit e veçojmë për furnizimin me ujë që korrespondon me Objektivin 1 dhe kanalizimeve që korrespondon me Objektivin 2, rezulton se për Objektivin 1 ka suficit ndërsa për Objektivin 2 ka deficit të buxhetit. Parashikimi në PKS sipas strategjisë së financimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, i bën këto objektiva me realistë dhe të arritshëm njëkohësisht. Kjo duhet të shoqërohet me përshtatjen e PBA-së me këtë trend investimesh.

Grafiku 2. Nevojat dhe financimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 1



Pesha kryesore në buxhetin e furnizimit me ujë shkon për investime infrastrukturore, të cilat sipas strategjisë së financimit të fushës së furnizimit me ujë dhe kanalizime është konstant deri në vitin 2020 dhe më pas pëson një rritje me 30 % më tepër se financimi deri në këtë periudhë.

Sa i përket kostove të operimit është analizuar edhe në Draft Raportin e përgatitur nga Banka Botërore²¹ kostot kryesore të ndërmarrjeve të ujës-jellës kanalizimeve janë kryesisht për pagat e punonjësve, pagesat e energjisë elektrike dhe kosto amortizimi. Gjithashtu vërehet se ndërmarrje të ndryshme kanë specifika të ndryshme të cilat përkthehen të gjitha në kosto shtesë.

²¹ November 2016, World Bank / Ministry of Transport and Infrastructure / National Water Council, Water for people - Financial policy and implementation measures - Final report – Final draft

Prandaj, problemi më i madh i tyre mbetet mbulimi i kostove që vjen si rezultat i problemeve teknike si amortizimi por edhe nga mospagesat e tarifave të përdorimit të ujit nga të gjithë përdoruesit e tij dhe kryesisht nga familjarët, bizneset etj. Kosto tjetër shtesë që evidentohet në këtë raport është edhe performanca e dobët e vetë ndërmarrjeve në sigurimin e shërbimeve si dhe kultura e ulët e përdorimit të ujit si çdo produkt tjetër. Në këtë kuadër, ekspertët kanë parashikuar disa skenarë për rritjen e të ardhurave dhe mbulimin e kostove të cilat parashikojnë:

- Rritjen e tarifave të përdorimit të ujit e cila konsiderohet si masë efektive por afatshkurtër;
- Rritjen e investimeve në nënsektorin ujësjellës kanalizime;
- Parashikimi për investime afatgjata dhe të qëndrueshme;
- Mirëmanaxhimi dhe forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të këtij nënsektori.

Përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve duke shkuar drejt rekuperimit të kostove do të ulë financimin në formë subvencioni nga buxheti qendror dhe do të rrisë mundësinë e financimit në përmirësimin e infrastrukturës dhe rrjeteve të furnizimit me ujë.

Shumica e studimeve në fushën e furnizimit me ujë janë parashikuar që të bëhen brenda vitit 2020, në mënyrë që investimet dhe planifikimi të jenë të bazuara në indikatorë dhe tregues të matshëm, për të ritur efikasitetin dhe maksimizuar përfitueshmërinë e investimeve.

Kostot e qeverisje së fushës së furnizimit me ujë në PKS janë llogaritur si kosto për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit dhe plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Grafiku 3 paraqet hendekun financiar, të cilat në këtë rast janë negative, që do të thotë se, burimet financiare janë të mjaftueshme për realizimin e këtij objekti.

Grafiku 3. Hendeku financiar për Objektivin 1



4.1.3.2. Objektiv 2

Sa i përket Objektivit 2 (*Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbim të zonave urbane dhe rurale*) është pranuar që tendenca e nevojave për investime për kanalizimet të jetë në përputhje me strategjinë për financimin e këtij sektori. Në këtë rast vihet re se planifikimi buxhetor nuk arrin të mbulojë nevojën për financime, pra shpërndarja e fondeve sipas PBA-së edhe për këtë fushë nuk është në përputhje me strategjinë e financimit. Shpjegimi për Objektivin 2 në lidhje me PBA-në aktuale është dhënë më sipër.

Grafiku 4. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 2

Në fushën e kanalizimeve është e qartë që mbulimi në rang vendi është i ulët krahasuar me atë të furnizimit me ujë dhe hendeku për financime në infrastrukturë në këtë fushë është më i madh. Duke qënë se këto dy objektiva janë të lidhur me njëri-tjetrin në një program të vetëm buxhetor duhet të bëhet një ekuilibrim më i mirë në parashikimin e buxhetit në dispozicion.

Shumica e studimeve në fushën e kanalizimeve janë parashikuar që të bëhen brenda vitit 2020, në mënyrë që investimet dhe planifikimi të jenë të bazuara në indikatorë dhe tregues të matshëm, për të rritur efikasitetin dhe maksimizuar përfitueshmërinë e investimeve.

Kostot qeverisëse në PKS janë llogaritur si kosto për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit dhe plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Referuar strategjisë së investimit, gjatë tre viteve të para janë më të ulëta, ndërkohë përtej vitit 2020 investimet janë parashikuar në vlera më të larta për të pasur një rritje më të madhe të treguesit të objektivit deri në fund të këtij programi (grafiku 4).

Grafiku 5 i cili paraqet hendekun financiar të këtij objektivit tregon sërish se nevojat më të mëdha mbeten për periudhën përtej vitit 2021.

Grafiku 5. Hendeku financiar për Objektivin 2

4.1.3.3. Objektivi 3

Sa i takon realizimit të Objektivit 3 (*Përmirësimi i sistemeve ujitëse për tokat e ujitshme bujqësore me synim plotësimin e nevojave të fermerëve me ujë, për të ofruar kushte optimale për rritjen e kulturave bujqësore*) të dhënat e grafikut 6 tregojnë se nevojat më të larta parashikohen në vitet 2019-2021 pavarësisht se për vitet e tjera kërkesat për financime mbeten sërish të larta.

Grafiku 6. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 3



Studimet në fushën e ujitjes janë planifikuar të realizohen përgjithësisht deri në vitin 2020, nëpërmjet të cilave do të skatësohet më mirë edhe sipërfaqja potencialisht e ujitshme. Gjithashtu këto studime do t'i shërbejnë një planifikimi më realist duke pasur investime më efektive.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime llogariten për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit dhe plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Në grafikun 6 vihet re se kërkesa më e madhe për financime janë kryesisht për investime infrastrukturore, dhe këto në një masë më të madhe deri në vitin 2021, ku nevojitet fillimisht rahabilitim total i sistemeve të ujitjes të dala jashtë funksionit. Në vitet në vazhdim këto investime ngelen përsëri të larta, referuar trendit të PBA-së, por me një ulje të konsiderueshme kundrejt viteve të para, duke pësuar një tjetër ulje pas vitit 2025. Pas vitit 2025 nevojat për investime infrastrukturore në ujitje përsëri nuk arrijnë ende të mbulohen nga trendi i parashikuar i PBA-së, por kanë një ulje pasi fokusohen në mirëmbajtjen e skemave të vendosura tashmë në funksion.

Për përmbushjen e këtij objektiv duhet që nga PBA-ja në 5 vitet e para të parashikohet një rritje më e madhe e investimeve sikurse duhet të ketë edhe një përqëndrim të financimeve të huaja për këtë objektiv.

Sa i takon hendekut financiar të këtij objektiv ai është më i lartë gjatë katër viteve të para të programit duke u ulur përgjatë vitit 2021 dhe po me trend zbritës vazhdon deri në fund të programit. Por pavarësisht kësaj, vlerat e këtij hendeku janë relativisht të larta në secilin vit (grafiku 7).

Grafiku 7. Hendeku financiar për Objektivin 3

4.1.3.4. Objektiv 4

Realizimi i Objektivit 4 (*Përmirësimi i sistemeve të kullimit të tokave bujqësore, me synim garantimin e kushteve optimale për rritjen e kulturave bujqësore*), kërkon më shumë financime nga viti 2018 deri në vitin 2020. Kjo nevojë financimi lidhet kryesisht me investimet infrastrukturore por edhe me masat e tjera lidhur me studimet dhe mirëqeverisjen.

Grafiku 8. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 4

Në 3 vitet e para (deri në 2020) është parashikuar që të realizohen përgjithësisht studimet mbi kullimin duke saktësuar objektivat dhe duke pasur një baze shkencore, mbi parshikimin e investimeve infrastrukturore në këtë fushë.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Nevoja për investime infrastrukturore është pothuajse konstante duke mos pasur ndonjë kapërcim të madh nga trendi i tyre. Kjo vjen për shkakun se sipërfaqet në hektarë që duhet të vihen nën sistemin e kullimit nuk janë aq të mëdha sa sipërfaqja që duhet të mbulohet me ujite. Investimet infrastrukturore në vitet në vazhdim pas 2021 fokusohen në mirëmbajtjen e sistemeve të kullimit të rehabilituara.

Referuar trendit të planifikimit të PBA-së duket se deri në vitin 2021 nevojiten fonde shtesë mbi këtë trend investimesh të cilat duhet të mbulohen nga rishpërndarja e buxhetit apo nga

financime të huaja. Në periudhën 2021-2030 vihet re se trendi i PBA-së e tejkalon nevojën për financime të këtij objektivi dhe financimet shtes duhet të alokohen për objektivin e ujitjes (nisur nga fakti që janë brenda të njëjtit programi buxhetor).

Grafiku 9. Hendeku financiar për Objektivin 4



4.1.3.5. Objektivi 5

Realizimi i Objektivit 5 (*Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda zonave të përcaktuara për Akuakulturën (ZPA), me synim zhvillimin e ekonomive duke respektuar kushtet mjedisore*), kërkon financime më të mëdha gjatë tre viteve të ardhshme, pra 2018-2020. Ndërsa për vitet e tjera kjo kërkesë është më e ulët.

Grafiku 10. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 5



Studimet për akuakulturën dhe përcaktimin e ZPA-ve janë parashikuar të bëhen deri në vitin 2020, këto studime do t'i paraprijnë një planifikimi realist, të bazuar teknikisht duke përmbushur edhe detyrimet që rrjedhin nga ligji për akuakulturën.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektivi fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Investimet infrastrukturore në këtë objektivi bëhen kryesisht nga sektori privat, të cilët investojnë në infrastrukturën e zhvillimit të akuakulturës. Megjithatë për të bërë një përdorim të qëndrueshëm dhe ruajtur ekuilibrat mjedisorë janë planifikuar disa investime për të

mbështetur subjektet në ndërtimin e impianteve dhe teknologjive të trajtimit të ujit të përdorur nga akuakultura. Këto investime janë shtrirë në mënyrë konstante në të gjithë periudhën e PKS-së 2018-2030.

Referuar planifikimit buxhetor të PBA-së, vihet re se megjithëse nevoja për financime krahasuar me objektivat e tjerë janë më të vogla, ato nuk mund të mbulohen nga PBA-ja. Kjo për faktin se në programin aktual ku përfshihet ky objektivi janë të parashikuar vetëm pagat e punonjësve në këtë fushë. Nisur nga kjo është e nevojshme që në përgatitjen e PBA-së të parashikohet financimi i këtyre masave.

Grafiku 11. Hendeku financiar për Objektivin 5



4.1.3.6. Objektivi 6

Për plotësimin e Objektivit 6 (Shfrytëzimi i potencialeve hidroenergjetike, me synim rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të burimeve ujore për hidroenergji, duke pasur parasysh detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare duke respektuar kushtet mjedisore) vihet re një nevojë më e madhe në 3 vitet e para të zbatimit të këtij programi me fokus kryesor studimet dhe masat për mirëqeverisje. Investimet në këtë objektivi me politikat që po ndjek Shqipëria kryhen nga sektori privat nëpërmjet koncesioneve apo formave të tjera të shfrytëzimit hidroenergjetik të burimeve ujore.

Grafiku 12. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 6



Studimet për një shfrytëzim sa më eficient të potencialeve hidroenergjetike që zotëron vendi janë planifikohen që të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020. Kjo do të ndimonte në identifikimin e zonave me potenciale reale për shfrytëzimin, përdorimin e integruar të veprave hidroenergjetike, me qëllime të tjera përdorimi, si bujqësia, uji i pijshëm etj. Kjo duke ruajtur njëkohësisht edhe ekuilibrat mjedisorë.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Referuar parashikimit të PBA-së vihet re se kemi një hendek për periudhën 2018-2020 dhe pas kësaj periudhe nevoja për financime mbulohet nga buxheti i shtetit. Në planifikimin e PBA-së për vitet e ardhshme duhet të ketë një përqëndrim të financimeve në periudhën 2018-2020, duke rritur financimin nga buxheti i shtetit dhe siguruar pjesën tjetër të financimit nga ndihma e huaj ose mekanizma të tjerë.

Grafiku 13. Hendeku financiar për Objektivin 6



4.1.3.7. Objektiv 7

Realizimi i Objektivit 7 (Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve përkatëse, duke respektuar kushtet mjedisore).

Arritja e këtij objektiv kërkon financim dhe kryesisht në investime për realizimin e studimeve dhe masave qeverisëse. Duke qenë se investimet infrastrukturore kryhen përgjithësisht nga sektori privat i cili operon në këtë fushë në forma të ndryshme. Investimet nga buxheti i shtetit nuk janë të nevojshme (aspektet mjedisore janë të përfshira në objektivat mjedisore). Ndërsa për studime apo masa që lidhen me mirëqeverisjen fondet e parashikuara paraqiten në grafikon më poshtë.

Grafiku 14. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 7



Studimet për sigurimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit në industri të ndryshme, duke respektuar edhe ekuilibrat mjedisorë, planifikohen që të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020. Kjo do të ndimonte në identifikimin potencialeve që ka vendi ynë për përmbushjen e këtyre kërkesave dhe aplikimin e teknikave, teknologjive moderne për riciklimin dhe trajtimin e ujit industrial.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.


Referuar parashikimit të PBA-së vihet re se kemi një hendek për periudhën 2018-2020 dhe pas kësaj periudhe nevoja për financime mbulohet nga buxheti i shtetit. Në planifikimin e PBA-së për vitet e ardhshme duhet të ketë një përqëndrim të financimeve në periudhën 2018-2020, duke rritur financimin nga buxheti i shtetit dhe siguruar pjesën tjetër të financimit nga ndihma e huaj ose mekanizma të tjerë financimi.

Grafiku 15. Hendeku financiar për Objektivin 7



4.1.3.8. Objektiv 8

Për këtë objektiv (Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë”, për ato trupa ujqorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat sipërfaqësore-lumenj, liqene, ujëra tranzitore/kalimtare, trupa ujqorë artificiale dhe shumë të modifikuara)), kërkesat totale për financim janë të larta dhe shoqërohen me një nevojë më të madhe për financim në periudhën 2018-2020.

Grafiku 16. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 8

Nevoja për studime në kuadër të këtij objekti është e fokusuar në periudhën 2018-2020, por jo vetëm, pasi nëse i referohemi grafikut të mësipërm vihet re një ngritje periodike çdo 6 vjet. Kjo ngritje vjen për shkak të ciklit 6-vjeçar të përgatitjes së planeve të menaxhimit të baseneve, të cilat janë dokumente me kosto të konsiderueshme. Realizimi i këtyre studimeve do të saktësonte në radhë të parë objektivat mjedisore pasi edhe në këtë dokument nuk është e mundur të përcaktohet statusi i vitit bazë të marrë si referencë fillestare.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.


Investimet infrastrukturore siç shikohet nga grafiku shfaqin një kërkesë të madhe për investime në periudhën 2018-2020, kjo lidhet me nevojën e ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe vënia në punë e atyre ekzistuese sipas standardeve të BE-së, rehabilitimin e dambave të minierave etj. Trendi i financimit të këtyre veprave është bërë në përputhje me strategjinë e financimit të fushës së furnizimit me ujë dhe kanalizime. Në periudhën 2020-2025 vihet re një ulje e nevojës për financime në infrastrukturë kryesisht për impiante trajtimi, po përsëri pa mundur që të mbulohet plotësisht nga buxheti i shtetit. Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të PKS-së (2018-2030), janë planifikuar investime infrastrukturore për mbrojtjen e ndotjes së ujërave sipërfaqësore nga bujqësia dhe rehabilitimi i mjedisve ujore sipërfaqësore të dëmtuara.

Planifikimi aktual i PBA-së për këtë objektiv në periudhën 2018-2025 nuk arrin të mbulojë kosotot përkatës. Për këtë duhet të parashikohen më shumë fonde nga buxheti i shtetit në vitet e para të zbatimit të PKS dhe në të njëjtën kohë të mbeshtet me financime të huaja në forma të ndryshme. Në periudhën 2025-2030, nevoja financiare rezulton më e ulët së parashikimi buxhetor dhe në këtë mënyrë duhet të bëhet rishpërndarje e fondeve.

Grafiku 17. Hendeku financiar për Objektivin 8

4.1.3.9. Objektiv 9

Lidhur me Objektivin 9 (Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht “të mirë”, për ato trupa ujorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët” (ujërat nëntokësore)), të dhënat e grafikut tregojnë se kërkesat për financim janë të larta gjatë periudhës 2018-2020 ku peshën më të madhe e mbajnë investimet infrastrukturore, të ndjekura nga studimet dhe masat qeverisëse më pas. Përtej kësaj periudhe vlerat pësojnë ulje pas vitit 2020 dhe një ulje të mëtejshme pas vitit 2025 (grafiku 18).

Grafiku 18. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 9

Studimet për këtë objektiv janë parashikuar të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020. Këto studime do t'i paraprijnë investimeve infrastrukturore në të ardhmen, do të saktësojnë statusin aktual të ujërave nëntokësore dhe do të propozojnë zgjidhjet më optimale për përmirësimin e cilësisë së tyre. Pas kësaj periudhe deri në përfundim të PKS-së është llogaritur një vlerë e përafërt për identifikimin e ndotjes së ujërave nëntokësore nga burime të ndryshme.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Investimet infrastrukturore referuar grafikut fillojnë me një nevojë relativisht të lartë për investime në periudhën 2018-2020 dhe janë të fokusuar në ndërtimin e sistemeve lokale të trajtimit të ujërave të ndotura urbane nëpërmjet gropave septike, ngritjen e laboratorëve dhe uljen e ndotjes që vjen nga landfillet. Përsa i përket trendit të financimeve në gropat spetike, është marrë në konsideratë strategjia e financimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Kërkesa për investime infrastrukturore pëson një ulje fillimisht pas vitit 2020 dhe me pas një ulje të dytë pas vitit 2025.

Referuar trendit të PBA-së vërehet se periudha 2018-2020 nuk arrin të mbulohet nga buxheti i shtetit, ndërsa për periudhën 2021-2030, trendi i PBA-së mbulon nevojat për financim, madje i tejkalon ato. Në këto kushte nevojitet sigurimi i financimit më të madh nga buxheti i shtetit dhe ndihma e huaj për 3 vitet e para dhe një rishpërndarje e PBA-së, në përputhje me PKS-në për periudhën 2021-2030.


Grafiku 19. Hendeku financiar për Objektivin 9



4.1.3.10. Objektiv 10

Lidhur me Objektivin 10 (Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht “e mirë” për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetar e kalimtar)), nevoja për financime është e përqëndruar përgjithësisht në periudhën 2018-2020 dhe më pas vazhdon deri në 2030.

Grafiku 20. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 10



Studimet janë planifikuar të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020 dhe pritet që të qartësojnë gjendjen aktuale të ujërave detare, të përmirësojnë planifikimin e investimeve në

infrastrukturë, përdorimin e teknologjisë moderne etj. Këto lidhen edhe me studimin e vazhdueshëm të ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe monitorimit të cilësisë së ujërave detare.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Investimet infrastrukturore janë të planifikuara për impiante dhe vendgrumbullime të mbetjeve nga anijet dhe mjetet e tjera lundruese, uljen e riskut të katastrofave detare dhe rritjen e kapaciteteve laboratorike. Këto parashikohen të fillojnë me një ngritje deri në vitin 2020 dhe më pas 2021-2030 investimet pësojnë një ulje.

Referuar planifikimit të PBA-së rezulton se këto investime mbuloohen me trendin aktual të financimeve dhe PBA-ja duhet të rishpërndahet për t'u përdorur në mënyrë eficiente.


Grafiku 21. Hendeku financiar për Objektivin 10



4.1.3.11. Objektiv 11

Për realizimin e Objektivit 11 (Reduktimi i rrezikut dhe humbjeve nga përmytja për jetën, jetesën dhe shëndetin dhe aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve e cila synon përmirësimin e menaxhimit të situatave të mbrojtjes nga përmytja; përmirësimi i infrastrukturës në përgjigje të fatkeqësive natyrore; garantimi i kushteve të sigurta të jetesës për njerëzit, florën dhe faunën në zonat e rrezikuara; sigurimi i aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore për personat, bizneset dhe komunitetet) nevojat për financim janë më të larta në periudhën 2018-2020, duke pësuar një ulje pas vitit 2021 dhe sërish pas vitit 2025. Këto kryesohen nga nevoja për investime infrastrukturore, studimet dhe masat qeverisëse.

Grafiku 22. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 11



Studimet planifikohen të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020 dhe do të shërbejnë për një evidentim më të mirë të zonave nën risk, hartimin e planeve të manaxhimit të përmbytjeve, fizibiliteti i masave mbrojtëse etj. Të gjitha këto do të çojnë në një planifikim më të mirë të investimeve infrastrukturore dhe rritjen e efektivitetit të tyre.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Investimet infrastrukturore nisin me një kërkesë të lartë për financim në periudhën 2018-2020, pësojnë një ulje nga viti 2021 e në vazhdim dhe ulen sërish pas vitit 2025 duke qëndruar konstante deri në fund të programit. Këto financime shkojnë për ngritjen e infrastrukturës mbrojtëse duke filluar nga zonat më prioritare me risk të lartë dhe duke përfunduar edhe në mirëmbajtjen e infrastrukturës deri në përfundim të programit.

Referuar planifikimit të PBA-së vihet re se në asnjë periudhë të shtrirjes së PKS-së nuk arrijnë të mbulohen nevojat për financime. Në këtë mënyrë është i nevojshëm një rishikim i planifikimit të financimeve në PBA dhe sigurimi i financimeve shtesë nga financimet e huaja.

Grafiku 23. Hendeku financiar për Objektivin 11



4.1.3.12. Objektivi 12

Për realizimin e Objektivit 12 (Përmirësimi i kushteve teknike të digave, të cilat shfrytëzohen për ujitjen e tokave bujqësore, me synim rritjen e sigurisë dhe reduktimin e efekteve të mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre), nevojiten financime të konsiderueshme për investimet infrastrukturore kryesisht, për studimet dhe masat qeverisëse. Kjo, duke filluar me një kërkesë më të madhe për periudhën 2018-2020, duke pësuar një ulje në 2021-in dhe duke u ulur sërish pas vitit 2025.

Grafiku 24. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 12



Studimet parashikohet të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020 dhe fokusohen në evidentimin e gjendjes aktuale të sigurisë së digave, përgatitjen e projekteve të zbatimit për rikonstruksionin e tyre, të projekteve të braktisjes së atyre digave që dalin jashtë funksionit dhe përcaktimit të përhapjes së valës në raste kolapsi të digave. Periudha 2021-2030 shoqërohet me investime mbi studimet që mund të jenë të nevojshme.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo mase përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Investimet infrastrukturore zënë edhe peshën më të madhe në nevojën për financime. Ato fillojnë me një kërkesë relativisht të lartë krahasuar me PBA-në e parashikuar duke pësuar një ulje pas vitit 2021 dhe një ulje tjetër pas vitit 2025. Investimet infrastrukturore fokusohen në rehabilitimin e digave të prioritizuara sipas kategorizimeve përkatëse, në funksion të riskut.

Referuar planifikimit të PBA-së vihet re se parashikimi është shumë i ulët referuar nevojave për financime dhe në të gjithë kohëzgjatjen e PKS-së këto parashikime nuk arrijnë të mbulojnë kërkesën për financime. Në këto kushte duhet që institucionet përkatëse të rishikojnë PBA-në dhe të sigurohet financim shtesë nga ndihma e huaj.

Grafiku 25. Hendeku financiar për Objektivin 12

4.1.3.13. Objektiv 13

Për realizimin e Objektivit 13 (Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit me synim mbrojtjen e tokave me rrezik të lartë erozioni duke forcuar infrastrukturën përkatëse në përgjigje të këtij fenomeni), nevojat për financime janë më të larta për periudhën 2018-2025 si rezultat i vlerave të parashikuara për investime infrastrukturore, studime dhe masa qeverisëse.

Grafiku 26. Nevojat për financim dhe parashikimi sipas PBA-së për periudhën 2018-2030 për Objektivin 13


Studimet planifikohet të realizohen kryesisht në periudhën 2018-2020 dhe fokusohen në studimin e erozionit të brigjeve lumore, liqenore dhe bregdetare, sikurse edhe mbi fizibilitetin e masave të nevojshme për uljen e shkallës së erozionit. Periudha deri në fund të PKS-së parashikon studime në një masë më të vogël sipas nevojës.

Kostot qeverisëse në PKS për këtë objektiv fokusohen në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Këto kosto janë llogaritur për ekspert vendas dhe të huaj mbi stafet aktuale, që duhen për të plotësuar nevojat e sektorit, referuar çdo masë përkatëse. Këto shpenzime shkojnë për plotësimin dhe përshtatjen e legjislacionit, plotësimin e institucioneve të ndryshme me ekspertizën dhe numrin e nevojshëm të punonjësve. Shtrirja e tyre në kohë varion në disa raste për periudha të caktuara, të përkohshme dhe në disa raste vazhdon gjatë gjithë kohës së zbatimit të programit.

Investimet kryesore në infrastrukturë janë planifikuar të realizohen në periudhën 2018-2025, dhe konsistojnë përgjithësisht në mbrojtje të brigjeve lumore me struktura tërthore dhe gjatësore, mbrojtje me skoliera e vijës bregdetare, marrja e masave mbi uljen e erozionit me prita malore, etj. Pas vitit 2025 këto investime vetëm do të mirëmbahen.

Referuar planifikimit të PBA-së vihet re se ka një hendek të madh të nevojave të evidentuara dhe parashikimit aktual financiar. Në këto kushte është e rëndësishme që investimet nga buxheti i shtetit të rriten, sikurse edhe duhet të sigurohen financime shtesë nga burime të huaja.

Grafiku 27. Hendeku financiar për Objektivin 13




4.1.3.14. Nevojat totale, financimi sipas PBA-së dhe hendeku financiar total

Kosto totale e zbatimit të këtij dokumenti duke përfshirë investimet, studimet si dhe nevojat për mirëqeverisje, rezulton të jetë 388.368.055.000 lekë. Duke patur parasysh aktivitetet që duhen zbatuar për arritjen e objektivave të Programit Kombëtar Sektorial, të kostuara deri në vitin 2030 si dhe mundësitë reale të financimit nga buxheti i shtetit por edhe nëpërmjet financimeve të huaja, është përlllogaritur edhe hendeku total financiar i cili përlllogaritet të ketë një vlerë prej 150.958.846.000 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur grafiku i mëposhtëm paraqet hendekun financiar total për realizimin e Programit Kombëtar Sektorial 2018-2030, i cili tregon se mundësitë reale për financim të këtij programi janë vetëm 61% e nevojave totale për financim, ndërsa hendeku financiar llogarite në 39%, ku kërkesat më të larta janë kryesisht tek investimet.


Grafiku 28. Nevojat totale, financimi sipas PBA-së dhe hendeku financiar total i PKS 2018-2030



Të dhënat e grafikut 29 tregojnë se nevojat totale për financim si dhe financimi sipas parashikimeve të PBA-së nga ku vihet re se vlerat më të larta të këtyre nevojave janë kryesisht


në katër vitet e para të realizimit të programit ndërkohë që kanë rënie deri në vitin 2025, rënie e cila vazhdon deri në fund të programit.

Grafiku 29. Treguesit financiarë për Programin Kombëtar Sektorial për Manaxhimin e Integruar të Ujit



Më poshtë paraqitet hendeku financiar për çdo vit i PKS-së i cili tregon se ky hendek ka vlera të larta gjatë tre viteve të para dhe më tej vjen në rënie.

Grafiku 30. Hendeku financiar total i PKS-së për çdo vit



4.2. Burimet e financimit të sektorit

Për të siguruar realizimin e objektivave dhe marrjen e rezultateve të dëshiruara në sektor brenda periudhës 2018-2030, sigurimi i financimit për nevojat shtesë përbën një nga elementët më të rëndësishëm të këtij dokumenti. Referuar informacionit të mësipërm financimi i hendekut financiar do të sigurohet përmes formave të mëposhtme:

- Sigurimi i asistencës nga partnerët për zhvillim në formën e granteve apo kredive përmes mekanizmave të ndryshme të financimit si Mbështetje Buxhetore Sektoriale, Pooling Funds etj;
- Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar në sektor përmes mekanizmave të tillë si rritja e tarifave për të gjithë përdoruesit e ujit, me synimin rritjen e të ardhurave për realizimin e nevojave për investime në sektor duke nënkuptuar që këto të ardhura specifike të jenë të dedikuara përsëri për sektorin e ujit;
- Prioritizimin e projekteve të investimeve me qëllim orientimin e burimeve financiare sipas nevojave kryesore të sektorit, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:
 - Financimi i projekteve që janë në vazhdim;
 - Mundësia e përdorimit maksimal të granteve;
 - Financimi i projekteve strategjike për vendin.
- Nxitja dhe stimulimi i Partneritetit Publik Privat (PPP) si një formë e përshtatëshme për sigurimin e shërbimeve cilësore në sektor referuar avantazheve të aplikimit të këtij bashkëpunimi disa prej të cilave janë:
 - Mënyra efektive për të zhvilluar projekte infrastrukturore dhe shërbime;
 - PPP shihen si mjet për të bashkuar prioritetet sociale me aftësitë manaxheriale të sektorit publik, duke lehtësuar qeverinë nga barra e shpenzimeve të mëdha kapitale dhe duke transferuar riskun e tepricave të shpenzimeve tek sektori privat;
 - Si mundësi për të siguruar kapital shtesë;
 - Për të siguruar aftësi alternative manaxhimi dhe zbatim;
 - Për të siguruar identifikimin më të mirë të nevojave dhe përdorim optimal të burimeve.²²

Kështu referuar sektorit të ujit, PPP-të shihen si mundësi e mirë bashkëpunimi pasi ato kanë aftësinë të ndërtojnë objekte/vepra apo të realizojnë shërbime që lidhen me manaxhimin e ujit në basenet ujore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e digave etj, duke përdorur ndërkohë operacione eficiente për të mbajtur kosto të ulta për taksapaguesit dhe për të siguruar një mënyrë efikase ofrimit të shërbimeve/investime për arsye të pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore.

Pjesë shumë e rëndësishme lidhur me mirëmanaxhimin e burimeve të financimit konsiderohen edhe marrja e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare pjesë e së cilës janë edhe të ardhurat që sigurohen nga tarifat e siguruar nga përdorimi i ujit të cilat grumbullohen dhe administrohen nga vetë ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve. Theksojmë gjithashtu se deri tani grumbullimi i tarifave siç janë ato të kontratave konçensionare apo lejeve mjedisore nuk kanë ndarje të posaçme për përdorimin e burimeve ujore me përjashtim të tarifave të miratuara sipas VKM nr. 662, datë 21.9.2016 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta” dhe VKM nr.876, datë 14.12.2016 “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative” prandaj edhe këto tarifa do të konsideroheshin gjithashtu si të ardhura shtesë për sektorin e ujit.

²² European Commission, Regional Policy – Guidelines for Successful Public-Private Partnerships; March 2003

4.2.1. *Mekanizmi i financimit të sektorit në kuadër të GMIP*

Ngritja e GMIP-së për manaxhimin e integruar të ujit si pjesë e SPI-së, shërben si një hallkë për të luajtur një rol koordinues në nivel sektori për partnerët zhvillimorë, duke qenë se këta të fundit janë pjesë e GMIP-së dhe pikat fokale respektive janë të ftuar në të gjitha takimet e nëngrupeve tematike.

Për të mundësuar zbatimin e PKS-së funksionimi i mekanizmit të ngritur në zbatim të qasjes sektoriale mer një rol shumë të rëndësishëm. Sikurse GMIP funksionon në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Inegruar (SPI) si sistemi kryesor vendimarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve financiare, përcaktimi i mekanizmit së ndërveprimit mes tyre është shumë i rëndësishëm.

Parashikimi i financimeve për këto programe do të jetë i lidhur me punën e nëngrupeve tematike, të cilat duhet të bashkëpunojnë me grupet për strategji, buxhetim dhe integrim (GSBI), brenda çdo ministrie përgjegjëse për buxhetin total të ministrisë. Rrjedhimisht nëngrupet tematike duhet të kenë një bashkëpunim të vazhdueshëm me këto grupe, të cilët do të konsistojnë në dhënien e orientimeve për përfshirjen në programet specifike të atyre projekteve që janë në linjë me objektivat e përcaktuara në këtë program.

Për sa i përket ndarjes në faza kohore, përcatimi i projekteve të cilat do ti komunikohen grupeve për strategji, buxhetim dhe integrim do të bëhet para dërgimit të kërkesave të fazës së parë të PBA-së në Ministrinë e Financave.

Ndërkohë, STKKU do të jetë pjesë e takimeve të nëngrupeve tematike, ku pjesë e axhendës do të jete diskutimi i projekteve për përfshirje në PBA. Në përfundim, STKKU do të bëjë një përmbledhje të këtyre kërkesave, pasi të jenë dakordësuar dhe me GSBI, dhe do të organizojë një mbledhje të posaçme të GMIP për marrjen e dakordësisë.

Më pas në përputhje me komentet që secili institucion do të marrë nga Ministria e Financave do të reflektohen ndryshimet në ato programe që implikojnë sektorin e ujit, gjithmonë në dakordësi me nëngrupet tematike dhe me GSBI. Pas përfundimit të këtij procesi, para së të dërgohen kërkesat e rishikuara në fazën e dytë, programet specifike që lidhen me sektorin do të miratohen parimisht në GMIP, duke u siguruar që projektet që lidhen me zbatimin e objektivave të parashikuara në të program të jenë të përfshira në kërkesat buxhetore.

Gjithashtu është e rëndësishme që ky proces të bëhet në përputhje me udhëzimet e Programimit Buxhetor Afatmesëm, duke u siguruar që: një politike mund të ketë disa objektiva, por qëllimi është caktuar për një program, në një ministri. Një program mund të ketë disa objektiva, por objektivi duhet të lidhet me një rezultat të matshëm dhe të monitorueshëm nën përgjegjësinë e një drejtori. Një rezultat mund të përbëhet nga disa projekte, por një projekt zbatohet nga një Agjenci nën udhëheqjen e një manaxheri. Një projekt mund të përfshijë disa aktivitete, por një aktivitet ka vetëm një kosto, e cila është nën kujdesin e një njësie. Një aktivitet mund të prodhojë disa rezultate, por një rezultat i referohet një dhe vetëm një objektivi (nuk mund të ekzistojnë më shumë objektiva se produkte). Prandaj skema e mënyrës së programimit të financimit sipas modelit të PBA-së duhet të jetë "Programe-Objektiva-Projekte-Aktivitete-Rezultate-Zbatimi".²³

²³ Raporti final i ekspertëve të PFM, Shkurt 2016

4.2.2. *Mekanizmi i financimit të pushtetit vendor në kuadër të përmbushjes së objektivave*

Pushteti Vendor zë një rol të rëndësishëm për mirëfunksionimin e sektorit në tërësi, nisur nga kompetencat që ai ka lidhur me mbarëvajtjen e furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe përgjegjësi të lidhur me sektorin e ujitje – kullimit. Për këtë arsye planifikimi i investimeve në sektor nga bashkitë paraqet rëndësi të veçantë, rrjedhimisht edhe ndërlidhja e tij me parashikimin për nevojat financiare. Me synim garantimin e sinergjisë mes politikave në nivel qendror me atë lokal, përfaqësues të pushtetit vendor do të jenë pjesë e mbledhjeve të GMIP-së, duke siguruar një urë bashkëpunimi në mënyrë që nisma të rëndësishme të cilat do të ndërmerren nga qeveria të trasmetohen dhe të merren për bazë nga Njësitë e Qeverisjes Vendore. Në këtë mënyrë investimet që do të parashikohen nga njësitë e qeverisjes vendore do të jenë në linjë me prioritetet e qeverisë.

Për të siguruar që pushteti vendor të kryejë në mënyrë sa më eficiente funksionet e tij, mënyra e sigurimit të buxhetit prej tyre përbën një rëndësi të veçantë.

Deri tani transfertat ndaj pushtetit vendor kanë qenë të pakushtëzuara, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Financave, si pjesë integrale e buxhetit vjetor të miratuar, çka nënkupton që alokimi i buxhetit sipas zërave të shpenzimeve bëhet nëpërmjet vendimeve të këshillave bashkiakë respektivë. Në paketën e buxhetit të vitit 2016 ka pasur edhe disa transfertat specifike për bashkitë, ku në lidhje me sektorin e ujit identifikohet vetëm zëri për Ujitje - Kullim. Një informacion më i detajuar gjendet në Shtojcën 4.

Shpërndarja e buxhetit për pushtetin vendor për vitin 2016 u realizuar bazuar në nenin 15 të Ligjit nr Nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Këshilli i Ministrave detajon sipas bashkive fondin për investime për funksionin e ujitjes dhe kullimit.

Për vitin 2017 për buxhetin vendor janë parashikuar 20.000.000 lekë investime për sigurinë e digave.

Ajo që synohet në të ardhmen është që transfertat ndaj pushtetit vendor të realizohen duke u bazuar në performancën e bashkive, sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe të matshme. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në rritjen e eficiencës së njësive vendore duke i bërë ato dhe shumë konkurrenciale me njera tjetrën, me rezultatin final ofrim shërbimesh ndaj qytetarit me një cilësi më të lartë.

Kapitulli V: MONITORIMI

Monitorimi është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes sistematike të të dhënave, referuar indikatorëve të përcaktuar për çdo objektiv, me qëllim raportimin dhe analizimin e mëtejshëm për realizimin e objektivave të sektorit. Kjo do të bëjë të mundur nxjerrjen e konkluzione nëse investimet që po kryhen në sektor po ecin me ritmet e duhura sipas parashikimeve, nëse ka nevojë për ndryshime ose korrigjime në planifikimin e vitit pasardhës apo atë të PBA-së. Të gjitha së bashku do të çojnë drejt një vendimmarrjeje të integruar dhe më eficiente brenda sektorit.

Të gjitha nivelet qeverisëse në bazë të fushave të përgjegjësisë që ato veprojnë dhe organizimit të programeve financiare të PBA-së dhe të pushtetit vendor, do të paraqesin raportet vjetore të realizimit të PKS-së dhe planit të veprimit, sipas kalendarit të përcaktuar. Kalendarit i procedurave të aplikimit përcakton periudhat brenda të cilave duhet të realizohet secili prej tyre.

5.1. Aktorët

Aktorët e përfshirë në procesin e monitorimit të PKS-së dhe planit të veprimit janë:

- Komiteti i Planifikimit Strategjik
- Njësia e Planifikimit Strategjik
- Grupi i Manaxhimit të Integruar të Politikave
- Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit
- Nëngrupet tematike
- Organet në nivel manaxherial
- Organet në nivel operacional

5.2. Përgjegjësitë dhe detyrat e aktorëve

Referuar urdhrorit të Kryeministrit nr. 129, datë 21.9.2015 për “Marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Manaxhimit të Integruar të Politikave”, vendimit të KKKU-së, nr. 4, datë 2.12.2015 për “Ngritjen, organizimin dhe funksionimin e nëngrupeve tematike në fushën e manaxhimit të integruar të ujit”, “Draft rekomandimit për monitorimin dhe raportimin e strategjive në Shqipëri” pergatitur nga SIGMA (një iniciativë e përbashkët e OECD-së dhe BE-së, finacuar kryesisht nga BE-ja), përgjegjësitë dhe detyrat e aktorëve në procesin e monitorimit janë si më poshtë vijon:

Komiteti i Planifikimit Strategjik jep rekomandime tek GMIP-ja dhe nëngrupet tematike në lidhje me implementimin e PKS-së. Detyrat kryesore janë:

- Diskuton raportin e monitorimit të PKS-në dhe planin e veprimit dhe jep rekomandimet përkatëse. Rekomandimet e KPS-së do të përfshijnë çështje të cilat duhet të adresohen tek ministritë, me qëllim përmirësimin e zbatimit të objektivave strategjike. Këto çështje mund t'i referohen kryesisht aspekteve manaxheriale (p.sh. financa, koordinimi) që kanë lidhje me prioritetet e politikave, drejtimin dhe zbatimin.
- Monitoron dhe vlerëson ecurinë e zbatimit të prioritetëve, programeve, investimeve kryesore dhe riprogramimin e tyre.

- Zgjidh çdo çështje ndërmjet institucioneve përsa i përket zbatimit të PKS-së, nëse zgjidhja ka deshtuar në nivele më të ulëta (p.sh. në GMIP apo ndërmjet institucioneve të ndryshme).

Njësia e Planifikimit Strategjike luan rolin e koordinatorit në nivelin e ekspertizës teknike ndërmjet institucioneve, për zbatimin e PKS-së. Detyrat kryesore të NJPS-së janë:

- Siguron ndihmë metodologjike të vazhdueshme për ministritë, në monitorimin dhe raportimin gjatë procesit dhe përgatitjes së raporteve.
- Nëse është e nevojshme, organizon takime me ministritë e linjës për të diskutuar rreth përgatitjes së raporteve të monitorimit dhe për të identifikuar zgjidhje konkrete.
- Nëse është e nevojshme, merr pjesë në punën e nëngrupeve tematike dhe të GMIP-së.
- Rishikon raportet e PKS-së dhe të planit të veprimit për të:
 - analizuar dhe krahasuar progresin përkundrejt vizionit kombëtar dhe prioritetëve të përcaktuara në SKZHI;
 - analizuar dhe krahasuar progresin përkundrejt premtimeve dhe prioritetëve të qeverisë;
 - analizuar dhe krahasuar informacionin mbi zbatimin e buxhetit dhe investimeve si dhe lidhjen mes progresit përkundrejt politikave të objektivave dhe indikatorëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave;
 - analizuar dhe siguruar një informacion të përmbledhur se si zbatimi i strategjive kontribuon në realizimin e axhendës së integritimit Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian;
- Analizon dhe identifikon risqet në zbatimin e PKS-së dhe planit të veprimit dhe propozon korrektimin e masave tek KPS-ja.

Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave monitoron procesin e zbatimit të PKS-së. Detyrat e saj janë:

- Monitoron progresin në realizimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve të parashikuara në PKS dhe planin e veprimit, duke vlerësuar arritjet e indikatorëve përkatës të SKZHI-së dhe objektivat e PKS-së.
- Monitoron zbatimin e strategjive aktuale, programe, dhe/ose politikave.
- Diskuton dhe jep rekomandime për raportet e kërkuara, me qëllim kalimin e mëtejshëm të tyre në KPS. (Jep rekomandime përsa i përket masave korrigjuese/riparuese përgjatë zbatimit dhe propozon ndryshim të prioritetëve, objektivave ose aktiviteteve, nëse lind e nevojshme, duke marrë në konsideratë riskun që e shoqëron.)
- Monitoron ecurinë e mbështetjes buxhetore të ofruar nga BE-ja, realizimin dhe absorbimin e fondeve të tjera të ofruara nga partnerët për zhvillim.
- Zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet institucioneve të ndryshme gjatë zbatimit të PKS-së. Nëse kjo rezulton e pasuksesshme, ia kalon për zgjidhje KPS-së.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit është hallka koordinuese që integron dhe harmonizon punën e GMIP-së me nëngrupet tematike nga njëra anë dhe raporton tek NJPS-ja. Detyrat kryesore të saj janë:

- Monitoron programin e punës dhe përmbushjen e detyrave të çdo nëngrupi tematik, në bazë të planit vjetor të punës.

- Përcjell raportet së bashku me opinionin përkatës, tek GMIP-ja.
- Përcjell raportin tek NJPS-ja me qëllim diskutimin e mëtejshëm nga KPS-ja.
- Publikon raporte në faqen zyrtare të saj, mbas miratimit përfundimtar të tyre. Në të kundërt, STKKU-ja mund të zgjedhë për të përgatitur një përmbledhje të shkurtuar për të informuar publikun e gjerë rreth informacionit përsa i përket raportimit. Publikimi i raporteve në faqen zyrtare do kryhet duke pasur parasysh rregullat mbi konfidencialitetin e informacionit që bëhet publik.

Nëngrupet tematike synojnë monitorimin sistematik të PKS-së dhe planit të veprimit si dhe vlerësimin e progresit të reformave në sektorin e ujit. Ato kanë përgjegjësi direkte në zbatimin e objektivave përkatëse, masave dhe aktiviteteve. Raportojnë mbi zbatimin e planit të veprimit si dhe për realizimin e indikatorëve dhe nivelin e arritjes së objektivave të PKS-së, tek GMIP-ja.

Ministria udhëheqëse e nëngrupit tematik

- Përcakton mekanizmat e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e PKS-së dhe planit të veprimit, në linjë me kërkesat e monitorimit dhe raportimit dhe siguron zbatueshmërinë e tyre.
- Monitoron punën e nëngrupit tematik dhe siguron zbatimin e të gjitha veprimeve/masave shoqëruese të rekomanduara nga GMIP-ja dhe KPS-ja.
- Mbledh informacion nga ministritë anëtare gjatë zbatimit të objektivave strategjike, masave dhe aktiviteteve.
- Përgatit apo koordinon përgatitjen e raporteve të kërkuara dhe i paraqet tek nëngrupet tematike për t'u diskutuar si dhe tek GMIP-ja nëpërmjet STKKU-së.
- Siguron që informacioni i cili ka lidhje me programet e buxhetit është i përfshirë në raportimet.
- Organizon punën e nëngrupeve tematike dhe për këtë arsye ata luajnë edhe rolin e sekretarisë së nëngrupit tematik, për të përmbushur funksionet.
- Inicion diskutime rreth çështjeve problematike në nivel të lartë, nëse është e nevojshme.

Ministritë anëtare të nëngrupeve tematike

- Grumbullojnë të dhëna, i analizojnë ato dhe sigurojnë informacionin për ministrinë lider të nëngrupit tematik me qëllim përgatitjen e raporteve të nevojshme në linjë me udhëzimet e kësaj të fundit apo të GMIP-së.
- Manaxhojnë mbledhjen e të dhënave dhe i analizojnë me qëllim monitorimin dhe raportimin, gjithashtu i koordinon me statistikat zyrtare kombëtare për të siguruar përmirësimin e të dhënave zyrtare ku është e mundur.

Ministria e Financave

- Siguron cilësinë e informacionit/të dhënave financiare të përcaktuara në raportin e monitorimit të PKS-së dhe planit të veprimit.
- Në bashkëpunim me NJPS-në bën një analizë në lidhje me zbatimin e buxhetit dhe investimeve publike, progresin përkundrejt objektivave, masave dhe aktiviteteve.

Informacioni që sigurohet nga Ministria e Financave do të paraqitet si një përmbledhje e shkurtuar për KPS-në.

Ministria e Integrimit Evropian

- Në bashkëpunim me NJPS-në analizon informacionin e raporteve dhe ndikimin që kanë në axhendën e integrimit Evropian, me qëllim përgatitjen e një përmbledhjeje të shkurtuar për KPS-në.
- Përdor këtë informacion në raportet që kanë lidhje me integrimin Evropian.

Organet në nivel manaxherial raportojnë mbi arritjen e të gjithë indikatorëve në nivel baseni apo rajonal, tek nëngrupet tematike.

Organet në nivel operacional raportojnë mbi zbatimin e investimeve si dhe për indikatorët që mund të identifikohen në këtë nivel, tek organet në nivel manaxherial.

5.3. Instrumentat e monitorimit dhe raportimit

Procesi i monitorimit e ka filluesën që në fazën e parë të prodhimit dhe marrjes së të dhënave, shndërrimit të tyre në informacion me qëllim raportimin, analizimin e mëtejshëm, vlerësimin dhe në fund përmirësimin e indikatorëve.

5.3.1 Raportimi dhe proceset

5.3.1.1 Raporti i monitorimit të PKS-së dhe planit të veprimit

Plani i raportimit të PKS-së dhe planit të veprimit bazohet në planin vjetor të punës së saj. Plani vjetor i punës së GMIP-së udhëzon përgatitjen e koordinuar të inputeve sektoriale përkatëse për:

- Procesin e monitorimit dhe vlerësimit të SKZHI-së dhe PBA-së (Shqyrtimet e Politikave të Programit dhe Shpenzimeve të Programit si dhe Planet e Investimeve dhe kërkesat e shpenzimeve të PBA-së).
- Proceset përkatëse të BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke përfshirë progres raportet vjetore për zgjerim në BE, Programin Kombëtar të Reformave Ekonomike, Nën-Komitetet e MSA-së dhe Komitetet Monitoruese Sektoriale të IPA II, programimin e asistencës për zhvillim. Të gjitha këto inpute do të sigurohen në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integrimit Evropian, Grupet Ndërmnistrore të Punës për Integrim Evropian dhe sektorët e Integrimit Evropian në ministritë përkatëse të cilat kanë rolin udhëheqës në këtë fushë.

Afati maksimal i përgatitjes së progres raportit vjetor është deri në 1 prill të vitit pasardhës.

Mbledhje të veçanta do të organizohen ndërmjet periudhës prill-maj, në lidhje me diskutimet rreth raportit vjetor. Një përmbledhje e këtij raporti do të publikohet në faqen zyrtare të STKKU-së deri në 1 qershor të vitit pasardhës.

Kur tematika e takimeve lidhet me monitorimin e progresit dhe problematikat në reformat sektoriale si dhe me planifikimin e investimeve (përfshirë mbështetjen buxhetore dhe financimin e huaj), STKKU-ja fton partnerët për zhvillim dhe koordinon kalendarin, axhendën e mbledhjeve të GMIP-së bashkarisht me pikën fokale të partnerëve për zhvillim.

Kalendari dhe axhenda e takimeve të GMIP-së hartohet edhe në linjë me proceset e integritit evropian dhe ato ndërkombëtare.

5.3.1.2 Proceset e raportimit vjetor

Faza I: janar-mars

Ministritë anëtare të nëngrupeve tematike përgatisin informacionin për raportin vjetor të monitorimit, dhe ia kalojnë ministrisë udhëheqëse. Kjo e fundit kërkon dhe mbledh informacion nga ministritë anëtare të nëngrupeve tematike.

Draft raporti kalon tek STKKU-ja, e cila përgatit opinionin dhe ia kalon për diskutim dhe miratim GMIP-së duke nxjerrë dhe rekomandimet përkatëse. GMIP-ja diskuton dhe miraton draftin final të raportit vjetor.

Faza II: prill-maj

GMIP-ja nëpërmjet STKKU-së ia kalon progres raportin NJPS-së, për diskutim dhe miratim tek KPS-ja.

NJPS-ja përgatit opinionin për KPS-në e cila diskuton raportin dhe jep rekomandimet përkatëse.

Faza III: deri në 1 qershor

STKKU-ja publikon në faqen zyrtare të saj raportin final.




Figura 12. Skema e monitorimit të hartimit dhe miratimit të raportit të PKS-së dhe planit të veprimit.

(Referoju Shtojcës 5.1)

5.3.2 Raporti i monitorimit 6-mujor të planit të veprimit

Raporti i monitorimit të planit të veprimit do të përgatitet dy herë në vit. Raportimi 6-mujor do të përfshijë 6-mujorin e parë të vitit. Afati maksimal i përgatitjes së raportit 6-mujor është deri në 30 shtator të vitit respektiv. Ndërsa raporti vjetor i planit të veprimit do të përgatitet në të njëjtën kohë dhe do të miratohet deri tek niveli i KPS-së, ashtu si raporti vjetor i Programit Kombëtar Sektorial dhe do të jetë pjesë integrale e këtij të fundit.

Raporti 6-mujor do të kalojë për diskutim deri tek niveli i GMIP-së. Ky raport mund të kalojë për diskutim tek KPS-ja, vetëm nëse nëngrupi tematik apo GMIP-ja vendosin një gjë të tillë.

5.3.2.1 Proceset e raportit 6-mujor

Ministritë anëtare të nëngrupeve tematike përgatisin informacionin për raportimin 6-mujor të monitorimit, dhe ia kalojnë ministritë udhëheqëse.

Ministria udhëheqëse kërkon dhe mblodh informacion nga ministritë anëtare të nëngrupeve tematike dhe draft raportin e kalon tek STKKU-ja, e cila përgatit opinionin dhe ia kalon për diskutim dhe miratim GMIP-së, duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse.

GMIP-ja diskuton dhe miraton raportit 6-mujor, ndërsa ministritë anëtare dhe udhëheqëse vepron në përputhje me rekomandimet e GMIP-së.




Figura 13. Skema e procesit të hartimit dhe miratimit të raportit 6-mujor të planit të veprimit.

(Referoju Shtojcës 5.2)

5.4. Indikatorët e monitorimit

Në mënyrë që të kemi një zbatim të suksesshëm dhe rigoroz të PKS-së, është i domosdoshëm monitorimi dhe vlerësimi. Këto të fundit njihen si një mjet shumë i rëndësishëm për ndjekjen hap pas hapi të procesit të zbatimit, por jo vetëm, pasi nëpërmjet rezultateve të marra prej tyre identifikohen dobësitë dhe problematikat duke ofruar mundësinë e korrigjimit. Nëse monitorimi dhe vlerësimi kryhen në mënyrën e duhur, me anë të zbatimit rigoroz të një plani monitorimi dhe matjes periodike të indikatorëve, mund të prodhojnë rezultatet e pritshme brenda afateve kohore të përcaktuara.

Në këtë material propozohen të përdoren dy lloje indikatorësh: indikatorë të orientuar drejt rezultatit dhe indikatorë të orientuar drejt realizimit të masave.

Indikatorët e rezultatit konsiderohen ata indikatorë të cilët japin një pasqyrë të saktë të arritjes së objektivave. Këto lloj indikatorësh do të përdoren për vlerësimin e arritjes së objektivave të programit. Përcaktimi i vlerës për disa indikatorë është i vështirë, për rrjedhojë është e nevojshme që institucionet përkatëse të kryejnë studime për përcaktimin e vlerave të tyre. Megjithatë fillimisht do të monitorohen ata indikatorë të cilët mund të jenë të matshëm.

Indikatorët e masave qeverisëse mund të konsiderohen ata indikatorë të cilët japin një pasqyrë të përpjekjeve për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm ligjor dhe institucional për reduktimin e presioneve/stresit në burimin ujor, përmirësimin e planifikimit dhe manaxhimin e integruar, shëndoshjen e sistemit financiar dhe përmirësimin e eficiencës së sektorit duke shprehur masën e arritjes së këtyre qëllimeve.




Figura 14. Skema e Indikatorëve

Nga analiza e monitorimit të dy kategorive të përmendura më sipër do të mund të gjykohej mbi kontributin e shtrirë në kohë, që ka dhënë realizimi i secilës prej tyre. Në këtë mënyrë do të mund të vlerësohet deri diku pesha që ka pasur secila nga masat e zbatuara në arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës. Plani Kombëtar Sektorial është një dokument dinamik i cili do të jetë objekt i rishikimit të përvitshëm bazuar në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit.

Nga analiza dhe raportet vjetore të gjeneruara nga nivele të ndryshme të qeverisjes së sektorit të ujit do të vlerësohen edhe problematikat apo masat të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme. Kjo do të lehtësojë dhe orientojë vendimmarrjen në të gjitha nivelet për rishikimin në pikat e “dobëta” të identifikuar. Objekt rishikimi nuk do të jenë vetëm afatet kohore të masave por edhe vetë masat nëse do të jetë e nevojshme. Ndërkaq, objektivat do të mbeten të pandryshuar. Gjithashtu do të mund të rishikohen edhe vlerat e indikatorëve të objektivave në ato raste kur nuk ka qenë e mundur të përcaktohen. Raportimi për çdo indikator do të kryhet nga institucionet përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse. Ky raportim do të jetë pjesë integrale e Sistemit të Planifikimit Operacional të Punës (sistemi aktual i raportimit të ministrive të linjës pranë Kryeministrit). Ministrinë e linjës do të përgatisin një raport mbi realizimin e objektivave, sipas indikatorëve përkatës, si dhe do të propozojnë rekomandime për ndryshime të nevojshme në PKS, të cilat do të përcillen pranë Sekretariatit të GMIP-së. Sekretariati i GMIP-së së bashku me nëngrupet tematike do të jetë përgjegjës për përgatitjen e një raporti

përmbledhës vjetor për vlerësimin e progresit të PKS-së. Sekretariati i GMIP-së do të raportojë për ecurinë e PKS-së në GMIP.

Vlerësimi dhe rishikimi i PKS-së do të jetë pjesë e programit të punës së GMIP-së, i cili përgatitet si draft programi i punës, duke përfshirë kalendarin e takimeve. Ky dokument qarkullon tek të gjithë anëtarët e GMIP-së në Dhjetorin e vitit të mëparshëm dhe zyrtarisht miratohet në Janar të vitit pasues. Më poshtë gjeni tabelën e indikatorëve për cdo objektiv.

Tabela 14. Indikatorët e objektivave të sektorit

Nr.	Objektivi / Indikatori	Njësia Matëse	Viti bazë (2015)	2020	2027	2030
Qëllim Strategjik: Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre ndërmjet përdoruesve, duke maksimizuar përfitimet ekonomike në respekt të kushteve mjedisore dhe parimeve të manaxhimit të qëndrueshëm.						
1	Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim, të sigurtë dhe të vazhdueshëm të popullsisë.					
	1.1 - Mbulimi me ujë	% e popullsisë së mbuluar	81	82	84	90
	1.2 – Mbulimi i kostove O&M ujësjellës & kanalizime	% raporti i kostove me fitimet	100	100	100	100
	1.3 – Mbulimi i kostos totale ujësjellës & kanalizime	% raporti i kostove totale me fitimet	75	82	90	92
	1.4 – Norma e akëtimit	% fatura të paguara kundrejt atyre të lëshuara	92	95	97	100
	1.5 – Niveli i matjes	% raporti i sasisë së ujit të lëshuar dhe atij të faturuar	64	100		
	1.6 – Uji pa të ardhura	% niveli i humbjeve në rrjet	67	54.5	37	30
	1.7 – Eficienca e stafit ujësjellës & kanalizime	Staf për 1000 lidhje	5.53	5	4.5	4
	1.8 – Kohëzgjatja e furnizimit me ujë	orë / ditë	12	14	18	20
2	Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura					
	2.1 - Mbulimi me kanalizime	% e popullsisë së mbuluar	50	60	68	80
3	Plotësimi i nevojave të fermerëve me ujë për sipërfaqet e ujëtshme bujqësore					
	3.1 - Sipërfaqe e ujitur	ha sipërfaqe toke e ujëtshme	135,000	250,000	330,000	360,000
	3.2 Sipërfaqe me infrastrukturë ujëtse funksionale	ha sipërfaqe toke	xx	xx	xx	xx
	3.3 Sipërfaqe e ujitur e përmirësuar (diferenca e sipërfaqes me infrastrukturë me atë funksionale)	ha sipërfaqe toke	xx	xx	xx	xx
	3.4 Volumi i aluvioneve të hequr	m ³	xx	xx	xx	xx
	3.5 Rritja e punësimit në bujqësi	ditë pune / ha	xx	xx	xx	xx
	3.6 Mbledhja e tarifave të ujit	%	xx	xx	xx	xx

4	Përmirësimi i sistemeve të kullimit për sipërfaqet e ujëtshme bujqësore					
	4.1 - Sipërfaqe e kulluar	ha sipërfaqe toke që ka sistem kullimi funksiona	130,000	270,000	280,000	280,000
	4.2 Kanale të tretë dhe të dytë të pastruar	km kanal i pastruar				
	4.3 Volumi i aluvioneve të hequr për çdo 100 metër kanale kryesore					
	4.4 Volumi i aluvioneve të hequr për çdo 100 metër kanale sekondare	m ³				
	4.5 Volumi i aluvioneve të hequr për çdo 100 metër kanale terciare	m ³				
	4.6 Dendësia e kullimit	m.l/ha				
5	Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA)					
	5.1 - Përqindja e zhvillimit të kesaj ekonomie Brenda ZPA-ve.	% e ekonomive që ushtrojnë aktivitetin Brenda këtyre zonave	0%	60%	100%	100%
	5.2 – Prodhimi vjetor nga akuakultura	Ton/vit	xx	xx	xx	xx
6	Shfrytëzimi i potencialeve hidroenergjetike					
	6.1 - Shfrytëzimi i potencialeve	%, krahasuar me potencialin maksimal të vendit	45%	80%	80%	80%
	6.2 – Prodhimi Vjetor i energjisë	kWh/vit	xx	xx	xx	xx
7	Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë					
	7.1 - Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit për industri					
	7.1.a - Nevoja për ujë të freskët për fabrika pasurimi	%, krahasuar me sasinë e kërkuar	100%	100%	100%	100%
	7.1.b - Nevoja për ujë të freskët për uzina ferrokromi	%, krahasuar me sasinë e kërkuar	100%	100%	100%	100%
Qëllim Strategjik: Mbrojtja e ekosistemeve ujore, përfshirë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga ndotja shpërdorimi dhe mbi shfrytëzimi, duke mirë koordinuar të gjitha aktivitetet të cilat shkaktajnë presione mbi to si dhe duke respektuar parimet e manaxhimit të qëndrueshëm.						
8	Ruajtja dhe arritja e statusit ekologjik dhe kimik minimalisht “të mirë”, për ata trupa ujorë që kanë status “më pak se të mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat sipërfaqësore- lumenj, liqene, ujëra tranzitore/kalimtare, ujërat bregdetare, trupat ujorë artificialë dhe shume të modifikuar)²⁴					
	8.1 - Mbulimi me monitorim i trupave ujorë	nr. i stacioneve të monitorimit	xxx	xxx	xxx	
	8.2 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për NBO5	% niveli i përputhshmërisë	53 %	55%	56%	

	8.3 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave; për NH4	% niveli përputhshmërisë	i	43 %	45%	46%	
	8.4 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për P-total,	% niveli përputhshmërisë	i	53%	55%	56%	
	8.5 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për O2 i tretur	% niveli përputhshmërisë	i	xxx	xxx	xxx	
	8.6 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për NO3	% niveli përputhshmërisë	i	xxx	xxx	xxx	
	8.7 - Sasia e substancës ozonholluese HidroKlorflorkarbon (HCFC)	ton / vit		108	84	40	
	8.8 - Ulja e prerjeve të pa ligjshme në pyje	m ³ /vit		xxx	xxx	xxx	
	8.9 - Plane të manaxhimit të baseneve lumor	nr. planesh		1	3	6	
	8.10 - Rritja e Sipërfaqes së zonave të mbrojtura në shkallë vendi	km ² Sipërfaqja e zonave të mbrojtura		xxx	xxx	xxx	
	8.11 - Plane Manaxhimit të zonave të mbrojtura	nr. planesh		xxx	xxx	xxx	
	8.12 - Grumbullimi dhe hedhja e mbetjeve.	% e popullësisë		xxx	xxx	xxx	
	8.13 - Riciklimi i mbetjeve	% e mbetjeve të ricikluara		xxx	xxx	xxx	
	8.14 - Mbulimi me impiante të trajtimit të mbetjet e ngurta	nr. Impiante		xxx	xxx	xxx	
	8.15 - Rehabilitimi i tokave të ndotura	ha sipërfaqe tëke e rehabilituar		xxx	xxx	xxx	
	8.16 - Mbulimi me impiante të trajtimit të ujërave të përdorura	% e popullësisë e lidhur me impiante trajtimi të ujërave të ndotur		39	59	70	
	8.17 - Reduktimi i ndotjes nga pesticidet dhe kimikatet në fushën e bujqësisë	% e reduktimit të nivelit të ndotjes		n/a	10%	20%	
	8.18 - Reduktimi i shfrytëzimit të paligjshëm të inerteve	% e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të paligjshme		xxx	xxx	xxx	
	8.19 - Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve me gropa septike	% e popullësisë e mbuluar		6	15	25	
9	Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik dhe kimik, ruajtja dhe arritja e tyre si minimalisht të mirë, për ata trupa ujore që kanë status “më pak se mirë”, “të dobët” apo “shumë të dobët”. (ujërat nëntokësore)						
	9.1 - Mbulimi me monitorimi i trupave ujore	nr. i stacioneve të moitorimit		xxx	xxx	xxx	
	9.2 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për NBO5	% niveli përputhshmërisë	i	53 %	55%	56%	
	9.3 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave; për NH4	%		43 %	45%	46%	

		niveli përputhshmërisë	i			
9.4 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për P-total,	%	niveli përputhshmërisë	i	53%	55%	56%
9.5 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për O2 i tretur	%	niveli përputhshmërisë	i	xxx	xxx	xxx
9.6 - Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujërave për NO3	%	niveli përputhshmërisë	i	xxx	xxx	xxx
9.7 - Sasia e substancës ozonholluese HidroKlorflorkarbon (HCFC)	ton / vit			108	84	40
9.8 - Ulja e prerjeve të pa ligjshme në pyje	m ³ /vit			xxx	xxx	xxx
9.9 - Plane të manaxhimit të baseneve lumor	nr. planesh			1	3	6
9.10 - Rritja e Sipërfaqes së zonave të mbrojtura në shkallë vendi	km ² Sipërfaqja e zonave të mbrojtura			xxx	xxx	xxx
9.11 - Plane Manaxhimi të zonave të mbrojtura	nr. planesh			xxx	xxx	xxx
9.12 - Grumbullimi dhe hedhja e mbetjeve	% e popullësisë			xxx	xxx	xxx
9.13 - Riciklimi i mbetjeve	% e mbetjeve të ricikluara			xxx	xxx	xxx
9.14 - Mbulimi me impjante të trajtimit të mbetjeve të ngurta	nr. Impiante			xxx	xxx	xxx
9.15 - Rehabilitimi i tokave të ndotura	ha sipërfaqe të reabilituar			xxx	xxx	xxx
9.16 - Mbulimi me impjante të trajtimit të ujërave të përdorura	% e popullësisë e lidhur me impjante trajtimi të ujërave të ndotura			39	59	70
9.17 - Reduktimi i ndotjes nga pesticidet dhe kimikatet në fushën e bujqësisë	% e reduktimit të nivelit të ndotjes			n/a	10%	20%
9.18 - Reduktimi i shfrytëzimit të paligjshëm të inerteve	% e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të paligjshme			xxx	xxx	xxx
9.19 - Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve me gropa septike	% e popullsisë e mbuluar			6	15	25
10	Ruajtja dhe arritja e cilësisë minimalisht “ e mirë” për ujërat larës (të brendshëm dhe bregdetar e kalimtar)					
10.1 - Rritja e numrit të stacioneve të motorimit të ujrave bregdetare për elementet mikrobiologjik	nr. i stacioneve të monitorimit			78	100	xxx
10.2 - Rritja e numrit të parametrave të monitorimit sipas kërkesave të direktivave Evropiane	Numri i parametrave të monitoruar			xxx	xxx	xxx

Qëllim Strategjik: Mbrojtja e popullsisë dhe e pronës nga efektet e pakthyeshme të shkaktuara nga uji, përfshirë këtu përmbytjen, stuhitë e shiut dhe erozionin, në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive

11	Reduktimi i rrezikut dhe humbjeve nga përmbytja për jetën, jetesën dhe shëndetin dhe asetëve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve dhe komuniteteve (Sendai frameëorë)					
	11.1 - Reduktimi i numrit të banorëve të prekur nga përmbytjet	Numri i banorëve të prekur	14000	9000	7000	6000
	11.2 - Reduktimi i numrit të banesave të prekura nga përmbytjet	Numri i banesave të prekura	1100	700	500	400
	11.3 - Reduktimi i sipërfaqeve bujqësore të prekura nga përmbytjet	sipërfaqja e tokave bujqësore të prekura	5900	4800	4000	3600
	11.4 –Përqindja e volumit të ujit të mbetur në zonat e evakuara nga përmbytja	%	xx	xx	xx	xx
12	Përmirësimi i sigurisë së digave të nevojshëm për ujtje					
	12.1 - Numër digash në gjendje të sigurtë	Numër digash	130	240	540	540
	12.2 – Disponueshmëria e ujit në raport me kërkesat	m3 ujë	xx	xx	xx	xx
	12.3 – Shkalla në të cilën janë hequr aluvionet nga rezervuarët	m3 sasi aluvionesh				
	12.4 – Frekuenca e vrojtimit të gabimeve në sigurinë e digave	numër kontrollesh				
13	Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit					
	13.1 - Shkalla e erozionit					
	13.1.a - Zonat pak të rrezikuara (20% e territorit)	t/ha/vit	5	4.5	3	2.5
	13.1.b - Zonat shumë të rrezikuara (70% e territorit)	t/ha/vit	20	18	15	13

Fjalor/Përkufizime

Spektori i ujit	Spektori i ujit është tërësia e aktiviteteve të cilat kanë mundësi të krijojnë një vlerë të shtuar nga burimet ujore dhe infrastruktura e përdorimit të tyre. Nënsektorët e ujit përfaqësojnë fusha të ndryshme të përdorimit të ujit, mbrojtjes së ujit dhe mbrojtjes nga uji. Këto nënsektorë kanë impaktin e tyre në jetën sociale dhe shëndetin publik, bujqësi, energjitiqë, fusha të tjera të ekonomisë dhe në ruajtjen e ekuilibrave mjedisor”.	UN-WATER 2009
Qeverisja e ujit	Qeverisja e sektorit të ujit përfshin formulimin, ngritjen dhe zbatimin e politikave të ujit, kuadrin ligjor dhe atë institucional, si dhe qartësimin e rolit dhe përgjegjësi të qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat në lidhje me shërbimet e ujit dhe burimet ujore.	IPA Concept Note
Qasja Sektoriale	Është një proces i cili synon drejt zgjerimit të pronësisë kombëtare dhe qeverisjes mbi politikën dhe vendimet për sektorin publik për shpërndarjen e fondeve brenda një sektorit të ujit, kështu duke rritur koherencën ndërmjet politikave sektoriale, shpenzimeve qeveritare dhe arritjes së rezultateve. Qasja sektoriale e ujit, në mënyrë ideale, përfshin autititetet në nivel kombëtar nëpërmjet përgatitjes së një programi kombëtar sektorial për të zbatuar një set politikash publike në një nivel të caktuar.	Ekspertet e SIWI
Program Sektorial Kombëtar	Një seri e planifikuar veprimesh për tu realizuar në të ardhmen i cili integron politikën dhe strategjitë për sektorin e ujit. PKS është një program i cili integron politikën dhe strategjitë për sektorin e ujit. Ky program përfshin një buxhet sektorial dhe kuadrin e shpenzimeve afat-mesme si edhe kuadrin e koordinimit të sektorit me donatorët e huaj e përfshirë në të. Kështu, ekzistenca e një politike dhe strategjie për sektorin e ujit, buxheti sektorial si edhe një kuadri koordinimi me donatorët e huaj, përbëjnë blloqet kryesore mbi të cilat ndërtohet një program kombëtar sektorial.	English Oxford Dictionary (https://en.oxforddictionaries.com/definition/programme)
Benchmark	Benchmark është një standard ose pikë referimi me anë të së cilës realizohet krahasimi i të dhënave/vlerësimi nëpërmjet krahasimit (<i>kryesisht i performancës</i>). Përdoret kryesisht për vlerësimin e performancës së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.	English Oxford Dictionary (https://en.oxforddictionaries.com/definition/programme)
Subvencionimi	Subvencionimi është një përfitim ekonomik ose ndihmë financiare (si kredi e butë apo grant) e dhënë nga qeveria për të: mbështetur një aktivitet të caktuar; mbajtur çmimet e ulëta; mbajtur të ardhurat nga produktet strategjike; mbajtur nivelin e punësimit; injektuar investimet për të reduktuar nivelin e papunësisë.	http://www.businessdictionary.com/definition/subsidy.html
GIS	GIS (system gjeografik i informacionit) është një sistem kompjuterik për kapjen, ruajtjen, kontrollimin dhe shfaqjen e të dhënave në lidhje me pozicionet e sipërfaqes së Tokës. Ky sistem paraqet të dhëna të shumëllojshme në hartë	http://www.nationalgeographic.org/encyclopedia/geographic-information-system-gis/
Masë	Marrja e veprimeve të caktuara për të arritur diçka specifike (p.sh përmirësim performance).	https://en.oxforddictionaries.com/definition/take-measures
Aktivitet	Aktivitetet janë burime njerëzore, mjetet në dispozicion, komunikimi dhe procese të cilat përfaqësojnë një përpjekje të përbashkët për realizimi të një mase.	https://www.ibm.com/support/knowledgecenter/SSKTWP_8.0.1/com.ibm.openactivitiesties.client.doc/r_what_is_an_activity.html
Indikator	Një vlerë që derivon nga parametra të cilët tregojnë, sigurojnë informacion rreth, përshkruajnë gjendjen e një fenomeni / mjedisi / zone që ka rëndësi madhore dhe që shtrihet përtej vlerës së një parametri.	OECD
Zhvillim qëndrueshëm	Zhvillimi i cili kënaq nevojat e sotme të shoqërisë pa kompromentuar aftësinë e gjeneratave të së ardhmes për të kënaqur nevojat e tyre .	TFIME-2009
Prioritizim	Prioritizimi, si një parim, nënkupton të bësh 'gjërat e para të parat'; si një proces, nënkupton vlerësimin e një grupi produktesh dhe renditjen e tyre sipas rëndësisë apo nivelit të emergjencës.	http://www.businessdictionary.com/definition/prioritization.html

Kufi hidrografik i basenit ujembledhës	Vija imagjinare, e cila formohet duke lidhur pikat më të larta të peizazhit, si majat e maleve, kodrave, kreshtave që ndajnë luginat nga njëra-tjetra dhe që lë jashtë saj të gjitha degët e përrenjve dhe lumenjve që rrjedhin në anë të kundërt.	Ligj nr. 111/2012
Akuiifer	Formacione gjeologjike, me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme, që mundësojnë ose një rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose nxjerrjen e një sasive të konsiderueshme të ujërave nëntokësore.	GH, Aquastat, Ligj Nr. 111/2012
Basen ujour	Është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri përrenjsh, lumenjsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det, në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë apo në një lumë tjetër.	Ligj Nr. 111/2012
Burimet ujore	Janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.	Ligj Nr. 111/2012
Burime ujore të rinovueshme	Koncept që i referohet sasisë së ujit që mbahet nga cikli hidrologjik dhe rikthehet bazuar në parashikimet e bëra	GH
Burime ujore të shfrytëzueshme	(burime ujore të manaxhueshme ose potencial i zhvillimit ujour): Burimet ujore që konsiderohen të disponueshme për zhvillim në kushte të caktuara sociale, ekonomike, mjedisore. Llogaritja e burimeve të shfrytëzueshme ujore merr në konsideratë faktorë si pavarësia e rrjedhës, ujërat nëntokësorë dhe rrjedha minimale jo për konsum.	FAO 2003
Eutrofikim	Është pasurimi i ujit me përbërës ushqyes, veçanërisht me komponime azotike ose fosforike që shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve të larta bimore, që krijojnë prishje të padëshirueshme të baraspeshës së organizmave të pranishëm në ujë dhe të cilësisë së këtij uji.	Ligj Nr. 111/2012
Grumbullimi i ujit	Ka të bëjë me të gjitha ato veprimtari që nëpërmjet strukturave apo mekanizmave të tillë si: diga, puse, depo uji, çisterna, kanale, ujësjellësa, tubacione, kanale kulluese dhe kanalizime të ujërave të zeza, grumbullojnë, kanalizojnë, ndryshojnë drejtimin apo nxjerrin e ujit për përfitim publik.	Ligj Nr. 8102, dt 28.03.1996 (i ndryshuar)
Largimi i ujërave industriale	Sasia vjetore e ujit të larguar për qëllime industriale. I referohet zakonisht industrisë vefurnizuese që nuk lidhen me ndonjë rrjet shpërndarjeje. Përfshin burime të rinovueshme ujore si dhe mbishfrytëzim të ujërave të rinovueshme nëntokësore, largimin e ujërave nëntokësore fosile, përdorimin e ujit të shkripëzuar ose ujërat e përdorur të trajtuar. Në disa raste, largimi i ujërave industriale përfshihet në kategorinë e largimit të ujërave nga përdorimi shtëpiak.	Aquastat
Liqen	Është një trup me ujëra të brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore të qëndrueshëm.	Ligj Nr. 111/2012
Lumë	Është një trup ujour i brendshëm, me ujë i cili në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë.	Ligj Nr. 111/2012
NBO₅	Nevoja biologjike për oksigjen vlerëson aftësisë e degradimit të një mbetjeje organike nëpërmjet konsumit të oksigjenit gjatë procesit të degradimit organik. Ngarkesa organike në ujërat natyrore shteron oksigjenin e tretur në ujë. Përkundrazi, trajtimi i ujërave të zeza redukton NBO-në. "NBO ₅ " është sasia e oksigjenit të konsumuar gjatë 5 ditëve nga bakteret aerobe.	BB, Ligj Nr. 111/2012
Ndotje	Substanca kimike ose substanca të tjera, përqendrimi i të cilave është më i lartë se përqendrimi që gjendet në kushte natyrore.	WWDR3
Parametër	Një karakteristikë (tipar) që matet ose vëzhgohet.	OECD
Përdorimi i ujit	I referohet përdorimit të ujit nga bujqësia, industria, prodhimi i energjisë, ekonomitë shtëpiake, si dhe peshkimi, rekreacioni, transporti dhe shkarkimi i mbetjeve.	OECD
Presione	Me presione nënkuptohet veprimtaria e cila shkakton ndotje të ujit, përkeqësim të cilësisë së tij si dhe zvogëlim të rezervave të ripërtëritshme	

Reshje	(1) Produkti i lëngshëm ose i ngurtë i kondensimit të avujve të ujit që precipiton nga retë ose depozitohet nga ajri në tokë. (2) Sasia e reshjeve në njësi horizontale sipërfaqe në njësi kohe.	GH
Rezervuar	Trup ujour, natyror ose artificial, i përdorur për akumulim, rregullim dhe kontrollin e burimeve ujore.	GH
Rreziku nga përmbytjet	Është kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmbytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, për gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik që lidhet me ngjarjen e përmbytjes.	Ligj Nr. 111/2012
Rrjedhë mjedisore	Një koncept i lidhur me cilësinë dhe sasinë e ujërave në sipërfaqe ose nënsipërfaqe të një trupi ujour, që siguron një rrjedhë ujore të mjaftueshme për të realizuar funksionet e ekosistemit dhe të mirat e shërbimet që varen nga këto funksione.	Dyson <i>et al.</i> , 2003
Trajtimi i ujërave të zeza (ujëra të ndotura urbane)	Largimi i ndotësve fizikë, kimikë dhe biologjikë nga ujërat e përdorur si ato të drenazhimit ashtu edhe shtëpiake, nëpërmjet proceseve fizike, kimike dhe biologjike.	OECD
Ujë i pijshëm	Është uji i përcaktuar për përdorim nga njerëzit, ku futen: a) ujërat e trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për qëllim pirjeje, gatimi, përgatitjeje të ushqimeve dhe për nevojat e higjienës, pavarësisht nga origjina e tyre dhe nga fakti nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës, publik apo privat, depozitave, autoboteve, puseve, individuale apo kolektive, apo të ambalazuara në shishe ose enë;	Ligj Nr. 111/2012
Ujë i përdorur industrial	Është uji i prodhuar nga proceset e ndryshme industriale, i cili mund të jetë me rrezik kontaminimi apo ndotjeje për mjedisin në të cilin ai shkarkohet.	Ligj Nr. 111/2012
Ujëra nëntokësore	Të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës apo kanë dalje të drejtpërdrejtë në sipërfaqen e tokës në formën e burimeve natyrore.	Ligj Nr. 111/2012
Ujëra sipërfaqësore	Janë ujërat e brendshme, me përjashtim të ujërave nëntokësore, ujërat e përkohshme, ujërat bregdetare dhe ujërat territoriale.	Ligj Nr. 111/2012
Ujëra të ndotura	Janë ato ujëra që janë përdorur për qëllime hidrosanitare dhe industriale, grumbullimi, përpunimi dhe largimi i të cilave është detyrim për shëndetin dhe komoditetin publik.	Ligj Nr. 8102, dt 28.03.1996 (azhornuar)
Ujëra të ndotur të trajtuar	Ujëra që iu është bërë trajtim primar, sekondar ose trajtime të mëtejshme për të ulur nivelin e ndotësve ose rreziqeve shëndetsore, i cili rikthehet në mjedis. Mund të jenë edhe efluentë.	OECD
Trup ujour sipërfaqësor	Është një element i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, p.sh. një liqen, rezervuar, përrua, lumë ose kanal, pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujëra të përkohshme ose një shtrirje e ujit bregdetar.	Ligj Nr. 111/2012
Trup ujour tepër i modifikuar	Është trupi ujour sipërfaqësor, i cili, si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor, ka ndryshuar rrënjësisht karakterin e tij në krahasim me atë që është shpallur në legjislacionin përkatës nga autoriteti kompetent.	Ligj Nr. 111/2012

BIBLIOGRAFIA

- Urdhri nr.129 i Kryeministrit;
- Vendimi i KKU-së nr. 2 për nëngrupet tematike
- Draft“Recommendations for Monitoring and Reporting of Strategies in Albania”
përgatitur nga SIGMA (A joint initiative of the OECD and the EU, principally financed
by the EU)

SHTOJCA

Shtojca 1: Aktorët kryesorë në sektor

Grupi për Manaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin (GMIP) kryesohet nga Kryeministri dhe anëtarë të tij janë ministrat përgjegjës për një fushë të caktuar të sektorit të ujit, përfaqësues të pushtetit lokal sipas sektorëve, Pikat e Kontaktit për Çështjet Gjinore të ministrisë udhëheqëse. Partnerët për zhvillim janë të ftuar të marrin pjesë, duke promovuar dialogun, bashkërendimin, harmonizimin dhe komplimentaritetin e ndërhyrjeve të tyre në sektor dhe rakordimin e këtyre ndërhyrjeve sipas prioriteteve të vendit. Funkzioni i GMIP-së është të këshillojë, drejtojë dhe koordinojë institucionet e përfshira në sektor, të zhvillojë dhe të zbatojë një Program Kombëtar Sektorial (përfshirë një Program për Mbështetje Sektoriale që tregojnë burimet e financimit—shtetërore dhe të jashtme—për masat e ndryshme), të sigurojë dakortsi për çështje kyçe që ndikojnë në sektor, të miratojë listën e vetme sektoriale të projekteve prioritare strategjike, të miratojë rezultatet e punës të ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm dhe të bëjë rekomandime për vendim - marrësit e nivelit të lartë.

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi qendror udhëheqës në sektorin e burimeve ujore. Ai përbën një forum të nivelit të lartë ndërministror për planifikimin dhe manaxhimin në mënyrë të integruar të ujit.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), si organi ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU), ka objekt të veprimtarisë së tij projektimin dhe ngritjen e sistemit total të integruar të ujit, si dhe monitorimin e garantimin e funksionimit efikas të manaxhimit të integruar të këtij sistemi. Ai luan rolin e Sekretariati Teknik të GMIP-së për ujin përgjegjës për koordinimin e në nivel ndërinstitucional për të gjitha çështjet e manaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e ujitje – kullimit, infrastrukturës së mbrojtjes nga përmytja, në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës si dhe administrimin e burimeve ujore, përfshirë ujërat e brendshëm, ujërat nëntokësorë dhe ujërat detarë.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

Ministria e Mjedisit (MM) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe manaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave si dhe ndryshimeve klimatike.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në shfrytëzimin e burimeve hidrike për prodhimin e energjisë si dhe nxitjen dhe promovimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike.

Ministria e Integrimit Evropian (MIE) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të integrimit, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian.

Ministria e Shëndetësisë (MSH), është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ndër të tjera është përgjegjëse për bashkë-hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Ministria e Shëndetësisë harton, propozon për miratim dhe zbaton akte dhe nënakte ligjore për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Në zbatim të akteve ligjore në fuqi, Ministria e Shëndetësisë kryen monitorimin, inspektimin dhe ekspertizën e cilësisë së ujit të pijshëm nëpërmjet institucioneve në varësi të saj, përkatësisht Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik (SRSHP), Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) dhe Institutit të Shëndetit Publik (ISHP).

Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që synojnë modernizimin e zbatimit e kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave në sferën ekonomike, të turizmit, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka rolin kryesor në sektorin e emergjencave civile, duke përfshirë edhe emergjencat nga përmbytjet. Është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile.

Ministria e Financave (MF) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në investimet kapitale financiare në sektorin e ujit.

Ministria e Kulturës është përgjegjëse ka përgjegjësi në shfytëzimin dhe përdorimin e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet Këshillit Kombëtar të Restaurimeve dhe Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Komisioni i Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare (KPAUN), kryesuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, është përgjegjëse për diskutimin, në nivel të lartë, të çështjeve të lidhura me ujërat ndërkufitare.

Komisioni Bilateral midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, i krijuar në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit për rregullimin e regjimit ujqor të lumit Drin – Bunë dhe liqenit të Shkodrës pas situatës së përmbytjes, 2010.

Komiteti Drejtues për manaxhimin e lumit Drin (ndërkufitar) midis Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Kosovës dhe Greqisë (i përbërë nga ministrinë përgjegjëse administrimin për burimet ujorë respektivë), krijuar në vitin 2012, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit për manaxhimin e basenit të lumit Drin firmosur nga vendet të cilat ndajnë këtë basen. Në bazë të këtij janë ngritur tre grupe pune, në 2012: grupi për biodiversitetin, grupi për shkëmbimin e informacionit dhe grupi për direktivën kuadër të ujit.

Komision i Manaxhimit të parkut kombëtar të Prespës krijuar pas shpalljes si park kombëtar. Ka për detyrë të administrojë, manaxhojë territorin e parkut dhe të zbatojë planin e manaxhimit të parkut kombëtar të “Prespa”.

Komiteti i manaxhimit të pellgut ujëmbledhës së liqenit të Ohrit, krijuar në zbatim të marrëveshjes dypalëshe midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Komiteti ka për detyrë hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike, programeve,

planeve të veprimit që do të zbatohen në Liqen dhe pellgun ujëmbledhës të tij. Ai harton programin e monitorimit, grumbullon, analizon dhe publikon të dhënat lidhur me gjendjen mjedisore të liqenit. Komiteti i merr të gjitha vendimet, lidhur me gjendjen mjedisore, me konsensus në mungesë të konsensusit i drejtohet Parlamenteve përkatës.

Komisioni i Liqenit të Shkodrës, krijuar në zbatim të marrëveshjes dypalëshe midis dy Ministrive, Malit të Zi dhe Shqipërisë, përgjegjëse për liqenet. Komisioni ka për detyrë hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike, planeve të manaxhimit të zonave të mbrojtura, planeve të veprimit dy palëshe. Ai harton programin e monitorimit, grumbullon, analizon dhe publikon të dhënat lidhur me gjendjen mjedisore të liqenit. Komisioni i merr të gjitha vendimet, lidhur me gjendjen mjedisore, me konsensus dhe në mungesë të konsensusit i drejtohet Parlamenteve përkatës.

Këshillat e Baseneve Ujorë (KBU) janë autoritetet lokale përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenet përkatëse. Ato përbëhen nga 9 – 19 anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme të lidhura me ujin, për një basen të caktuar. Ato drejtohen nga Prefekti.

Prefekt ka rolin kryesor, në nivel lokal, për planifikimin e emergjencave civile dhe manaxhimin e krizave brenda kufijve të tij administrative, qarkut. Përgjegjësia kryesore është organizimi dhe koordinimi i planeve emergjente dhe zbatimin e masave të përcaktuara.

Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) janë ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, ujitjes. Bashkitë janë gjithashtu përgjegjëse për planifikimin e emergjencave civile dhe manaxhimin e situatave kritike brenda territorit të tyre administrativ. Nëpërmjet Komisionit të Emergjencave Civile Lokale, bashkia, koordinon aktivitetet e strukturave qeverisëse dhe jo-qeverisëse në planifikimin dhe përgjigjen e emergjencave.

Agjencia Kombëtare e Ujësjetës – Kanalizimeve (AKUK) është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës. Ajo është përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve që sigurojnë furnizim me ujë të pijshëm, kanalizimin, trajtime të ujit të ndotur për të gjithë popullsinë në vend, në bashkëpunim me qeverisjen vendore dhe subjektet e manaxhimit të infrastrukturës ujore.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është një institucion qendror publik në varësi të Ministrisë së Mjedisit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore të AKM dhe degëve rajonale në qarqe. AKM është përgjegjëse për zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit dhe hartimit i Raportit vjeçar të gjendjes së mjedisit.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), është person juridik publik, me status Drejtori e Përgjithshme në varësi të Ministrisë së Mjedisit, dhe është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planit të manaxhimit, manaxhon rrjetin e zonave të mbrojtura dhe propozon ndryshime të kuadrit ligjor për zonat e mbrojtura.

Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM) janë në varësi të AKZM dhe janë përgjegjëse për zbatimin e planit të manaxhimit të zonave të mbrojtura dhe kryerjen e monitorimeve në vend sipas zonës që ato mbulojnë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është institucion në varësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Ajo është përgjegjëse për miratimin e projekt

fizibiliteteve për përcaktimin e skemës së shfrytëzimit hidroenergjetik të rrjedhave ujore, kapacitetit të shfrytëzimit të burimeve ujore për prodhim energjie, si dhe monitorimin e këtyre veprave.

Agjencia e Basenit Ujor (ABU) (gjashtë) është organi ekzekutiv i Këshillit të Basenit në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Është përgjegjëse për hartimin e inventarit të përdorimit të burimeve ujore në sasi dhe cilësi dhe prodhon raporte periodike për KBU-në.

Bordet Rajonale të Kullimit (Lezhë, Fier, Durrës, Korçë) janë institucione përgjegjëse për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit dhe çdo vepër mbrojtjeje nga përmbytja brenda sipërfaqes së tyre të veprimit, në mënyrë që të largojnë ujin e tepërt, parandalojnë grumbullimin e ujit dhe përmbytjet. Funkcionet dhe detyrat kryesore të tyre, pas reduktimit të numrit të tyre, janë reduktuar dhe lidhen kryesisht me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore kulluese, hidrovorët, kanalet kryesorë të rreth 22 skemave të mëdha ujitëse, përfshirë edhe 7 rezervuarë të mëdhenj dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytjet (argjinatura lumore dhe detare si dhe kanalet e ujërave të larta).

Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (ASIG) është përgjegjës për vendosjen e standardeve në grumbullimin e të dhënave, data modelin duke përfshirë edhe burimet ujore.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) është institucion ndërinstitucional. Ajo bashkërendon dhe drejton operacionet e antindotje, operacionet në mbrojtje të pershimit dhe operacionet për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe mjedisit detar.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është përgjegjës për nxitjen, nëpërmjet asistencës financiare, e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut dhe me përparësitë e strategjitë e programit qeveritar, sipas fushave përkatëse.

Agjencia Kombëtare e Turizmit është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe kombëtare në fushën e turizmit, promovimin dhe krijimin e identitetit të turizmit shqiptar, nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë potencialit ekzistues turistik të vendit. Gjithashtu, përgatit programet për sigurimin e asistencës financiare për projektet që kanë për qëllim përmirësimin e sektorit të turizmit në vend.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është autoritet i pavarur përgjegjës për vendosjen e tarifave (për ujë të pijshëm dhe kanalizime), për licencimin e shoqërive të ujësjellës - kanalizimeve si dhe monitorimin e performancës së tyre.

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni, në varësi administrative të Ministrit të Shëndetësisë, ndër të tjera është përgjegjës për sigurimin e ekspertizave dhe pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndet publik . Mbështet Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik me ekspertizë në monitorimin e jashtëm të cilësisë së ujit të pijshëm, survejancën epidemiologjike dhe trajnimin e vazhdueshëm si dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) me ekspertizë dhe ekzaminime laboratorike.

Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik (SRSHP), pjesë e sistemit shëndetësor publik, në varësi të Ministrit të Shëndetësisë, ka për mision ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës në territorin që mbulojnë. Ndër të tjera janë përgjegjëse për monitorimin e jashtëm të cilësisë së ujit të pijshëm me qëllim parandalimin e sëmundjeve me origjinë ose të

transmetuara përmes ujit dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Mbështesin Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) me ekzaminime laboratorike. Sigurojnë survejancën epidemiologjike, hetimin epidemiologjik dhe koordinimin e përgjigjes ndaj shpërthimeve me origjinë hidrike.

Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (ISHSH), në varësi të Ministrit të Shëndetësisë, është përgjegjëse për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik, është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit të Ministrisë së Shëndetësisë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike.

Akademia e Shkencave (ASH) është institucioni përgjegjës për propozimin dhe kryerjen e kërkimeve e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) është përgjegjës për monitorimin e ujërave sipërfaqësore në cilësi dhe sasi. IGJEUM gjithashtu kryhen studime të ndryshme në lidhje me rrjedhjen e ujit, reshjet atmosferike dhe për parandalimin nga përmbytjet.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), vepron në varësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore.

Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) është institucioni që siguron të dhënat hapësinore dhe mbështetjen e veprimeve ushtarake dhe operacioneve të Forcave të Armatosura në fushat e Gjeodezisë, Hartografisë, Fotogrametrisë dhe Remote-sensing-ut, si dhe kërkesave për studimin, projektimin, standardizimet dhe certifikimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe atyre të perspektivës. IGJIU përgjigjet për hartografin masiv tokësor, detar dhe ajror të RSH dhe është autori i ndërtimit të rrjeteve gjeodezike.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) inspekton zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e burimeve ujore.

Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Mjedisit (ISHPM) është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjit që lidhet me përdorimin e burimeve natyrore dhe arritjes së kërkesave respektive në mbrojtjen e mjedisit.

Inspektorati Shtetëror i Ujërave (ISHU) është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat.

Organizatat dhe federatat e përdoruesve të ujit - Qëllimi i tyre është i lidhur me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e një ose më shumë sistemeve të ujitjes, si dhe sigurimin e ujit për ujitje për anëtarët e saj, duke ju shërbyer në këtë mënyrë interesave publike dhe të anëtarëve të saj.

Person fizik ose juridik privat konsiderohet si aktori kryesor i cili jep kontributin e tij nëpërmjet donacioneve të ndryshme. Gjatë viteve të fundit, investime të ndryshme në hidrocentrale, industrinë e lehtë dhe miniera janë ndërmarrë nga sektori privat.

Shtojca 2: Metodologjia

Shtojca 2.1 Detajimi i masave në aktivitete

Përcaktimi i aktiviteteve me qëllim realizimin e masave të parashikuara për sektorin e ujit në vetvete ka qënë një sfidë në procesin e hartimit të këtij programi. Metodologjia e përdorur për këtë rast përfshin dy faza kryesore:

- Identifikimi fillestar i aktiviteteve
- Analizimi i tyre

Për të lehtësuar këtë, STKKU ka përgatitur një matricë e cila i është shpërndarë të gjitha nëngrupeve tematike.

Për identifikimin fillestar të aktiviteteve janë angazhuar anëtarët e nëngrupeve tematike sipas fushës së ekspertizës që mbulon secili prej tyre, por edhe në kuadër të fushës së përgjegjësisë që mbulon institucioni që secili prej tyre përfaqëson. Gjatë identifikimit fillestar të aktiviteteve respektive për secilën masë, anëtarët e nëngrupeve tematike kanë marrë në konsideratë të gjitha dokumentet strategjike për çdo sektor, të miratuara apo në procese finale të përgatitjes, Strategjia e Ujësjetës Kanalizimeve 2011-2017, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2018 – 2020, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2014-2020, si dhe Masterplanin e Ujësjetës Kanalizimeve për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Secili nëngrup tematik ka përgatitur kështu një listë me aktivitetet përkatëse për secilën masë e cila më pas i është përcjellë STKKU-së për harmonizim.




Figura 15. Skema e përfutimit të informacionit nga dokumente planifikuese

Gjatë fazës së dytë, ajo e analizimit të aktiviteteve, janë rishqyrtuar të gjitha propozimet e mara nga nëngrupet tematike duke patur parasysh edhe rekomandimet e nënkomitetit të BE-së Uji, Energjia, Transporti dhe Mjedisi si dhe Progres Raportet e viteve të fundit. Analiza ka konsistuar në harmonizimin e të gjitha aktiviteteve me qëllim eliminimin e përsëritjeve,

plotësimin me aktivitete aty ku është gjykuar e nevojshme, si edhe harmonizimin dhe redaktimin e tyre.

Megjithatë, duke patur parasysh faktin që PKS është një dokument i gjallë, nisur nga fakti që programet e planifikimit buxhetor janë me një afat 3 vjeçar, lista e aktiviteteve të hartuar mbetet subjekt i ndryshimeve dhe plotësimeve përkatëse.

Shtojca 2.2 Sekuencimi i masave dhe aktiviteteve në funksion të ndërtimit të një mekanizmi eficient qeverisës

Sikurëse theksohet edhe më sipër për realizimin e objektivave janë propozuar masat përkatëse për aspekte të ndryshme të kuadrit qeverisës, më pas këto masa planifikohet të zbatohen nëpërmjet aktiviteteve. Për të bërë eficiente dhe realiste zbatimin e masave, është e nevojshme që të realizohet shtrirja në kohë e aktiviteteve apo masave që detyrimisht janë të varura, nga realizimi i një aktiviteti apo mase tjetër. Në këtë mënyrë në ndryshim nga masat infrastrukturore, masat me karakter qeverisës nuk mund të prioritizohen në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por ato duhet të hamonizohen detyrimisht me njeri tjetrin. Shtrirja në kohë e aktiviteteve përbën kohëzgjatjen e nevojshme për zbatimin e masës. Për të bërë një kornizë orientuese të sekuencimit në kohë të masave, është pasur parasysh që përmirësimi i qeverisjes të përfundojë brenda vitit 2020, duke qënë se shumica e strategjive referuese synojnë këtë periudhë zbatimi. Pavarësisht mundësisë për investime infrastrukturore masat qeverisëse duhet të jenë mekanizmat kryesorë që do ti përgjigjen procesit të integritimit Evropian. Fillimisht, është menduar që të zbatohen masat me karakter qeverisës të cilat nuk shoqërohen me kosto shtesë në buxhetet respektive dhe kërkojnë vetëm angazhimin e stafëve. Gjithashtu jemi munduar që masat të ndjekin një rend kronologjik realist, duke respektuar edhe procedurat ligjore dhe administrative që përcakton kuadri rregullator.

Shtojca 2.3 Kostimi i masave dhe aktiviteteve

Kostoja e përlllogaritur e Programit Kombëtar të menaxhimit të integruar të ujit është e bazuar në programet buxhetore të ministrive të linjës për periudhën 2015-2018, kërkesat për investime të parashikuara në strategjitë sektoriale, strategjitë ndërsektoriale të lidhura me sektorin, dhe investimet e identifikuar në master planin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime.

Për sa i përket masave qeverisëse, si referencë është marrë metodologjia e përdorur nga Ministria e Financave për llogaritjen e kostove njësi të akteve ligjore dhe nënligjore.

Në të njëjtën kohë, për ato masa të cilat janë realizuar ose janë në proces hartimi nëpërmjet projekteve të ndryshme të BE-së, është referuar kosto respektive sipas projekteve.

Kryesisht për sa i përket masave me karakter ligjor, për ato akte ligjore dhe nënligjore, të cilat janë parashikuar të hartohen me mbështetje financiare të jashtme, si referencë kosto njësi është përdorur kosto e parashikuar nga projekte të mëparshme të ngjashme.

Shembull: Të angazhuar për hartimin e një ligji janë **10 punonjës të Administratës** të cilët punojnë për 20 ditë pune (1 muaj) me një pagë mesatare 75 200 lekë në muaj.

Përlllogaritja e përafërt e kostos totale të hartimit të një dokumenti:

- Paga: 10 punonjës * (75 200) = 752 000 lekë.
- Sig shoqërore: 752 000 000 lekë * 0.167 = 125584 lekë.
- Kosto personeli: 752 000 lekë + 125584 lekë = 877584 lekë
- Kosto administrative: 200 000 lekë.

Total: 877584 lekë + 200 000 lekë = **1077584 lekë.**

Kostoja totale e përafërt në rastin kur ligji përgatitet nga punonjës të administratës (në

Për sa i përket rasteve kur një masë qeverisëse parashikohet të hartohet nëpërmjet punësimit / kontraktimit të ekspertëve të jashtëm shqiptar, sërish është përdorur metodologjia e vënë në dispozicion nga Ministria e Financave.

Shembull: Të angazhuar për hartimin e një ligji janë **2 ekspertë të jashtëm shqiptar** të cilët punojnë për 20 ditë pune (1 muaj) me një pagë mesatare mujore 535 000 lekë në muaj.

Përlllogaritja e përafërt e kostos totale të hartimit të aktit:

- Paga: 2 ekspertë * (535 000) = 107 0000 lekë.
- Sig shoqërore: 267 500 lekë * 0.167 = 44672.5 lekë.
- Kosto personeli: 107 0000 + 44672.5 lekë = 1114672.5 lekë
- Kosto administrative: 400 000 lekë.

Total: 1114672.5 lekë + 400 000 lekë = **1512672.2 lekë.**

Kostoja totale e përafërt në rastin kur ligji përgatitet nga 2 ekspertë të jashtëm shqiptar është **1512672.2 lekë.**

Për sa i përket rasteve kur një masë qeverisëse parashikohet të hartohet nëpërmjet punësimit / kontraktimit të ekspertëve të huaj, sërish është përdorur metodologjia e vënë në dispozicion nga Ministria e Financave.

Shembull: Të angazhuar për hartimin e një ligji janë **2 ekspertë të huaj** të cilët punojnë për 20 ditë pune (1 muaj) me një pagë mesatare 100 000 lekë në ditë (800 euro/ditë).

Përlllogaritja e përafërt e kostos totale të hartimit të aktit:

- Paga dhe sigurime: 2 ekspertë * 20 ditë pune * 100 000 = 4000 000 lekë.
- Shpenzime akomodimi: 2 ekspertë * 20 ditë pune * 12 000 lekë dita = 480 000 lekë.
- Shpenzime dhe ushqim: 2 ekspertë * 20 ditë pune * 8 000 lekë dita = 320 000 lekë
- Kosto administrative: 500 000 lekë.

Në lidhje me trajnimet për rritjen e kapaciteteve dhe eficiencën institucionale, kostot e dhëna janë bazuar në numrin e punonjësve që do të trajnohen, sipas afateve respektive.

Për sa i përket masave të lidhura me kapacitetet njerëzore është përdorur si referencë numri i punonjësve dhe paga e tyre mesatare, për rastet kur parashikohet forcimi i strukturave apo edhe ngritja e strukturave të reja (*shiko shembullin më sipër*).

Për sa i përket masave infrastrukturore, për studimet dhe investimet janë përcaktuar kosto reale, aty ku ato janë parashikuar të kryhen me projekte të ndryshme apo edhe me buxhet të shtetit, sipas rastit. Në disa raste, investimet e identifikuar nuk shoqërohen me një kosto të përcaktuar, kjo për faktin se nevojitet paraprakisht një studim për evidentimin e çështjeve problematike, të cilat shoqërohen më pas nga kosto respektive.

Llogaritja e kostove të studimeve

Për sa i përket studimeve, llogaritja e kostove të tyre referuar edhe praktikave të ndryshme është përdorur metodologjia e ditëve të punës të eksperteve të fushave të ndryshme. Nga kjo listë ekspertësh në varësi të karakterit të studimit është bërë edhe përcaktimi i orëve të punës për secilin nga studimet. Lista tip e përdorur për përcaktimin e kostove të studimeve është si më poshtë:

Tabela 15. Studimet dhe kostot e llogaritura për ditë pune

<i>Sn-N</i>	<i>Titulli i studimit</i>	<i>Ditë pune</i>	<i>Kosto për ditë pune (në Euro)</i>	<i>Total</i>
1	Ekipi i ekologjisë		600	0
2	Ekspert për modelimin e lumenjve dhe hidrolog		600	0
3	Ekspert për manaxhimin e burimeve ujore		600	0
4	Ekspert i cilësisë së ujit		600	0
5	Ekspert i hidroenergjisë		600	0
6	Ekspert për ujitjen		250	0
7	Ekspert për manaxhimin e mjedisit		250	0
8	Ekspert për ekologjinë		250	0
9	Ekspert për ndryshimet klimatike		600	0
10	Ekspert financiar për burimet ujore		300	0
11	Ekspert për qeverisjen e ujit		600	0

<i>Sn-N</i>	<i>Titulli i studimit</i>	<i>Ditë pune</i>	<i>Kosto për ditë pune (në Euro)</i>	<i>Total</i>
12	Ekspert për ngritje kapacitetesh		250	0
13	Ekspert për shkencat sociale		250	0
14	Ekspert i legjisleacionit mjedisor		250	0
15	Ekspert për komunikimin me publikun dhe pjesëmarrjen		250	0
16	Ekspert për çështjet gjinore		250	0
17	Komunikimi dhe trajnimet		250	0
18	Vizita në terren dhe monitorimi		1000	0
	Ditë pune total		Euro	0

Shtojca 2.4 Përcaktimi i peshës që zënë projektet në raport me arritjen e objektivave respektiv

Referuar peshës specifike të projekteve, jo detyrimisht e një projekti i cili ka një peshë të madhe në realizimin e objektivit strategjik mund të renditet i pari në listën e prioritizuar të projekteve. Gjithësesi është e nevojshme që të identifikohet pesha specifike që zë secili nga projektet kundrejt realizimit të objektivit. Nisur nga karakteri që kanë secili nga objektivat duhet të identifikohet edhe indeksi i vlerësimit të peshës që ka projekti kundrejt objektivit.

Për furnizimin me ujë është përdorur si referencë për realizimin e objektivit numri i popullsisë, i predispozuar potencialisht për t'u furnizuar me ujë.

Shtojca 2.5 Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse

Institucionet që mbartin përgjegjësi publike, përfshirë edhe ato të lidhura me sektorin e ujit, janë ngritur me Vendime të Këshillit të Ministrave ose ligje që rregullojnë funksionimin, organizimin dhe përgjegjësitë e tyre.

Fusha e përgjegjësisë shtetërore të ministrive përcaktohet me akte individuale në formën e Vendimeve të Këshillit të Ministrave. Aty përcaktohet misioni dhe përgjegjësitë përkatëse për periudhën e mandatuar.

Fusha e përgjegjësisë shtetërore e institucioneve të tjera qendrore, publike dhe enteve përcaktohet në ligjet e tyre organike. Në këto ligje organike përcaktohet misioni, fusha e përgjegjësisë dhe struktura përkatëse.

Në raste të tjera, Kuvendi ose Këshilli i Ministrave mund ti ngarkojnë institucioneve publike, përgjegjësi të veçanta nëpërmjet ligjeve dhe vendimeve. Në asnjë rast këto përgjegjësi nuk tejkalojnë misionin për të cilin janë ngritur këto institucione.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti, STKKU i është referuar këtyre akteve ligjore në fuqi, për të përcaktuar institucionet përgjegjëse për secilën nga masat dhe aktivitetet e parashikuara në Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit.

Shtojca 2.6 Përcaktimi i indikatorëve

Për identifikimin e indikatorëve kryesisht janë marrë në konsideratë fillimisht indikatorët ekzistues të përcaktuar në dokumentet strategjike të lidhura me sektorin e ujit, sipas çështjeve të ndryshme, të përfshira në dokumentet strategjike, të miratuara apo edhe ato në proces miratimi. Të gjithë indikatorët referojnë katër periudha kohore:

- Viti bazë 2015;
- Periudhën afatmesme viti 2020;
- Periudhën afatgjatë viti 2027;
- Afati final 2030.

Më pas, është propozuar një listë e përgjithshme me indikatorët e identifikuar, e cila është përcjellë për diskutim tek të gjitha nëngrupet tematike për plotësime dhe saktësime të mëtejshme.

Në tabelën më poshtë jepet vizualisht listimi i indikatorëve matës të performancës për secilin objektiv.

Tabela 16. Indikatorët matës të performancës për objektiv (shembull)

Nr.	Objektivi / Indikatori	Njësia Matëse	Viti bazë (2015)	2020	2027	2030
<i>Qëllim Strategjik: Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre ndërmjet përdoruesve, duke maksimizuar përfitimet ekonomike në respekt të kushteve mjedisore dhe parimeve të manaxhimit të qëndrueshëm.</i>						
1	Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim, të sigurtë dhe të vazhdueshëm të popullsisë.					
	<i>1.1 - Mbulimi me ujë</i>	<i>% e popullsisë së mbuluar</i>	<i>81</i>	<i>82</i>	<i>84</i>	<i>90</i>

Të gjitha nëngrupeve tematike i është kërkuar të bëjnë propozimet respektive, duke marrë në konsideratë të gjitha politikat strategjike të insitucioneve që secili prej anëtarëve përfaqëson. STKKU, ka ndjekur me rigorozitet këtë proces, pasi përcaktimi i qartë dhe eficient i indikatorëve përbën një nga faktorët kryesorë të zbatimit të suksesshëm të këtij programi për sektorin e ujit. Ndër dokumentat strategjike themelore të marra në konsideratë për këtë proces mund të evidentohen: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UN Sustainable Development Goals 2030), Strategjia e Evropës Juglindore 2014–2020 (Southeast Europe Strategy 2014-2020), MSA shoqëruar me të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrja e statusit të vendit kandidat në BE në 2014, SKZHI 2015-2020, objektivat e Programit të Qeverisë, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, përfshi ato të miratuara si edhe ato në proces miratimi.

Për sa i përket përcaktimit të indikatorëve për vitin 2027 dhe 2030, ato janë përcaktuar me përafërsi nisur nga trendi i realizimit të tyre deri tani. Ekspertët e fushës të cilët janë edhe anëtarë të nëngrupeve tematike respektive kanë bërë propozimet përkatëse të cilat janë reflektuar në tabelën përfundimtare.

Gjithashtu, një mbështetje në këtë proces kanë qenë edhe kërkesat specifike të Direktivës 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave” (Direktiva Kuadër e Ujit), si dhe kërkesat e direktivave bija të saj. STKKU ka përgatitur një udhëzues të përgjithshëm, i cili identifikon të gjitha kërkesat specifike që rrjedhin nga këto direktiva dhe i ka vënë në dispozicion të anëtarëve të nëngrupeve tematike duke lehtësuar kështu procesin e përcaktimit të indikatorëve. Nisur nga fakti që këto kërkesa janë tepër specifike, teknike, të ndërlikuar dhe të një natyre që implikojnë sektorë të ndryshëm përfshi edhe kostot e mëdha të zbatimit, disa

prej tyre nuk janë përkthyer në indikatorë, ndërsa disa të tjerë janë përkthyer por nuk shoqërohen ende nga një njësi matëse respektive për periudhat e përcaktuara në dokument.

Nisur nga fakti që Programi Kombëtar Sektorial për manaxhimin e integruar të ujit është një dokument i gjallë, numri i indikatorëve mund të ndryshojë në varësi të ecurisë së zbatimit të këtij programi por edhe të burimeve financiare në dispozicion.

Shtojca 2.7 Prioritizimi i masave dhe aktiviteteve / projekteve të karakterit infrastrukturor

Prioritizimi i masave me karakter infrastrukturor është një proces i domosdoshëm për të përmirësuar planifikimin dhe shpërndarjen e investimeve. Kjo nevojë lind nga mungesa e buxhetit në dispozicion për të financuar të gjithë listën e projekteve, por jo vetëm. Sikur i gjithë buxheti i nevojshëm të ishte në dispozicion sërish do të nevojitej koha e duhur për realizimin e investimeve. Në këto kushte është i nevojshëm hartimi i matricave dhe i kriterëve për prioritizimin e listës së projekteve. Lista e projekteve të nevojshëm për arritjen e objektivave është e vështirë të identifikohet plotësisht në këtë fazë por me anë të këtij mekanizmi në krijojmë mundësinë që në çdo kohë të mund të prioritojmë projektet. Kriteret e matricave gjithashtu mund të jenë të ndryshueshme në bazë të prioriteteve të qeverisë dhe vendimmarrjeve politike, sikurse edhe pikëzimi, duke e bërë këtë sistem vlerësimi fleksibël.

Matrica e prioritizimit të projekteve për sektorin e ujit është reflektim i një procesi konsultativ midis aktorëve qeveritarë dhe joqeveritare në kuadrin e hartimit të PKS dhe në kuadrin e funksionimit të nëngrupeve tematike të ngritura për këtë qëllim. Prioritizimi kryhet sipas kriterëve të kategorizuara në teknike, infrastrukturore, ekonomike, financiare, mjedisore, sociale dhe institucionale për çdo projekt. Në varësi të sektorëve, prioritizimi i këtyre projekteve do të bëhet dhe në bazë të performancës.

Synimi është hartimi i një matrice prioritizimi për secilën kategori të projekteve të identifikuar. Sistemi i pikëve bën të mundur renditjen ndërmjet projekteve të të njëjtit karakter, por jo vetëm.

Nisur nga fakti që sektori i ujit është kompleks dhe i përbërë nga disa fusha të përdorimit të ujit e mbrotjes së burimeve ujore në dispozicion, etj, dhe me një numër të madh institucioneve të përfshira, puna për evidentimin e këtyre kriterëve ka qënë e gjatë dhe tërësore. Nëngrupet tematike kanë rënë dakord që kriteret e prioritizimit të përgjigjen individualisht çdo fushe përdorimi të ujit, për të ardhur në ndihmë konkretisht të gjithë përdoruesve dhe por edhe zbatuesve të PKS-së.

Shënim: Matricat janë standardizuar sipas një formati të rënë dakord nga nëngrupet tematike. Ato janë në formë tabelare, të ndara në kolona si më poshtë:

Tabela 17. Matricë prioritizimi (*shembull*).

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë se kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (te normalizuara)
1	2	3	4	5	6	7	
	Kritere të përgjithshme	15					
1	Numri i përfituesve të shërbimit	6	>200000	Banorë	5	6.0	6.0
			50000 – 200000	Banorë	4	4.5	
			30000 – 50000	Banorë	3	3.0	
			2000 – 30000	Banorë	2	1.5	
			<2000	Banorë	1	0.0	

- Kolona 1: në këtë kolonë vendoset emërtimi i kriterit, sipas listës së kriterëve të paraqitur më sipër.
- Kolona 2: në këtë kolonë vendoset pesha që zë secili kriter. Shuma totale e peshave të të gjithë kriterëve sëbashku është 100.
- Kolona 3: në këtë kolonë vendoset vlera / indeksi
- Kolona 4: në këtë kolonë vendosen të gjitha njësitë matëse/ vlerësuese sipas secilit kriter
- Kolona 5: në këtë kolonë vendosen pikët e mundshme të marra për çdo njësi matëse / vlerësuese si rezultat i vlerësimit të kryer.
- Kolona 6: në këtë kolonë vendoset normalizimi. Kjo vlerë paraqet pikët përfundimtare që merr secila nga njësitë matëse / vlerësuese të identifikuara respektivisht për çdo kriter (shif figurën mëposhtë).
- Kolona 7: në këtë vendosen respektivisht të gjitha pikët totale të përfutuara.

Kriteri:

numri i përfituesve të shërbimit

Njësi Matëse	Pesha	Pikët sipas njësisë	Normalizimi
> 200000	15	4	$15 = \text{Pesha}$
50000-200000		3	$10 = \{15 / (3)\} * 3-1$
30000-50000		2	$5 = \{15 / (3)\} * 2 -1$
2000-30000		1	0 (Gjithmonë)

$$\text{Normalizimi} = [\text{Pesha} / (n - 1 \text{ njësisë matëse})] * (n - 1 \text{ njësi matëse})$$

Ku: n- numri i njësisë matëse (psh: 4 njësi matëse)

Më poshtë gjenden matricat e prioritizimit për çdo objektiv.

Objektivi 1: Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim, të sigurt dhe të vazhdueshëm të popullsisë

Matrica e prioritizimit për projektet në funksion të këtij objektivi përfshin kritere teknike, infrastrukturore, ekonomike, financiare, mjedisore, sociale dhe institucionale. Kriteret teknike lidhen me popullsinë e ndikuar, tipin e projektit, funksionalitetin, ndikimin në financa, ndikimin në zhvillimin social si edhe me strukturat institucionale. Kriteret ekonomike dhe financiare lidhen tipikisht me investimin për frymë dhe nevojat për financim. Kriteret mjedisore lidhen ngushtësisht me ndikimin në zonën ujëmbledhëse si edhe konsumin e energjisë. Kriteret socioekonomike lidhen ngushtësisht me shkallën e varfërisë. Kriteret institucionale lidhen ngushtësisht me kapacitetet administrative për administrimin e projekteve. Për secilën kategori të projekteve është përgatitur një matricë e veçantë e cila shërben për prioritizimin e projekteve të të njëjtit karakter. Prioritizimi për këtë objektiv do të bëhet mbi bazë të performancës.

Tabela 18. Matrica e prioritizimit për ujësjellës urban.

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Piket sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
	1	2	3	4	5	6	7
	Kritere të përgjithshme	50					
1	Popullsia e Ndikuar	15	5.000 500 100 <100	Banorë	4 3 2 1	15.0 10.0 5.0 0.0	
2	Tipi i Projektit	10	Sistem i Ri Zgjerim Rehabilitim	Tipi i projektit	3 2 1	10.0 5.0 0.0	
3	Kohëzgjatja e Shërbimit	20	<6,5 <10 <15 15	Orë	4 3 2 1	20.0 13.3 6.7 0.0	
4	Funksionaliteti dhe Gjendja Fizike	5	Klasa D Klasa C Klasa B Klasa A		4 3 2 1	5.0 3.3 1.7 0.0	
	Kategoria e Kriterit Ekonomik/ Financiar	30					
5	Investimi për frymë	15	200 400 650 >650	Investim	4 3 2 1	15.0 10.0 5.0 0.0	
6	Hendeku financimi (% e investimit)	15	65% 90%		3 2	15.0 7.5	

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
			>120%		1	0.0	
	Kategoria e Kriterit Mjedisor	15					
7	Konsumi i Energjisë/ Tipi i Furnizimit	15	me Vetë-Rrjedhje e Përzier me Ngritje Mekanike	Tipi i furnizimit	3 2 1	15.0 7.5 0.0	
	Kategoria e Kriterit Socioekonomik	5					
8	Shkalla e Varfërise	5	15% 11% <11%		3 2 1	5.0 2.5 0.0	
	TOTAL	100					

Tabela 19. Matrica e prioritizimit për ujësjellës rural.

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
	1	2	3	4	5	6	7
	Kritere të përgjithshme	40					
1	Popullsia e Ndikuar	20	1.800 600 <600	Banorë	3 2 1	20.0 10.0 0.0	
2	Tipi i Projektit	20	Sistem i Ri Zgjerim Rehabilitim	Tipi i projektit	3 2 1	20.0 10.0 0.0	
	Kategoria e Kriterit Ekonomik/ Financiar	20					
3	Investimi per frymë	20	200 400 650 >650	Investim	4 3 2 1	15.0 10.0 5.0 0.0	
	Kategoria e Kriterit Mjedisor	15					
4	Konsumi i Energjisë/ Tipi i Furnizimit	15	me Vetë-Rrjedhje e Përzier me Ngritje Mekanike	Tipi i furnizimit	3 2 1	15.0 7.5 0.0	

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
	Kategoria e Kriterit Socio-ekonomik	20					
			15%		3	20.0	
5	Shkalla e Varferisë	20	11%		2	10.0	
			<11%		1	0.0	
	Kategoria e Kriterit Institucional	5					
6	Ekziston ofruesi i Shërbimit Publik?		Po		2	5.0	
			Jo		1	0.0	
	TOTAL	100					

Objektivi 2: Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbimin të zonave urbane dhe rurale

Matrica e prioritizimit për projektet në funksion të këtij objektivi përfshin kriteret teknike, infrastrukturore, ekonomike, financiare, mjedisore, sociale dhe institucionale. Kriteret teknike lidhen me popullsinë e ndikuar, tipin e projektit, funksionalitetin, ndikimin në financa, ndikimin në zhvillimin social si edhe me strukturat institucionale. Kriteret ekonomike dhe financiare lidhen tipikisht me investimin për fryme dhe nevojat për financim. Kriteret mjedisore lidhen ngushtësisht me ndikimin në zonën ujëmbledhëse si edhe konsumin e energjisë. Kriteret socioekonomike lidhen ngushtësisht me shkallën e varfërisë. Kriteret institucionale lidhen ngushtësisht me kapacitetet administrative për administrimin e projekteve. Prioritizimi për këtë objektivi do të bëhet mbi bazë të performancës.

Tabela 20. Matrica e prioritizimit për kanalizim urban.

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
	1	2	3	4	5	6	7
	Kritere të përgjithshme	35					
			50.000		4	20.0	
1	Popullsia e Ndikuar	20	15.000	Banorë	3	15.3	
			20.000		2	6.7	
			<2.000		1	0.0	
2	Tipi i Projektit	10	Sistem i Ri	Tipi i projektit	3	10.0	
			Zgjerim		2	5.0	
			Rehabilitim		1	0.0	
3	Funksionaliteti dhe Gjendja Fizike	5	Klasa D		4	5.0	
			Klasa C		3	3.3	
			Klasa B		2	1.7	
			Klasa A		1	0.0	
	Kategoria e Kriterit Ekonomik/Financiar	20					

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
4	Investimi për frymë	10	250	Investim	4	10.0	
			1000		3	6.7	
			2000		2	3.3	
			>2000		1	0.0	
5	Gap financimi (% e investimit)	10	20%		3	10.0	
			40%		2	5.0	
			>40%		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Mjedisor		25					
6	Impakt Pozitiv ne Zonën Ujëmbledhëse	25	Liqen	Tipi i furnizimit	3	25.0	
			Lum		2	12.5	
			Det		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Socioekonomik		15					
7	Shkalla e Varfërisë	15	15%		3	15.0	
			11%		2	7.5	
			<11%		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Institucional		5					
8	Ekziston ofruesi i Shërbimit Publik?	5	Po		2	5.0	
			Jo		1	0.0	
TOTAL		100					

Tabela 21. Matrica e prioritizimit për kanalizim rural.

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
	1	2	3	4	5	6	7
Kritere të përgjithshme		30					
1	Popullsia Ndikuar	15	1.000	Banorë	3	15.0	
			600		2	7.5	
			<600		1	0.0	
2	Tipi i Projektit	5	Sistem i Ri	Tipi i projektit	3	5.0	
			Zgjerim		2	2.5	
			Rehabilitim		1	0.0	
3	Tipi i sistemit të kanalizimeve	10	I veçuar		2	10.0	
			I kombinuar		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Ekonomik/ Financiar		20					

Nr.	Emërtimi i kriterit	Pesha	Vlera / indeksi	Njësi matëse / vlerësuese	Pikët sipas njësisë së kriterit	Normalizimi	Pikët totale për kriter (të normalizuara)
4	Investimi për frymë	20	500	Investim	4	20.0	
			1500		3	13.3	
			2000		2	6.7	
			>2000		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Mjedisor		25					
5	Impakt Pozitiv në Zonën Ujëmbledhëse	25	Liqen	Tipi i furnizimit	3	25.0	
			Lum		2	12.5	
			Det		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Socioekonomik		15					
6	Shkalla e Varfërisë	15	15%		3	15.0	
			11%		2	7.5	
			<11%		1	0.0	
Kategoria e Kriterit Institucional		10					
7	Ekziston ofruesi i Shërbimit Publik?	5	Po		2	5.0	
			Jo		1	0.0	
